Sigurisht, mënyra se si pozicionohet një vend nuk është thjesht çështje zgjedhjeje. Hapësira e saj e manovrës së një qeverie varet nga zhvillimet politike dhe qëndrimet e lojtarëve më të mëdhenj. Nëse, për shembull, BE do të zgjedhë një qasje më gjeopolitike ndaj zgjerimit, ajo ndoshta do të këmbëngulë në një shtrirje më të madhe të politikës së jashtme. Kështu, politikat shumë-polare të Serbisë mund të bëhen më të vështira për t'u mbështetur. Në të

kundërtën, nëse BE dobësohet me vendosmëri nga kriza e Koronës, ndërsa Kina del e forcuar ndjeshëm, më shumë vende të rajonit do të tundohen të orientojnë politikat e tyre në drejtim të Pekinit (Lehne, 2020).

KAPITULLI 4 - GJEOPOLITIKA NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE ROLI I LIDERSHIPIT

Mosmarrëveshjet në fillim të viteve 1990, në Kongresin e 14-të të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, për sa i përket mekanizmit të votimit të "një personi një votë" bëri që delegacionet sllovene dhe kroate të largoheshin nga Kongresi, të cilat nga ana tjetër çuan në një krizë kushtetuese. Sllovenia dhe Kroacia kërkuan më parë pavarësinë. Maqedonia ndoqi dhe me anë të referendumit, shpalli pavarësinë në 1991. Bosnja dhe Hercegovina shpalli pavarësinë një vit më vonë, në 1992, ndërsa Serbia dhe Mali i Zi formuan Republikën Federale të Jugosllavisë.

Figura 1 Shtetet e Ballkanit Perëndimor



Burimi: <https://www.economist.com/europe/2014/09/27/in-the-queue>

Këto shpallje të pavarësisë kontribuan në mënyrë të pashmangshme në ngritjen e ndjenjave etno-nacionaliste dhe nacionaliste, të gjitha në republikat e sapo pavarësuar. Kjo retorikë etno-nacionaliste u përdor veçanërisht nga presidenti i Serbisë Slobodan Millosheviq, i cili përfitoi nga vakuumi i krijuar nga një shtet qendror që po dobësohej progresivisht dhe vendosi përdorimin e ultra-nacionalizmit serb për të ndezur flakët e etno-nacionalizmit në republikat tjera (veçanërisht Bosnjë dhe Kroaci, si dhe ndaj Kosovës) dhe të fitojë legjitimitetin në vend. Duke gjetur një burim të ri të legjitimitetit, Millosheviçi shpejt rriti fuqinë e tij në Serbi përmes kontrollit të aparatit të partisë dhe shtypit. Ai vendosi për të hequr dy provincat autonome të Kosovës dhe Vojvodinës nga autonomia e tyre e garantuar kushtetuese brenda Serbisë duke përdorur tubime masive për të detyruar udhëheqjet lokale të jepnin dorëheqjen në favor të kandidatëve të tij të preferuar. Nga mesi i vitit 1989 Kosova dhe Vojvodina ishin ri-integruar në Serbi. Udhëheqja malazeze ishte e përbërë kryesisht nga aleatët e Millosheviqit.

Në Bosnjë, serbët etnikë dhe kroatët etnikë bënë shpallje të pavarësisë së rajoneve ku ata kryesisht banonin - në rastin e të parës, Republika Srpska dhe në rastin e kësaj të fundit, Republika Kroate e Herceg-Bosnjës. Këto pretendime territoriale, të shoqëruara me rritjen e etno-nacionalizmit dhe shpërbërjen e Jugosllavisë, çuan në luftën më të madhe në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore, në të cilën kishte qindra mijëra viktima me mbi një milion të zhvendosur. Kjo çoi në disa shpërqarje paqësore por edhe të dhunshme, të cilat rezultuan në spastrimin etnik të shqiptarëve dhe gjenocidin e boshnjakëve.

Për gati tridhjetë vjet, rajoni ka qenë i paqëndrueshëm. Përkundër këtyre paqëndrueshmërive historike, këto shtete aktualisht po përballen me një pikë kthese potencialisht të re të ndikuar nga zhvillimet e brendshme dhe rendi global që ndryshon. Në nivelin kombëtar, Ballkani Perëndimor duket se po përjeton progres ekonomik që nga konfliktet në vitet 1990 dhe fillim të viteve 2000 siç shihet në rritjen e PBB-së për kokë banori, rritjen e eksporteve dhe mallrave, rritjen e lirisë së biznesit (përveç në Bosnjë dhe Hercegovinë).

Sidoqoftë, mjedisi politik tregon mesazhe më të përziera. Për sa i përket kontrollit të korrupsionit, prirja është përgjithësisht në rritje. Lidhur me efektivitetin e perceptuar të qeverisë, trendi me kalimin e kohës duket se po rritet edhe pse rezultatet janë ende mjaft të ulëta. Sa i përket demokracisë, nga analiza e proceseve zgjedhore, vijmë në përfundim se

vendet po shkojnë drejt një ambienti autokratik, e pjesërisht demokratik. Më konkretisht, Serbia pati një rënie në këtë drejtim në 15 vitet e fundit, ndërsa Maqedonia e Veriut u rrit në vitet e fundit për shkak të ndryshimit të strukturave qeveritare. Lidhur me sundimin e perceptuar të ligjit, i cili kap perceptimet e agjentëve të ndryshëm në shoqëri në lidhje me besimin e tyre në cilësinë e zbatimit të kontratës, të drejtat e pronës, policinë dhe gjykatat, si dhe gjasat e krimit dhe dhunës, rezultatet janë të ulëta. Disa vende, veçanërisht Serbia dhe Shqipëria, kanë parë rënien e tyre në perceptim të ligjit në vitet e fundit. Megjithatë, rajoni ende po merret me ankesat e së kaluarës. Së fundmi, gjendja e dhunës dhe siguria e rajonit të Ballkanit Perëndimor tregon një imazh të përzier, krahasuar me vitet 1990 dhe fillimet e viteve 2000, nga ku rrjedh se vendet duket se po përfetojnë më pak trazira shoqërore. Duke thënë këtë, protesta të tilla si i ashtuquajti Revolucion shumëngjyrësh në Maqedoninë e Veriut në 2016 dhe Grushti i Parlamentit në 2017; protestat anti-Vuçiq në Serbi në 2018 dhe protestat në Malin e Zi në pranverën e 2019 pas skandaleve të shumta të korrupsionit tregojnë se trazirat shoqërore nuk janë zvogëluar plotësisht. Për sa i përket qëndrueshmërisë së perceptuar politike dhe mungesës së dhunës, tendencat tregojnë progres që nga konfliktet e armatosura të fillimit të viteve 2000, megjithatë, vitet e fundit, rezultatet e perceptuara janë në rënie në të gjitha vendet.

Në lidhje me dinamikën e brendshme, ka sfida afatgjata mbi funksionimin e mjedisit politik me sundim të ulur të ligjit dhe nivele të larta të korrupsionit. Tjetra, ekzistojnë rreziqe të sigurisë që vijnë nga trazirat shoqërore, paqëndrueshmëria politike si dhe ekstremizmi etno-nacionalist, i djathtë.

Këto sfida, të lidhura me progresin e ngadalhtë ekonomik, humbjen e perspektivave drejt integritit në BE dhe mungesën e konsolidimit të demokracive, e vendosin rajonin në një enigmë shumë komplekse gjeopolitike. Strategjia e Zgjerimit të BE dhe proceset e pranimit në NATO janë ngadalësuar. Kjo, e kombinuar me mungesën e përparimit të brendshëm, thellimin e polarizimeve të rajoneve që kishin çuar më parë në luftë, si dhe gjasat më të larta të ndikimit nga aktorët e jashtëm, mund të rezultojë në thellimin e pasigurisë, dhunës potenciale, autoritarizmit, ekstremizmit të dhunshëm, migrimit dhe krimit të organizuar (droga dhe trafikimi i qenieve njerëzore) në kufirin me BE (Rustemi et. al, 2019).

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, proceset zgjedhore janë, si rregull, një burim i tensioneve të reja politike. Legjitimiteti i proceseve të tilla elektorale prodhon më tej legjitimitetin e dëmtuar të të gjitha institucioneve dhe proceseve që burojnë prej tyre. Në të kaluarën, ndryshimet dhe reformat e dëshiruara në kornizën legjislative dhe institucionale nuk kanë ndodhur në asnjë prej vendeve të analizuara në këtë punim. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, me gjithë rekomandimet e qarta ndërkombëtare, u bë shumë pak përparim në përmirësimin e legjislacionit kushtetues në lidhje me zgjedhjet, pas një bllokade që ka zgjatur më shumë se një dekadë. Reforma zgjedhore në Malin e Zi filloi shumë vonë dhe përfundoi në dështim të plotë, pa marrëveshje mbi çështjet kryesore dhe me miratimin e njëanshëm të ndryshimeve kryesisht teknike nga koalicioni qeverisës. Në Serbi, edhe pse reformat zgjedhore janë kërkuar për një kohë të gjatë, ndryshimet dhe intervenimet ishin sipërfaqësore, kryesisht në sigurimin e censurit të nevojshëm për koalicionin qeverisës, ndërsa thelbi ka mbetur i njëjtë, pa ndryshime reale në praktikë. Në Maqedoninë e Veriut janë bërë disa përmirësime në regjistrimin e votuesve, në procedurat e votimit dhe modelet e kontrollit financiar, por pa reformë reale të modelit zgjedhor, që favorizon partitë e mëdha dhe pa një politikë ndëshkuese, që është veçanërisht e dobët kur bëhet fjalë për presionin ndaj votuesve dhe klientelizmin.

Në përgjithësi nuk ka ndonjë përmirësim të dukshëm në institucionet përgjegjëse për zgjedhjet. Komisionet Qendrore Zgjedhore nuk janë organe profesionale të përbërë nga ekspertë, por organe të përbëra nga përfaqësues të partive politike.

Vetëm në Bosnjë dhe Hercegovinë situata është e ndryshme, ku komisioni nuk përbëhet nga anëtarë partiak, edhe pse edhe këtu palët mundohen të ndikojnë në përzgjedhjen. Agjencitë anti-korrupsion shpesh nuk kanë kapacitet ose vullnet për të trajtuar korrupsionin politik. Keqpërdorimi i burimeve publike me qëllim të fushatës dhe dyshimet për financim të paligjshëm të partive dhe fushatave vazhdojnë të rëndojnë procesin zgjedhor dhe të gjenerojnë mosbesim të qytetarëve te proceset zgjedhore.

Procesi i zgjerimit të BE-së ka dhënë një model unik të promovimit të demokracisë përmes integritetit. Ky model u zhvillua në vitet 1990 për zgjerimin në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe duke zyrtarizuar kriteret e anëtarësimit në takimin e Këshillit Evropian të Kopenhagës, të njohur si Kriteret e Kopenhagës. BE luan një rol të rëndësishëm në monitorimin

e progresit përmes raporteve vjetore. Procedurat e rrepta të monitorimit i referohen përmbyshjes së kriterëve politike (institucione të qëndrueshme, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe respektimi i të drejtave të pakicave kombëtare) në secilin vend kandidat.

Gjithashtu duhet të theksohet se kriteret e Kopenhagës janë kriterë shtesë dhe nuk përmbahen në traktatet themelore të BE-së. Është një vendim dhe u referohet vendeve që fitojnë statusin e kandidatit. Vendimi ka një karakter politik dhe jo ligjor dhe nuk detyron vendet anëtare të BE-së. Përmbyshja e kriterëve të Kopenhagës funksionon si një kategori ligjore dhe kjo pjesërisht është për shkak të faktit se vetëm një aspekt i kriterëve të anëtarësimit (vetëm kriteret politike) u prezantuan për herë të parë në Traktatin e Amsterdamin. Dimensionin politik i këtyre kushteve politike është se ato duhet të përmbushen para se BE-ja të shprehë mendimin e saj mbi vendin në aderim dhe të sigurojë që kriteret shtesë që nuk përmbahen në aktet e BE-së përmbushen. Komisioni Evropian ka një detyrim ligjor të vlerësojë vetëm përmbyshjen e kriterëve politike, por kjo nuk do të thotë që kriteret tjera janë më pak të rëndësishme.

Politika e zgjerimit drejt Ballkanit Perëndimor ndjek të njëjtin model si për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, por paraqet aspekte të reja në procesin e kushteve politike. Vështirësitë në zbatimin dhe miratimin e disa prej risive institucionale të Traktatit të Lisbonës, si dhe çështjet e kapacitetit për t'u marrë me mosmarrëveshjet e brendshme, ka të ngjarë të parandalojnë që Bashkimi Evropian të tregojë ndonjë entuziazëm për zgjerimin. Gjithashtu, rritja e euro-skepticizmit dhe e partive politike anti-imigrim po ndez zjarrin.

Mjafton të vëzhgohen disa nga politikat në vendet anëtare të BE-së në lidhje me refugjatët, emigrantët, azilkërkuesit, për të kuptuar se zgjerimi po bëhet një temë e ndjeshme.

Vështirësitë me pranimin e Rumanisë dhe Bullgarisë në 2009 dhe perceptimi se pranimi i tyre ishte i nxituar kanë çuar në një qëndrim më të fortë për kushtet e ardhshme. Kombinimi i këtij perceptimi, theksi më i madh i qeverisjes së mirë dhe situatës në Ballkan, kanë çuar në një mozaik më kompleks të kushteve dhe pritjeve, të cilat shprehen në shkallë të ndryshme në procesin e integritetit. Ballkani është një rajon heterogjen me vende që u bashkuan me BE siç është Kroacia, vende që janë kandidatë "të përhershëm" siç është Maqedonia, si dhe ato

shtetësia e të cilëve është e bllokuar dhe që nuk kanë marrëdhënie zyrtare me BE-në, siç është Kosova. Përveç kritereve të Kopenhagës dhe marrëveshjeve të ndryshme të paqes dhe konkluzioneve politike (Dejtoni, Kumanova, Ohri, Beogradi), kushtet e BE-së në Ballkan gjithashtu përbëhen nga një proces i stabilizimit dhe asociimit. Ky proces përcakton kriteret kryesore shtesë në lidhje me parimet demokratike, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, bashkëpunimin rajonal, etj. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është një shpërblim për përmbushjen me sukses të kërkesave të procesit të Stabilizim-Asociimit. Vendet aspiruese mund të paraqesin një kërkesë zyrtare në Këshill dhe ajo që vijon është një mendim nga Komisioni Evropian - nëse një raport pozitiv paraqitet dhe pranohet nga Këshilli Evropian, atëherë procesi i negociatave për anëtarësimin në BE mund të fillojë. Në fund të këtyre negociatave Parlamenti Evropian miraton, me shumicë absolute të votave, dhe në të njëjtën kohë traktati i pranimit duhet të ratifikohet në të gjitha vendet anëtare.

Në Dokumentin e Zgjerimit të vitit 2005, Komisioni deklaroi se ishte plotësisht "i përgatitur për të rekomanduar pezullimin e përparimit në rast të shkeljes serioze të parimeve themelore të BE-së, ose nëse vendi nuk arrin të përmbushë kërkesat themelore në ndonjë fazë" (Komisioni Evropian, 2005). Traktati i Lisbonës gjithashtu i jep Këshillit Evropian mundësinë për të vendosur "kushte" shtesë për t'u bashkuar me BE (Josifoviq, 2015).

Procesi i reformës së administratës publike në të gjithë rajonin ka vazhduar për një kohë të gjatë dhe rezultatet e kësaj reforme mezi janë të dukshme. Strategjitë, ligjet dhe projektet ambicioze ende nuk ndikojnë në zgjidhjen e problemeve më të mëdha të administratës publike. Ndjeshmëria ndaj ndikimit politik, nepotizmit, klientelizmit dhe punësimit partiak janë vetëm disa nga frazat që ndërlidhen me administratën publike në Ballkanin Perëndimor. Në disa prej shteteve janë bërë përpjekje për instalimin e sistemit të punësimit të bazuar në merita, por ai nuk po zbatohet në praktikë. Me këtë konstatim me siguri nuk do të ishin pajtuar autoritetet e vendeve përkatëse, por ky është mendim i numrit të madh të ekspertëve që merren me këtë çështje. Pikërisht për shkak të kësaj anomalie gjatë punësimit në administratën publike, gati të gjitha shtetet përballen me numër të tepërt të punonjësve në administratën publike, por në të njëjtën kohë përballen edhe me mungesë të stafit profesional.

Nga ana tjetër, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje dhe politikë-bërje ekziston vetëm në letër, si një masë për të përmbushur kërkesat e BE-së. Reforma e sistemit të vetëqeverisjes lokale nuk bazohet në tregues të vërtetë ekonomikë, por shpesh reduktohet në vendbanimet partiake.

Në të gjitha vendet, ka dallime të mëdha të dukshme në zhvillimin e komunave, prandaj kemi një numër të madh të komunave jofunksionale dhe të paqëndrueshme financiarisht që në mënyrë të papërgjegjshme dhe jo transparente disponojnë me buxhete dhe nuk janë në gjendje të përmbushin detyrimet tatimore.

Shteti i kapur, korrupsioni endemik, korrupsioni si mënyrë jetese, korrupsioni në të gjitha poret e shoqërisë - këto janë vetëm disa nga frazat e përdorura nga organizatat e shoqërisë civile, analistët, por edhe organizatat ndërkombëtare për të përshkruar gjithnjë e më shumë situatën në Ballkanin Perëndimor.

Autoritetet kombëtare nuk kanë një përgjigje mjaft të mirë ndaj këtyre vlerësimeve kritike. Reformat po kryhen si një shfaqje për komunitetin ndërkombëtar, pa vendosmëri të mirëfilltë politike. Nën presionin ndërkombëtar, po miratohen ligje të përmirësuara që nuk zbatohen në mënyrë thelbësore dhe rezultatet, në rastin më të mirë, paraqiten përmes statistikave shpesh mashtruese.

Në fushën e parandalimit, janë formuar agjenci të specializuara anti-korrupsion që nuk janë rezistente ndaj ndikimeve politike dhe nuk janë të gatshme të zbatojnë vazhdimisht ligjin kur kjo do të thotë kundërshtim i mbajtësve të pushtetit politik dhe shoqëror. Në Maqedoninë e Veriut, një përbërje e re e një agjencie të tillë u zgjodh në 2019, e cila rezultoi në një rritje të madhe të pritjeve të publikut. Asnjë efekt i punës së kësaj agjencie nuk është parë ende dhe e njëjta varet nga mbështetja financiare dhe lidhjet e saj me institucionet tjera anti-korrupsion.

Qasja në informacion, si një parakusht për luftën kundër korrupsionit, ende nuk është e garantuar mjaftueshëm në të gjitha vendet, dhe në disa, të tilla si Mali i Zi, ka tendenca të kufizimeve të mëtejshme.

Përgjigja shtypëse ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar ka rezultate po aq të dobëta. Ekziston një pabarazi e dukshme midis problemeve të krimit dhe korrupsionit që janë shënuar nga raportet ndërkombëtare dhe perceptimet e publikut, dhe numrit të rasteve që

zbulohen dhe ndiqen penalisht në praktikë. Ka dyshime serioze në lidhje me ndikimin e politikës dhe ekzekutivit në kryerjen e hetimeve, të mishëruara në "rrjedhjen e rastit të informacionit" ose fillimin e drejtuar të hetimeve nga një ministër ose president në Serbi.

Në fund, edhe numri më i vogël i çështjeve që zbulohen, hetohen dhe marrin një vendim përfundimtar gjykatë, falë një politike të butë penale, i dërgon një mesazh shoqërisë që korrupsioni dhe krimi japin shpagim (Koprivica & Kovacevic, 2020).

Metodologjia e re e zgjerimit gjithashtu shpreh pritjen që vendet kandidate do të tregojnë angazhimin e tyre për harmonizimin me politikën e jashtme. Demokracitë e brishta tranzicionale ballkanike nuk mund të forcojnë institucionet demokratike nën ndikimin ekonomik dhe politik të shoqërive autoritare dhe jodemokratike. Në një situatë të mungesës së burimeve financiare në tregun e gjerë, vendet e Ballkanit Perëndimor nuk duhet të lejojnë që nevoja e tyre për zhvillimin ekonomik të jetë një ftesë për kapital gërryes, një biletë për qasje të shpejtë, të lirë dhe agresive në burimet tona të kufizuara. Varësia ekonomike zakonisht krijon varësi politike dhe dobëson kontrollin demokratik dhe potencialin shoqëror.

Vendet e Ballkanit Perëndimor gjithashtu duhet të demonstrojnë angazhimin e tyre strategjik ndaj Bashkimit Evropian me gatishmërinë e tyre për të pranuar të gjitha rregullat demokratike të lojës, përfshirë faktin që kapitali i shëndetshëm tërhiqet përmes ndërtimit të institucioneve të shëndetshme. Është koha për të ndaluar praktikën e angazhimit verbal për Perëndimin me fotografi të përshtatshme, ndërsa në të njëjtën kohë të kryeni biznese të dyshimta jo-transparente me palë të treta.

Në mënyrë që të rivendosë besueshmërinë e tij në Ballkanin Perëndimor, Bashkimi Evropian duhet të ndalojë praktikën e dërgimit të mesazheve jo koherente dhe kontradiktore. Sigurisht, një pjesë shumë më e vogël e përgjegjësisë për mungesën e progresit në fushën e demokratizimit bie mbi Unionin, i cili për vite me radhë "trokiti mbi supe" qeveritë rajonale, vlerësoi progresin zyrtar dhe nxori në pah mungesën e rezultateve thelbësore.

Metodologjia e re është gjithashtu një shans i ri për kthimin e ndikimit të Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor, përmes një qasjeje më të mirë, më sistematike dhe të ndershme të procesit të integritetit. Kjo nënkupton një perspektivë të qartë evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor, me afate të arritshme dhe motivuese, dhe pa ngritur nivelin

gjatë vetë procesit. Kjo nënkupton një përdorim të qartë dhe pa kompromis të mekanizmave për shpërblimin e kandidatëve të suksesshëm dhe sanksionimin e atyre të pasuksesshëm, si dhe pezullimin e negociatave pavarësisht nga pasojat ditore politike, me një vizion të qartë të qëllimit përfundimtar dhe strategjik. Kjo përfshin hapjen e perspektivave të qëndrueshme ekonomike për Ballkanin Perëndimor.

Në një kohë kur Bashkimi Evropian ishte i preokupuar me reforma të brendshme, retorika nacionaliste, polarizimi i brendshëm dhe marrëdhëniet e tensionuara bilaterale u rritën në Ballkanin Perëndimor. Vendet e Ballkanit duket se e kanë harruar mesazhin e përsëritur shumë herë - se bashkëpunimi rajonal, pajtimi dhe stabiliteti janë thelbësore për integrimin evropian. Metodologjia e re e zgjerimit gjithashtu thekson se udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor duhet të tregojnë përpjekje të mëtejshme për të forcuar bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në mënyrë që të sjellin stabilitet dhe përparim për qytetarët e tyre dhe të bindin BE-në se rajoni po adreson trashëgiminë e së kaluarës së tij. Tani më është koha që vendet e Ballkanit Perëndimor të sigurojnë që parimi i mosndërhyrjes në punët e brendshme të fqinjëve të tyre të respektohet. Çështjet e hapura rajonale duhet të komunikohen, dhe problemet duhet të zgjidhen përmes mekanizmave të bashkëpunimit diplomatik dhe politik, dhe jo përmes mesazheve nxitëse të dërguara përmes lajmëtarëve në mediumet besnike. Ndjeshmëria e shoqërive, institucioneve dhe proceseve tona ndaj goditjeve dhe ndikimeve rajonale është arsyeja pse ne duhet t'i dëshmojmë Evropës se jemi mjaft të pjekur për të zgjidhur vetë problemet e brendshme dhe ato rajonale.

Një kusht i domosdoshëm për bashkëpunim është pajtimi midis popujve dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor, të cilit autoritetet në të gjitha vendet nuk i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme, veçanërisht pengjet që heqin pohimin e një qasjeje autokritike ndaj ngjarjeve nga e kaluara e afërt. Në samitin e Vjenës të Procesit të Berlinit, një raport shumë i rëndësishëm për zgjidhjen e konflikteve bilaterale u miratua si një kusht për një bashkëpunim më të mirë rajonal, i cili tërhoqi vëmendjen për një problem që është prezent për një kohë të gjatë dhe gjithashtu është lënë pas dore për një kohë të gjatë. Fqinjët e anëtarëve të ardhshëm të Bashkimit nga Ballkani janë ndër aktorët e procesit të pranimit, në të cilin ata duhet të marrin pjesë në

mënyrë aktive dhe me përgjegjësi, duke ndihmuar fqinjët e tyre, e jo duke shtuar kushte shtesë dypalëshe (Simurdic, 2016).

Figure 2. Vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe Kosova



Burimi: EU – Kosovo Locator.

4.1 Maqedonia e Veriut

Politikat në Maqedoninë e Veriut ndodhin brenda kornizës së një republike demokratike përfaqësuese parlamentare, ku Kryeministri është shefi i qeverisë dhe i një sistemi shumëpartiak. Pushteti ekzekutiv ushtrohet nga qeveria. Pushteti legjislativ i është dhënë si qeverisë ashtu edhe parlamentit.

Prej në qershor 2017 Maqedonia e Veriut udhëhiqet nga një qeveri e re, një qeveri e cila u shty për t'i dhënë fund mosmarrëveshjes së emrit me Greqinë dhe për të hapur rrugën e Maqedonisë drejt integriteteve në NATO dhe BE. Platforma e qeverisë së re ishte anëtarësimi në NATO dhe BE për Maqedoninë. Parakushti për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe fillimin e negociatave me BE ishte zgjidhja e çështjes së emrit me Greqinë, e cila kishte qenë një problem që e kishte ndjekur vendin që nga pavarësia e tij në 1991. Udhëheqja e re e vendit, e vendosur për t'i dhënë fund kësaj sage në emër të perspektivës së vendit, ra dakord për një takim midis dy kryeministrave të vendeve fqinje për negocimin e një vendimi përfundimtar midis Maqedonisë dhe Greqisë ndërmjetësuar nga i dërguari i posaçëm i ShBA-ve, Mathew Nimetz. Me ndihmën dhe premtimin e faktorit politik ndërkombëtar për integrim më të shpejtë Euro-Atlantik të Maqedonisë, u arrit një marrëveshje midis Greqisë dhe Maqedonisë, e njohur si Marrëveshja e Prespës. Marrëveshja e Prespës u nënshkrua më 17 Qershor 2018 midis Kryeministrave të të dy vendeve. Si rezultat i kësaj marrëveshjeje, Republika e Maqedonisë ndryshoi emrin e saj në "Republika e Maqedonisë së Veriut". Me arritjen e kësaj marrëveshjeje, filloi një protokoll për anëtarësimin e vendit në NATO, i cili është ratifikuar nga të gjitha parlamentet e vendeve anëtare. Nga ana tjetër, bllokimi i Francës për hapjen e negociatave të pranimit në BE rivendosi një krizë tjetër politike, pasi kampi maqedonas i opozitës tani akuzon qeverinë pro-reformatore të Kryeministrit aktual Zoran Zaev se është një tradhtar për heqjen dorë nga emri i vendit duke mos i përmbushur premtimet e tyre të dhëna për fillimin e negociatave për pranim me BE.

Sipas raportit përfundimtar të botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR, 2020), zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Maqedoninë

e Veriut u administruan mirë midis rregullimeve të nevojshme të lidhura me COVID-19 por mangësitë e vazhdueshme dhe paqëndrueshmëria në kornizën ligjore nënvizuan nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse përpara zgjedhjeve të ardhshme. Këto janë disa nga konkluzionet kryesore pas zgjedhjeve të 15 korrikut 2020, siç detajohen në raportin përfundimtar të botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR).

Raporti ofron 32 rekomandime për të përmirësuar zhvillimin e zgjedhjeve dhe për të rritur transparencën dhe besimin e publikut në procesin zgjedhor.

Rekomandimet kryesore përfshijnë:

- Rishikim të Kodit Zgjedhor - në një procedurë publike, pas një konsultimi të gjerë, gjithëpërfshirës dhe me kohë - në mënyrë që të sigurojë harmonizimin me ligjet tjera përkatëse dhe pajtueshmërinë me angazhimet e OSBE-së dhe standardet ndërkombëtare.
- Krijimi i një përbërjeje dhe mandati të përhershëm për Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe sigurimin e procedurave të qarta dhe transparente për emërimin e komisionarëve të tij.
- Sqarimi dhe konsolidimi i udhëzimeve ligjore për procedurat e regjistrimit të votuesve, për t'iu përgjigjur funksionalitetit të regjistrimit qendror të popullsisë.
- Sigurimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Zyrës së Revizionit të Shtetit me burime të përshtatshme njerëzore dhe financiare për të kryer në mënyrë efektive mandatet e tyre gjatë periudhës zgjedhore.
- Rishikimi i rregulloreve për reklamat politike të paguara në medime, në mënyrë që të lejohet hyrja e papenguar në medime mbi një bazë jo-diskriminuese.
- Zbatimi i reformave për të promovuar pavarësinë politike të transmetuesit publik, duke përfshirë zvogëlimin e varësisë së tij nga buxheti i shtetit dhe ndryshimin e procedurës për zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit Programatik.
- Eliminimi i kufizimeve të panevojshme të së drejtës për të paraqitur ankesa elektorale në mënyrë që të sigurohen mjete juridike efektive.

Nëse e analizojmë raportin e paraqitur më sipër dhe nëse të njëjtin e krahasojmë me ato të proceseve zgjedhore në të kaluarën, konkludojmë se numri i madh i rekomandimeve nga ana e ODIHR, kanë të bëjnë me keqpërdorimin e resurseve shtetërore në kohë zgjedhjesh nga ana e pushtetit, dhe ky rekomandim përsëritet disa herë radhazi në disa cikle zgjedhore. Këto vlerësime edhe pse të buta, sërish e vënë në pikëpyetje legjitimitetin e udhëheqësisë së zgjedhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Për më tepër, mund të merret parasysh, mosrealizimi i regjistrimit të popullatës që nga viti 2002, e cila ndikon drejtpërdrejt në listat zgjedhore që vite me radhë kontestohen nga subjekte të ndryshme politike në vend.

4.2 Shqipëria

Rregullimi politik i Republikës së Shqipërisë i takon një sistemi parlamentar shumë-partiak, ku Presidenti i Shqipërisë është kreu i shtetit, ndërsa Kryeministri i Shqipërisë është shefi i qeverisë. Pushteti ekzekutiv ushtrohet nga Qeveria dhe Kryeministri me kabinetin e tij.

Edi Rama është politikan, artist, shkrimtar dhe Kryeministri aktual i Shqipërisë. Ai është gjithashtu drejtuesi i Partisë Socialiste të Shqipërisë që nga viti 2005. Ai fitoi pushtetin në 2013, duke udhëhequr një koalicion të partive të majta në një fitore të madhe, me një platformë të quajtur "Rilindja për Shqipërinë". Fitorja e tij u bazua në katër shtylla, integrimin evropian, ringjalljen ekonomike, rivendosjen e rendit publik dhe demokratizimin e institucioneve shtetërore. Në vitin 2017, Rama fitoi një mandat të dytë, me Socialistët që u bënë të parët në 25 vjet që arritën një shumicë të vetme partie në parlament.

Rama shërbeu si Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nga 1998 në 2000 dhe ishte Kryetar i Bashkisë së Tiranës për tre mandate rresht nga 2000 në 2011. Nën vëzhgimin e tij, Tirana përjetoi një transformim total, duke u ripërtërirë me fasada shumëngjyrëshe dhe struktura arkitektonike të guximshme, me ç'rast Rama fitoi çmimin e "Kryetarit më të Mirë Botëror" në 2004 dhe Çmimin Hero Evropian nga Revista Time (WorldMayor, 2020). Nga viti 2020 e deri më tani, kryeson me zyrën e OSBE-së me një mandat njëvjeçar.

Edi Rama është shumë aktiv dhe i drejtpërdrejtë në mediumet sociale, ndërsa kundërshtarët e tij politik vazhdimisht e sulmojnë atë për lidhje me krimin e organizuar dhe me afera korrupsioni. Për më tepër, zgjedhjet e fundit lokale u bojkotuan nga opozita në Shqipëri, duke hedhur kështu njollë për procesin zgjedhor në tërësi dhe demokracinë në vend, në kohë kur Shqipëria tenton të hapë negociatat për anëtarësim në BE.

Pas zgjedhjeve lokale të Shqipërisë më 30 qershor 2019, Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) ka publikuar raportin e saj përfundimtar. Sipas këtij raporti, zgjedhjet në Shqipëri u mbajtën me pak kujdes për interesat e elektoratit dhe, në një klimë të një bllokimi politik dhe polarizimi, votuesit nuk kishin një zgjedhje kuptimplote midis opsioneve politike (ODIHR, 2019). Kjo ndodhi pikërisht për shkak se opozita në këtë vend bojkotoi zgjedhjet dhe në të njëjtën kohë përpiqej të paralizojë institucionet shtetërore përmes


protestave. Pas mbarimit të zgjedhjeve dhe pas përfundimit të procesit të mbikëqyrjes së tyre, misioni i ODIHR publikoi raportin e tyre final ku në mes tjerash përfshiheshin rekomandimet në vijim:

- Angazhimi i partive politike dhe palëve të tjera të interesit zgjedhor në reformën zgjedhore duke mbajtur një dialog të hapur dhe gjithëpërfshirës për të adresuar rekomandimet e pazgjidhura elektorale të ODIHR-it;
- Ndërmarrja e masave për të eliminuar problemin afatgjatë të keqpërdorimit të burimeve administrative brenda dhe midis zgjedhjeve, duke përfshirë vendosjen e rregullave precize që përcaktojnë se si burimet publike mund të përdoren dhe nuk mund të përdoren për qëllime elektorale, dhe duke bërë përpjekje për të siguruar që votuesit të mos detyrohen për të marrë pjesë në fushatë, ngjarje ose votim në një mënyrë të veçantë;
- Sigurimi i të drejtës së votuesve për një zgjedhje të lirë dhe të fshehtë, duke përfshirë rishikimin e procedurave të votimit dhe theksimin e rëndësisë së fshehtësisë së votave gjatë trajnimit të komisioneve zgjedhore dhe në materialet e edukimit të votuesve;
- Miratimi i formulave alternative për emërimin e anëtarëve të administratës zgjedhore, mbështetur nga masat mbrojtëse procedurale për pavarësinë e tyre;
- Sigurimi i pavarësisë dhe paanësisë së administratës zgjedhore dhe gjyqësorit;
- Hetimi i të gjitha pretendimeve për shkelje zgjedhore nga organet e zbatimit të ligjit në mënyrë të plotë dhe transparente, dhe vendosja e procedurave efektive për punonjësit e administratës publike për të raportuar çdo presion politik të ushtruar mbi ta në lidhje me punën e tyre (ODIHR, 2019).

Në rast se analizojmë rekomandimet e kaluara të misionit mbikëqyrës të OSBE-së (ODIHR-it), në lidhje me organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve në Shqipëri, do të vërejmë se vërejtjet dhe rekomandimet pothuajse të njëjta përsëriten vite me radhë, duke mos u përfillur nga institucionet shtetërore apo nga klasa politike në vend. Kjo do të thotë se mungon vullneti i mirë nga elitat politike në vend për të kapërcyer anomalitë që kanë të bëjnë me shkeljet e procesit zgjedhor dhe sundimin e demokracisë funksionale, por nga ana tjetër na bën me dije se

mungojnë mekanizmat qortues dhe disiplinorë nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, ose thjesht të njëjtat nuk i japin rezultatet e duhura.

Figura 3. Harta politike në Shqipëri pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017



Burimi: KQZ, Shqipëri, 2017.

4.3 Kosova

Politika e Kosovës zhvillohet në një kornizë të një republike demokratike përfaqësuese parlamentare shumë-partiake, ku Presidenti është kreu i shtetit dhe Kryeministri kryetari i qeverisë. Zgjedhjet parlamentare mbahen çdo katër vjet.

Pushteti ekzekutiv ushtrohet nga qeveria, kryesuar nga Kryeministri. Fuqia legjislative i jepet si ekzekutivit ashtu edhe parlamentit.

Republika e Kosovës që nga pavarësimi i saj nga Serbia, ballafaqohet me shtetndërtimin, ngritjen dhe forcimin e institucioneve demokratike dhe ndërtimin e kapaciteteve njerëzore. Për momentin Kosova gjendet në prag të zgjedhjeve, për shkak të shpërndarjes të parlamentit që erdhi si pasojë e një vendimi të gjykatës kushtetuese. Por si kanë kaluar deri më tani zgjedhjet në Kosovë?

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian (MVZ i BE) në Kosovë në Raportin e tij Përfundimtar mbi zgjedhjet e parakohshme legjislative të 6 tetorit 2019, reflekton në gjetjet e Misionit të cilat përfshijnë një fushatë të gjallë dhe konkurruese në pjesën më të madhe të Kosovës, një proces i administruar mirë dhe transparent para votimit si dhe një ditë të rregullt të zgjedhjeve. Sidoqoftë, keqpërdorimi i burimeve publike dhe mungesa e transparencës së financave të fushatës rezultoi në një fushë të pabarabartë loje. Raporti gjithashtu vuri në dukje mungesën e konkurrencës në zonat serbe të Kosovës dhe një mjedis fushate të dëmtuar nga frikësime kundër kandidatëve ose mbështetësve të listës jo-Srpska.

Vëzhguesit e zgjedhjeve që janë kryesisht nga shtetet e BE-së po vlerësonin procesin në Kosovë nga fillimi i shtatorit derinë certifikimin e rezultateve përfundimtare në fund të nëntorit. Rezultatet paraprake të botuara pas ditës së zgjedhjeve ishin përgjithësisht të besueshme nga subjektet politike, megjithatë besueshmëria e procesit të numërimit dhe tabelarizimit të ditës pas zgjedhjeve u ndikua negativisht nga mungesa e vendimeve me kohë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, trajtimi joefikas i ankesave nga Kolegji Zgjedhor dhe vendimet e diskutueshme të gjykatës. Zonja von Cramon-Taubadel nënvizoi: “Vendimet e diskutueshme të gjykatës në lidhje me numërimin e fletëve të votimit jashtë Kosovës dhe fakti

që gati 90 për qind e vendvotimeve duhej të rinumëroheshin janë mangësi serioze për t'u trajtuar për të ruajtur besimin e publikut në procesin zgjedhor".

Raporti Përfundimtar i MVZ-së së BE-së (EU, 2019) përmban 23 rekomandime për të përmirësuar proceset e ardhshme zgjedhore në Kosovë. "Ka probleme sistematike të përsëritura me procesin zgjedhor. Për shembull, mungesa e dispozitave të qarta për rezultatet sfiduese në të gjitha nivelet, çështjet në lidhje me saktësinë e listës së zgjedhësve, rregullimi dhe mbikëqyrja joadekuate e financave të fushatës, dhe shumë të tjera. Këto probleme duhet të adresohen urgjentisht, duke marrë parasysh edhe përpjekjet e marra tashmë nga komisioni parlamentar ad-hoc i Asamblesë, në mënyrë që ta sjellë Kosovën plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare për zgjedhjet demokratike".

Kosova vazhdimisht përballet me zgjedhje të njëpasnjëshme dhe jo-stabilitet politik. Shumë nga politikanët pretendojnë të bëhen udhëheqës shtetërorë por asnjëri nuk arrin të mbledhë vota të mjaftueshme për një qeveri stabile dhe stabilitet politik në vend. Kjo tregon një krizë lidhshme politike i cili akoma nuk mund të konsolidohet, që nga vdekja e Presidentit historik Ibrahim Rugova, i cili akoma shihet nga numri më i madh i popullatës si i pazëvendësueshëm, gjë e cila e krijon kultin e liderit.

4.4 Serbia

Politika e Serbisë funksionon brenda kornizës së një demokracie parlamentare. Kryeministri është shefi i qeverisë, ndërsa presidenti është kreu i shtetit. Serbia është një republikë parlamentare e përbërë nga tre degë të qeverisë: ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori.

Pushteti ekzekutiv ushtrohet nga Kryeministri, i cili kryeson një kabinet. Kryeministri zgjidhet nga Asambleja Kombëtare me propozimin e presidentit, i cili emëron të emëruarin pas konsultimeve me të gjithë udhëheqësit parlamentarë. Presidenti zgjidhet bazuar në votën e popullit, por ka pak pushtet qeverisës dhe është kryesisht një pozitë ceremoniale. Mandati i presidentit zgjat pesë vjet dhe mund të zgjidhet për më së shumti 2 mandate. Ministrat e kabinetit emërohen nga kryeministri dhe konfirmohen nga Asambleja Kombëtare. Fuqia qeverisëse i jepet kryeministrit, zëvendëskryeministrave dhe ministrave të tjerë.

Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse është zgjedhur me shumicën e votave të të gjithë përfaqësuesve në Asamblenë Kombëtare.

Serbia përdor sistemin shumëpartiak, me parti të shumta politike. Si pasojë shpesh ndodh që asnjëra parti të mos formojë vetë qeverinë, e kjo rezulton në formimin e qeverive të koalicionit. Zgjedhjet mbahen në nivelin parlamentar, provincial dhe lokal dhe caktohen çdo katër vjet, ndërsa zgjedhjet presidenciale planifikohen çdo pesë vjet.

Zgjedhjet e fundit parlamentare në Serbi u mbajtën më 21 qershor. Këto zgjedhje u kontestuan dhe u bojkotuan nga shumica e partive opozitare, të cilat akuzonin pushtetin për cenim të demokracisë, për ndërhyrje jo të rregullt në kodin zgjedhor, duke mos përfillur opozitën, etj. Për më tepër, këto zgjedhje u kundërshtuan edhe për shkak të pandemisë COVID-19, dhe u cilësuan si kërcënim për shëndetin e qytetarëve.

Sërish, raporti i publikuar nga OSBE (ODIHR, 2020) i percepton zgjedhjet e fundit si të administruara në mënyrë efikase përkundër sfidave të paraqitura nga pandemia COVID-19, por dominimi i partisë në pushtet, duke përfshirë mediumet, ishte një arsye për shqetësim. Këto janë disa nga konkluzionet kryesore nga zgjedhjet e 21 qershorit 2020, siç detajohen në raportin përfundimtar të botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR).

Raporti ofron 29 rekomandime për të përmirësuar zhvillimin e zgjedhjeve dhe për të rritur transparencën dhe besimin e publikut në procesin zgjedhor.

Rekomandimet kryesore përfshijnë:

- Rishikimi i kornizës ligjore - në një procedurë publike, pas një konsultimi të gjerë, gjithëpërfshirës dhe në kohë - për të siguruar sigurinë ligjore dhe pajtueshmërinë me angazhimet e OSBE-së dhe standardet ndërkombëtare
- Vendosja e masave për parandalimin e keqpërdorimit të detyrës dhe burimeve shtetërore dhe sigurimi i monitorimit efektiv të pajtueshmërisë, përfshirë sanksionet proporcionale
- Parandalimi i praktikës së presionit ndaj votuesve duke siguruar që rastet e detyrimeve të pretenduara të hetohen tërësisht
- Futja e kërkesave për raportim dhe zbulim të të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës para ditës së zgjedhjeve
- Vendosja e listave të votuesve në dispozicion për shqyrtim publik duke siguruar edhe privatësinë e të dhënave edhe qasjen e ligjshme
- Forcimi i pavarësisë së Autoritetit Rregullator për Media Elektronike dhe përcaktimi i qartë i përgjegjësisë të tij gjatë periudhës së fushatës, përfshirë mundësinë për të ndërmarrë veprime në kohë bazuar në monitorimin sistematik të mbulimit të zgjedhjeve
- Sigurimi i publikimit të shpejtë nga qendrat e votimit të të gjitha protokolleve dhe rezultateve të skanuara, përfshirë ato të korrigjuara më vonë gjatë procesit ose të përcaktuara nga zgjedhjet e përsëritura

Nëse vërejmë raportin e fundit të organizatës Freedom House - ai del të jetë tejet negativ mbi Serbinë dhe udhëheqësinë aktuale, duke e përshkruar Serbinë si një “regjim hibrid”, kryesisht për shkak të standardeve në rënie në qeverisje, drejtësi, zgjedhje dhe liri të mediemeve. Kryeministri Vuçiq e injoroi këtë raport duke e quajtur një raport nga një OJQ e cila është e lidhur me Sorosin.

Nga ajo që cekëm më lart, mund të konstatojmë se bashkësia ndërkombëtare duhet të japë alarmin dhe të veprojë në ngritjen e nivelit të demokracisë në Serbi. Nuk mund të presim që qeveria aktuale serbe të punojë drejt forcimit të demokracisë për shkak se

qeveria kontrollon mediumet, duke mos lënë anash faktin se qeveria e Serbisë përbëhet nga mbi 90% e parlamentarëve. Nga ana tjetër, politikanët opozitarë gjithashtu kanë lëshuar akuza për sulme të organizuara nga pushteti, kërcënime dhe shantazhe.

4.5 Mali i Zi

Ndërveprimet politike në Malin e Zi zhvillohen në një kornizë të një republike demokratike përfaqësuese parlamentare, ku Kryeministri i Malit të Zi është kreu i qeverisë dhe i një sistemi shumëpartiak. Pushteti ekzekutiv ushtrohet nga qeveria. Pushteti legjislativ i është dhënë si qeverisë ashtu edhe Parlamentit të Malit të Zi.

Qeveria e Malit të Zi përfshin kryeministrin, zëvendëskryeministrat si dhe ministrat. Zdravko Krivokapić është Kryeministri i Malit të Zi dhe kreu i Qeverisë, që nga Dhjetori 2020.

Presidenti i Shtetit është Milo Gjukanović, i cili konsiderohet si një nga udhëheqësit politik të Ballkanit perëndimor me kohëzgjatje më të madhe të mbajtjes së pushtetit. Presidenti:

- Përfaqëson Malin e Zi në vend dhe jashtë
- Shpall ligjet
- Shpall zgjedhje parlamentare
- Propozon në Parlament një kandidat për Kryeministër, si dhe për presidentin dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese
- Propozon mbajtjen e referendumit
- Jep falje
- Jep nderime dhe dekorata

Qeveria e Malit të Zi emërohet me shumicën e votave të Parlamentit. Qeveria:

- Formulon dhe zhvillon politikën e jashtme
- Miraton dekrete dhe rregullore të tjera
- Zbaton ligjet
- Përfundon traktatet ndërkombëtare
- Vendos organizimin dhe mënyrën e funksionimit të administratës qeveritare
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara në Kushtetutë

Kryeministri i Malit të Zi drejton punën e Qeverisë dhe i paraqet Parlamentit Programin e Qeverisë duke përfshirë një listë të ministrave të propozuar. Dorëheqja e Kryeministrit shkakton rënien e Qeverisë.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2020 në Malin e Zi ishin konkurruese dhe u zhvilluan në një mjedis shumë të polarizuar për çështjet e kishës dhe identitetit kombëtar. Garuesit ishin në gjendje të përçonin mesazhet e tyre por partia në pushtet fitoi një avantazh të padrejtë përmes keqpërdorimit të detyrës dhe burimeve shtetërore, dhe mbulimit mbizotërues të medimeve.

Këto janë disa nga konkluzionet kryesore nga raporti përfundimtar mbi zgjedhjet parlamentare të Malit të Zi të 30 gushtit 2020, botuar më 11 dhjetor 2020 nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR, 2020).

Raporti ofron 23 rekomandime për të përmirësuar zhvillimin e zgjedhjeve dhe për t'i sjellë ato plotësisht në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe standardet tjera ndërkombëtare. Rekomandimet kryesore përfshijnë:

- kryerjen e një reforme gjithëpërfshirëse për të harmonizuar kornizën ligjore zgjedhore dhe për të rregulluar të gjitha aspektet kryesore të zgjedhjeve
- zbatimin e vendimeve të qarta, të qëndrueshme, në kohë dhe plotësisht të zbatueshme brenda mandatit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve
- rishikimin e kapacitetit ligjor dhe kërkesat e qëndrimit për të votuar dhe kandiduar për zgjedhje
- futja e sanksioneve efektive dhe proporcionale dhe një detyrim i qartë i organit mbikëqyrës për të identifikuar dhe publikuar informacionin mbi pasaktësitë, përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e pa-raportuara.
- rishikimi i dispozitave për sfidimin dhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe përshkrimin e vendimeve për rezultatet paraprake mund të apelojnë, duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese.

Duhet të potencohet fakti se Mali i Zi për herë të parë pas rreth 30 viteve do të udhëhiqet nga një parti apo koalicion tjetër, ndryshe nga ai të cilin malazezët e kanë pasur në të kaluarën, i cili udhëhiqej nga Milo Gjukanović, presidenti aktual i Malit të Zi, me jetëgjatësinë më të madhe politike në Ballkan, gjë e cila tani do të krijojë një tërmet politik, pasi që qeveria e re vazhdimisht po ngre akuza për korrupsion dhe keqpërdorime për ish-pushtetmbajtësit.

4.6 Bosnja e Hercegovina

Politika e Bosnje dhe Hercegovinës zhvillohet në një kornizë të një demokracie përfaqësuese parlamentare, përmes së cilës pushteti ekzekutiv ushtrohet nga Këshilli i Ministrave. Fuqia legjislative i është dhënë edhe Këshillit të Ministrave edhe Asamblesë Parlamentare të Bosnjës dhe Hercegovinës. Anëtarët e Asamblesë Parlamentare zgjidhen sipas një sistemi proporcional të përfaqësimit.

Sistemi i qeverisjes i vendosur nga Marrëveshja e Dejtonit është një shembull i konsocializmit, pasi përfaqësimi është nga elitat që përfaqësojnë tre grupet kryesore etnike të vendit të quajtur popuj përbërës, me secilin që ka një pjesë të garantuar të pushtetit.

Bosnja dhe Hercegovina është e ndarë në dy njësi - Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republika Srpska, të cilat janë politikisht autonome deri në një farë mase, si dhe Rajoni Brčko, i cili administrohet bashkërisht nga të dyja.

Kryesimi i Presidencës së Bosnjë dhe Hercegovinës kryhet me rotacion midis tre anëtarëve (një Boshnjak, një Serb dhe një Kroat), në çdo 8 muaj brenda mandatit të tyre 4-vjeçar. Të tre anëtarët e Presidencës zgjidhen drejtpërdrejt nga populli, me votuesit e Federatës që zgjedhin anëtarin boshnjak dhe atë kroat, dhe votuesit e Republika Srpska që zgjedhin anëtarin serb. Presidenca shërben si një kryetar shteti. Presidenca është kryesisht përgjegjëse për politikën e jashtme dhe propozimin e buxhetit. Ajo gjithashtu emëron kryeministrin, i cili më pas miratohet nga Dhoma e Përfaqësuesve.

Raporti përfundimtar nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR, 2018) mbi zgjedhjet e përgjithshme të 7 tetorit 2018 në Bosnjë dhe Hercegovinë thekson mungesën e ndjekjes së duhur të vlerësimeve të mëparshme të lidhura me zgjedhjet e ODIHR dhe rekomandon një rishikim gjithëpërfshirës të legjislacionit për parandalim me abuzimin e burimeve publike për qëllime fushate.

Raporti gjithashtu rekomandon heqjen e kufizimeve etnike diskriminuese dhe të bazuara në vendbanime të së drejtës për të dalë në zgjedhje, në përputhje me angazhimet e

OSBE-së dhe detyrime të tjera ndërkombëtare, si dhe gjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ndërsa pranon efikasitetin e përgjithshëm të administratës zgjedhore, raporti inkurajon rishikimin e mënyrës së formimit të komisioneve të qendrave të votimit, për të siguruar paanësinë e tyre. Raporti gjithashtu rekomandon sigurimin e burimeve të përshtatshme për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe forcimin e metodave të rekrutimit dhe trajnimit për të siguruar profesionalizmin e nevojshëm të organeve të menaxhimit të zgjedhjeve.

Raporti inkurajon partitë politike të ndjekin ligjin dhe të përmbahen nga ushtrimi i presionit mbi votuesit. Ai u bën thirrje autoriteteve të hetojnë pretendimet e shkeljeve zgjedhore menjëherë, me hollësi dhe në mënyrë efektive, dhe t'i mbajnë përgjegjësit e tyre.

Raporti rekomandon një rishikim të procedurave të votimit për të garantuar plotësisht lirinë dhe fshehtësinë e zgjedhjeve të votuesve. Ai gjithashtu vë në dukje një nevojë për të rritur programet e edukimit të votuesve, duke përfshirë parandalimin e votimit familjar dhe votimin e parregullt të asistuar dhe inkurajon autoritetet të sigurojnë që qendrat e votimit të jenë plotësisht të arritshme për personat me aftësi të kufizuara.

Raporti bën thirrje për transparencë dhe përgjegjshmëri më të madhe të financave të fushatës dhe rekomandon që llogari specifike bankare të përdoren për të gjitha aktivitetet e financimit të fushatës. Më tej rekomandon futjen e sanksioneve proporcionale dhe dekurajuese për shkeljet financiare.

Bosnja dhe Hercegovina është shembulli më i mirë i mos-funksionimit të një sistemi politik, dhe shoqërie multi-etnike, pasi që lufta kryesore në arenën politike bëhet për të forcuar pozicionet brenda pushtetit dhe jo për të shërbyer për një shoqëri më të mirë. Ky mosfunksionim i sistemit vërehet edhe në raportet e mësipërme midis entiteteve të ndara në baza etnike.

KAPITULLI 5 - ROLI I LIDERËVE POLITIK AKTUAL NË PROCESIN EURO-INTEGRUES TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Bazuar në literaturë, udhëheqësit përfaqësojnë faktorin më të rëndësishëm në zhvillimin e një shoqërie. Zhvillimi i ekonomisë dhe shoqërisë së një vendi varet nga iniciativa dhe aktiviteti i tyre, gatishmëria dhe vendosmëria e tyre për të ecur përpara, edhe kur vendimet e tyre ndonjëherë duket se gjenerojnë pakënaqësi, e cila mund të rezultojë me humbjen e mbështetjes. Shumë nga problemet në shoqëri sot janë pjesërisht rezultat i lidërshiptit të papërgatitur për t'u përballur me ndërlidhjet e realitetit të sotëm (Koleci, 2019). Lidhjet moderne të udhëheqjes zakonisht bazohen në modele politike ushtarake ose të mëparshme. Zakonisht aftësitë e një udhëheqësi kërkojnë në kohë vështirësie ose kur qëllimet ndryshojnë ose thellohen. Nëse asgjë nuk po ndryshon, atëherë kërkojnë mbikëqyrje, dhe jo udhëheqje. Për tre dekadat e fundit, udhëheqësit ballkanikë kanë ngritur reputacionin e tyre midis mbështetësve të tyre me retorikë nacionaliste, e cila shumicën e kohës krijoi boshllëqe shtesë midis pjesëve të kundërta.

Politika kërkon pasion dhe perspektivë. Sigurisht, e gjithë përvoja historike konfirmon të vërtetën - se njerëzimi nuk do ta kuptonte të mundshmen nëse nuk do të kërkonte të pamundurën. Por për ta bërë këtë, duhet të jesh një udhëheqës, jo vetëm një udhëheqës, por edhe një hero, në kuptimin e plotë të fjalës (Weber, 1919). Edhe ata që nuk janë as udhëheqës dhe as heronj kanë nevojë të pajisen me durimin e zemrës, e cila mund të trimërojë edhe shpresat e thyera. Kjo është e nevojshme tani ose përndryshe njerëzit nuk do të jenë në gjendje të arrijnë as atë që është e mundur sot.

Një nga karakteristikat e tranzicionit politik në Ballkan është natyra specifike e udhëheqësve të saj. Disa prej tyre ishin në pushtet në prag të kolapsit Jugosllav, disa të tjerë morën detyrën menjëherë pas. Por të gjithë ata e pranuan sfidën për të lëvizur nga pozicionet e tyre të mëparshme politike dhe premtuan të ndërmarrin - ose, të paktën, dukej se e bënin këtë - procesin e demokratizimit dhe rrugën e BE-së. Për ta kuptuar më mirë këtë transformim, mjafton të merren parasysh disa nga liderët politik të vendeve të rajonit.

Aleksandar Vučić, ish sekretar i përgjithshëm i Partisë nacionaliste Radikale Serbe dhe Ministër i Informacionit në administratën e Millosheviçit - kur u vranë gazetarë dhe disidentë - tani është udhëheqësi i Partisë Progresive Serbe pro-Evropiane. Milo Gjukanoviç, i cili ka drejtuar Malin e Zi që nga viti 1991 e deri në vitin 2020, qoftë si kryeministër ose si president, ishte së pari një aleat i Slllobodan Millosheviçit, që më pastaj të bëhet kundërshtari i tij; ai përdori identitetin kombëtar malazez dhe paraqitet si një socialdemokrat me një orientim evropian. Po aq transformues, megjithëse në një mënyrë tjetër, është Milorad Dodik, një ish kundërshtar i Partisë Demokratike Serbe që kishte përgjegjësi politike për luftën në Bosnjë. Në 2006 Dodik mori detyrën si kryeministër i entitetit serb të Bosnjës (Republika Srpska) si një reformator i moderuar por gradualisht u shndërrua në një nacionalist i vijës së ashpër.

Transformimi i këtyre udhëheqësve reflekton legjitimitetin dhe miratimin që ata kanë kërkuar nga Perëndimi, në vend se një ndryshim të mirëfilltë. Përderisa BE dhe institucionet perëndimore kërkonin politikanë pragmatikë që mund të bënin reforma, udhëheqësit nga Ballkani gëzuan statusin e tyre të ri si garantues të stabilitetit politik në rajon dhe fituan legjitimitetin e jashtëm.

Me fjalë të tjera, sa më shumë që një qeveri angazhohet nga jashtë për BE-në, aq më shumë perëndimi do ta mbështesë atë. Stabiliteti i arritur është kështu mungesa e ndryshimit të regjimit në të cilin qeveria lokale mban rrugën e BE-së si një synim në politikën e jashtme, dhe - në këmbim - BE-ja mbyll sytë ndaj brishtësisë së sistemit të saj demokratik. Stabiliteti politik bëhet një dogmë, pasi ndryshimet e regjimit përjashtohen nga loja. Prandaj, në vend të një tranzicioni të mirëfilltë drejt konsolidimit të demokracisë, shumë vende në rajon kanë zhvilluar një model autoritar të maskuar me pranimin e "vlerave perëndimore". Vlerat perëndimore shfrytëzohen për të mbajtur marrëdhënie të forta dhe legjitimitet nga institucionet e BE-së, kushtëzimi i dështuar i të cilave po zgjat tranzicionin e Ballkanit. Rasti më i keq është Serbia, pasi dobësimi i institucioneve të saj demokratike është i tillë që raporti i fundit nga Freedom House e vendosi vendin në dhjetë rëniet më të këqija 10-vjeçare të demokracisë në botë.

Shumë vende të rajonit, e në veçanti Serbia, janë duke shfrytëzuar pandeminë për të forcuar fuqitë e qeverisë, për të zvogëluar ato të parlamenteve, për të imponuar mbikëqyrje

masive dhe për të kufizuar punën e mediumeve të pavarura në përpjekje për të krahasuar përhapjen e "lajmeve të rreme". Në fakt, kur gjendja e jashtëzakonshme do të hiqet, do të ishte e vështirë të shihet rivendosja e të gjitha lirive të kufizuara individuale nga qeveritë me tendenca autokratike.

Pra, *stabilitokratët* ishin në gjendje të kapnin imagjinatën e politikë-bërësve perëndimorë duke u portretizuar si reformatorë pragmatikë relativisht të rinj. Ky është rasti i Presidentit Serb Aleksandar Vuçiç, ish Kryeministrit maqedonas Nikola Gruevski, anëtarit serb të Presidencës Boshnjake Milorad Dodik dhe Presidentit të Malit të Zi Milo Gjukanoviç. Ngjitja e këtyre personazheve në pushtet u prit kështu me miratim në mediumet dhe qeveritë perëndimore. Prandaj, aftësia për të siguruar legjitimitet të brendshëm dhe të jashtëm u bë thelbësore për *stabilitokracitë*.

Të gjithë udhëheqësit e lartpërmendur kanë zbutur retorikën e tyre dhe kanë përshtatur politikën e tyre në dritën e ndryshimeve socio-politike që ndodhën nga vitet 1990 deri më sot. Në jetën e tyre politike, ata të gjithë kanë qenë ekstremistë dhe të moderuar; progresivë dhe konservatorë; nacionalistë dhe pro-evropianë. Në mënyrë që të merrnin miratimin nga kabinetet perëndimore, ata të gjithë pretendonin se i janë përkushtuar rrugës për në BE: ata duken pragmatikë dhe reformistë, por, përkundër pamjes së tyre të re, ata kurrë nuk ndryshuan vërtet. Si rezultat, kjo rrugë e dyanshme ku BE dhe qeveritë lokale ushqehen me njëri-tjetrin prodhon një situatë ku sa më shumë *stabilitetokracia* të vazhdojë, aq më pak vendi do të jetë i qëndrueshëm. Në fakt, i vetmi stabilizim i arritur është vazhdimi i sundimit të së njëjtës parti, një garanci për Perëndimin, e cila do të vazhdojë të mbështesë sundimtarët që mbajnë orientimin pro-evropian të qeverisë.

Më në fund, duhet të ceket edhe se këto udhëheqës ndjekin një pakt shoqëror që nuk bazohet vetëm në premtimet e BE-së, por edhe në interesin e kombit, duke fituar kështu mbështetjen nga elementët konservatorë të shoqërisë që ende lëvizin lehtësisht nga retorika nacionaliste (Fruscione, 2020).

Në debatet aktuale mbi të ardhmen e BE, është e qartë se BE nuk do të jetë e plotë, as plotësisht e integruar, elastike dhe e prosperuar pa vendet e Ballkanit Perëndimor. Integrimi i

plotë i Ballkanit Perëndimor në BE sjell zgjidhje më efektive dhe efikase dhe një të ardhme më të sigurt dhe më të parashikueshme për të gjithë.

Politika e integritit në BE e vendeve të Ballkanit Perëndimor ka arritur në udhëkryq. Pavarësisht zotimit nga vendet anëtare të BE në Samitin e Selanikut se të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një perspektivë të anëtarësimit në BE, vetëm Kroacia arriti të bëhet pjesë e Unionit në vitin 2013. Komunikimi i Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor nga 2018 inkurajoi edhe një herë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe u siguroi atyre një skenar të mundshëm të pranimit në BE, por doli se kjo perspektivë ishte joreale. Vendimi i Këshillit Evropian në tetor 2019 për të mos hapur negociatat e pranimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut ka njollosur besueshmërinë e BE-së, ka minuar besimin dhe ka vënë në pritje të gjithë perspektivën e integritit.

Ngecja aktuale në procesin e pranimit në BE ka të bëjë më pak me kornizën e zgjerimit sesa me mungesën e vullnetit politik si të qeverive në rajon ashtu edhe të vendeve anëtare të BE-së. Sidoqoftë, mungesa e konsensusit për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut dhe debati që rezulton në lidhje me mekanizmin e zgjerimit ofrojnë një mundësi unike për të vlerësuar këtë proces dhe për të ofruar propozime për përmirësimin e tij. Një krizë krijon mundësi për ndryshim dhe një “krizë e mirë” mund të shpie në përmirësimin thelbësor të procesit të integritit në BE të Ballkanit Perëndimor.

Nga ana tjetër, strategjia e Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor nga shkurti i 2018 njohu që ekzistojnë "elementë të kapjes së shtetit" në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Raportet e vendit të Komisionit Evropian, veçanërisht ato për Serbinë dhe Malin e Zi, shprehin shqetësime të rëndësishme për sundimin e ligjit dhe lirinë e medimeve. Sidoqoftë, institucionet evropiane mbeten të ndrojtura kur bëhet fjalë për identifikimin e shembujve konkretë të kapjes së shtetit dhe kapjes së medimeve, gjë që lejon qeveritë e Ballkanit Perëndimor të injorojnë kritika të tilla.

Mosmarrëveshjet bilaterale përfaqësojnë një pengesë të rëndësishme për pranimin në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo vlen për të dy mosmarrëveshjet midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve fqinje anëtare të

BE-së. Ekzistojnë tashmë shembuj të pasojave serioze negative të këtyre mosmarrëveshjeve për pranimin në BE të vendeve në rajon dhe pritet që kjo të ndodhë edhe në të ardhmen.

5.1. Zgjidhja e kontestit të emrit mes Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë

Sot, udhëheqësit politik në vendet në tranzicion përballen me kriza të vazhdueshme ekonomike dhe sociale, siguri dhe pasiguri politike, siç është rasti me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kriza politike ka prekur rëndë ekonominë e vendit, marrëdhëniet ndëretnike dhe reputacionin ndërkombëtar. Ngecja e investimeve të huaja direkte është e dukshme, pasi investorët e huaj kërkojnë gjithmonë stabilitet politik dhe sigurim për investimet e tyre. Nuk duhet harruar sundimi i ligjit, i cili, sipas disa hulumtimeve të mëparshme të opinionit publik, është më meritori për situatën dhe ndërlikimet e krijuara në procesin euro-integrues të vendit. Gjyqësori në Republikën e Maqedonisë së Veriut shihet si një nga hallkat më të dobëta në vend, duke krijuar mosbesim dhe pakënaqësi te qytetarët e saj me mungesë të efikasitetit, gjykime të pafund dhe shumë vendime të diskutueshme, të cilat shpesh shiheshin si mbrojtëse ndaj zyrtarëve të qeverisë dhe atyre që janë në pushtet. Si pasojë, profesionistët e rinj dhe të arsimuar po largohen nga vendi në kërkim të pagave dhe sigurisë më të mirë, për shkak të mungesës së perspektivës dhe dështimit të qeverive të kaluara për t'i mbajtur ata në vend dhe për t'u ofruar atyre trajtim të barabartë.

Marrëveshja e Prespës është përshkruar nga shumë diplomatë si një kryevepër diplomatike që do të hyjë në histori sepse për herë të parë për një çështje bilaterale në Ballkan kishte një vullnet politik për të mposhtur nacionalizmin nga të dy palët. Përmes kësaj marrëveshjeje, Greqia dhe Maqedonia e Veriut vendosën të investojnë në miqësi, bashkëpunim dhe solidaritet dhe të japin një shembull jo vetëm për Ballkanin dhe Evropën, por për të gjithë botën. Por cilat ishin arsyet që i bënë të dy udhëheqësit të arrijnë një marrëveshje për mosmarrëveshjen e gjatë, e cila krijoi shumë debate të ashpra midis politikanëve, akademikëve, qytetarëve, si dhe udhëheqësve.

Studimet e mëparshme mbi mosmarrëveshjen e çështjes së emrit midis dy vendeve të Ballkanit kanë treguar se si politikatat e jashtme mund të ndryshojnë me kohën kur ka çështje më të mëdha për t'u trajtuar. Në rastin e Greqisë, sondazhe të ndryshme treguan se opinionin publik grek është zbutur dhe se preferencat e brendshme kanë ndryshuar. Kjo pasqyrohet nga më pak

kufizime në kursin e politikës së jashtme të qeverisë në mosmarrëveshje. Zbutja e qëndrimit publik mund të ketë të bëjë gjithashtu me shfaqjen e burimeve ose ngjarjeve të tjera që rrisin prestigjin kombëtar grek, ndjenjën e dallimit të të ndjerit mirë dhe më të sigurt. Bashkimi Evropian ka derdhur miliarda Euro në subvencione duke rritur cilësinë e përgjithshme të jetës dhe duke iu përgjigjur me vendosmëri pyetjes publike dikur të ngutshme ekzistencialiste se ku përkiste Greqia kulturisht (Kostovilis, 2005). Gjithashtu, kriza ekonomike që goditi Greqinë gjatë viteve të kaluara ka bërë që shumë politikanë të dhathtë të kalojnë në udhëheqës të moderuar, të cilët janë të gatshëm të mbajnë lidhjet e tyre me vendet që ndihmojnë Greqinë të kapërcejë shifrat e bilancit negativ. Fqinjët e tyre veriorë u goditën gjithashtu nga disa pasiguri dhe konflikte të brendshme, të cilat minuan përpjekjet e vendit drejt stabilizimit dhe prosperitetit ekonomik. Më në fund, ai që dukej të ishte një kompromis i pamundur midis udhëheqësve nacionalistë, u shkatërrua përpara sfidave të reja ekonomike dhe politike me të cilat përballen liderët e të dy vendeve.

Kronologjikisht, çështja e emrit midis Maqedonisë dhe Greqisë ka kaluar nëpër disa faza. Faza e parë vazhdoi midis 1991, kur u krijua shteti modern maqedonas dhe 1995, kur u nënshkrua Marrëveshja e Përkohshme në KB midis dy shteteve. Faza e dytë zgjati nga 1995 deri në Samitin e NATO-s 2008 në Bukuresht që adresoi çështjen e zgjerimit të NATO-s. Së fundmi, faza e tretë është e fundit (Frckoski, 2009). Për më tepër, ajo është emëruar si një mosmarrëveshje mbi pronësinë e pasurisë kulturore në të cilën secili prej dy vendeve është përpjekur të vendosë një markë tregtare në atë që e konsideron si emrin e saj, emblemat e saj kombëtare dhe paraardhësit e saj të famshëm. Meqenëse kultura e një shteti është po aq posedim i tij sa territori i tij, përvetësimi i kësaj kulture nga një vend tjetër është interpretuar si një kërcënim për integritetin kombëtar. Thelbësore për të rënë dakord mbi vetë statusin e emrit të kontestuar të tokës dhe njerëzve të saj duket se është një produkt i përdorimit të kriterëve krejtësisht të ndryshme në përcaktimin e termave themelorë: për Greqinë, fjala "Maqedoni" dhe të gjitha ato që simbolizon vazhdimësia kulturore është çështja kritike (Flouda, 2002).

Përkundër çështjes së emrit me Greqinë, Republika e Maqedonisë së Veriut u përball me disa kriza që provuan seriozisht bazat e shtetit në dimensione të ndryshme. Ndërsa konflikti i armatosur i vitit 2001 u duk se ishte provë e stabilitetit në aspektin e sigurisë dhe vlerave themelore demokratike, e fundit ishte një provë e vërtetë për besueshmërinë e drejtësisë dhe qeverisë. Publikimi i mijëra materialeve të përgjimit të paligjshëm të lidhur me korrupsionin, abuzimin e pushtetit dhe fshehjen e krimeve nga zyrtarët e shtetit, krijuan një pikëpyetje të madhe se kush kontrollon kë në vend. Opozita ishte e vendosur në zbulimin e këtyre materialeve duke i prezantuar ato në media, pa sqaruar qartë se si i morën përgjimet e paligjshme. Nga ana tjetër, VMRO qeverisëse akuzoi opozitën që po bashkëpunonte me fuqitë e jashtme, të cilët dëshironin që qeveria "patriotike" të zhdukej.

Për më tepër, protestat në Maqedoni u bënë pjesë e jetës së përditshme, ku në Shkup për muaj me radhë pothuajse çdo ditë kishte protesta duke filluar nga ato të studentëve te ato të gjyqësorit dhe punonjësve të tjerë të shtetit. Dy protesta të mëdha u zhvilluan në Shkup, me njërin nga opozitat që kërkonte dorëheqjen e qeverisë dhe tjetra mbështeste qeverinë. Si pjesë e këtyre protestave, mbështetësit e opozitës vazhduan protestën për ditë me radhë duke ngritur kampin para ndërtesës së qeverisë, ku në përgjigje të kësaj, mbështetësit e qeverisë gjithashtu ngritën kampin para ndërtesës së Kuvendit. Kjo situatë e trazuar në vend bëri që partitë kryesore politike të bënin lëvizje të papritura të cilat shpesh shiheshin me mosbesim nga qytetarët.

Nëse marrim parasysh faktin që shumica e qytetarëve në të dy vendet ishin kundër arritjes së një marrëveshjeje që do të kërkonte kompromis, veprimi i ndërmarrë nga të dy krerët e qeverisë ishte një hap shumë i guximshëm. Një sondazh i organizuar nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis" Shkup (MCIC, 2018), në 2018 tregoi se një në dy shtetas (47.1%) kundërshtonte çdo ndryshim të emrit. Shumica e maqedonasve etnikë (59.6%) ishin pro mos-ndryshimit, ndërsa mendimi i shqiptarëve etnikë në vend ishte në favor të ndryshimit të emrit të shtetit, duke hequr kështu pengesën e vetme që procesi i integritit evropian të bëhet realitet në vend. Hendeku midis maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve etnikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut ishte i

dukshëm dhe i pritshëm, pasi që shqiptarët etnikë nuk janë të lidhur emocionalisht me çështjen e emrit siç janë bashkëqytetarët e tyre maqedonas. Për më tepër, duke analizuar rezultatin e këtij sondazhi të kryer ne mund të shohim se 41.7% e qytetarëve deklaruan se nuk do të votonin për partinë që do të zgjidhë mosmarrëveshjen për emrin, ndërsa vetëm 36% deklaruan se do t'i jepnin mbështetje asaj force politike. (MCMS, 2018) Nëse marrim parasysh rezultatet e paraqitura të sondazhit, të cilat nuk ishin aq të ndryshme nga sondazhet e tjera që u bënë gjatë viteve në lidhje me çështjen e emrit, duke hedhur një hap përpara në zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje, u pa si vetëvrasje politike për çdo politikan që do të guxojë ta bëjë këtë.

Në fund të shtatorit 2018, qeveria maqedonase organizoi një referendum në të cilin shtetasit maqedonas hodhën votat e tyre nëse janë për bashkimin me integrimet euroatlantike apo kundër. Partia kryesore e opozitës maqedonase (VMRO DPMNE) si dhe Presidenti i Maqedonisë Gjorge Ivanov (i cili u zgjodh si kandidat i VMRO gjatë zgjedhjeve të mëparshme Presidenciale) bëri thirrje për bojkot të referendumit. Gjithashtu organizata të ndryshme civile anti-Atlantike me sfond pro-serb dhe pro-rus organizuan marshime kundër ndryshimit të emrit.

Referendumi u mbështet nga Kryeministri dhe partia e tij (LSDM) si dhe nga të gjitha partitë etnike shqiptare në Maqedoninë e Veriut. Kryeministri maqedonas Zoran Zaev dhe koalicioni qeveritar filluan një fushatë në internet për një votë "Po" në referendum. Referendumi nga natyra e tij ishte jo-detyrues. Komuniteti ndërkombëtar ishte gjithashtu në mbështetje të rezultatit pozitiv të Referendumit, pasi e kundërta do të thotë një goditje e madhe ndaj aspiratave Euro-Atlantike të vendit dhe një hap prapa nga Marrëveshja e Prespës.

Në mbështetje të qeverisë aktuale maqedonase, shumë zyrtarë dhe diplomatë të rangut të lartë politik vizituan vendin dhe nxitën politikanët pro-perëndimorë të vazhdojnë drejt rrugës së integritit Euro-Atlantik. Për më tepër, Presidenti i Shqipërisë dhe udhëheqja qeveritare e vendit u kërkuan shqiptarëve etnikë në Maqedoni të mbështesin votën "Po" në referendumin e ardhshëm. Kjo rezultoi me mbështetjen e gjerë të votës "Po" nga të gjithë liderët e shqiptarëve etnikë në Maqedoni, ndër të cilët ishin kreu i Bashkimit Demokratik për Integrim Ali Ahmeti dhe kreu i Partisë Demokratike të Shqiptarëve Menduh Thaçi. Përkundër faktit se 94% e votuesve votuan pro, pjesëmarrja në votime ishte më pak se pragu prej 50 për qind i kërkuar për të

vërtetuar rezultatet. Si opozita ashtu edhe qeveria pretenduan fitoren, me opozitën që pretendonte se propozimi ishte refuzuar për shkak të pjesëmarrjes së ulët ndërsa qeveria argumentoi që rezultati të ishte jo-detyrues e që do të thoshte se kërkesa për pjesëmarrje ishte e parëndësishme. Përsëri, ajo luajti një rol të madh në përcaktimin e ndryshimit të emrit ku u pa se gati 60 për qind e popullsisë mbështeti ndryshimin e emrit, duke mos përfshirë ata që ishin jashtë vendit, pasi Maqedonia ka pasur një problem të madh me migrimin posaçërisht në dy vitet e fundit. Për më tepër, forcat politike shqiptare në Maqedoninë e Veriut luajtën një rol thelbësor në çuarjen përpara të interesit kombëtar të vendit të tyre në të gjitha zhvillimet kryesore. Duhet të theksohet se ata ishin forca lëvizëse në Maqedoninë e Veriut që kërkonte vazhdimisht të zgjidhej çështja e emrit me Greqinë. Ndoshta kjo ishte për shkak se ata nuk mbanin barrën e nacionalizmit të lidhur me emrin e vendit, por përkundrazi ata pasqyruan vazhdimisht dëshirën për t'u bashkuar me strukturat Euro-Atlantike si qëllimin e tyre kryesor politik. Prandaj, me një përqindje shumë të lartë të votave pro-shqiptare në referendumin e fundit dhe votën historike në parlament për Marrëveshjen e Prespës, ata dhanë kontributin e tyre për të bërë të mundur që Maqedonia e Veriut të bashkohej me NATO dhe të hapte negociatat me Bashkimin Evropian.

Nëse analizojmë zhvillimet e sipërpërmendura, duhet t'i japim vlerësim rolit të liderëve politikë në arritjen e marrëveshjes së Prespës, e cila përfundoi mosmarrëveshjen e 3 dekadave për emrin. Ata vepruan si udhëheqës vizionarë dhe morën vendime të vështira për të ardhmen më të mirë të njerëzve të tyre, edhe pse ata u kundërshtuan për të njëjtën gjë nga një përqindje e madhe e qytetarëve të tyre. Përsëri, ata u kujdesën më pak për vlerësimet e tyre dhe bënë një hap të madh përpara.

Një arsye tjetër e fortë pas këtij sukse si diplomatik është vendosmëria e bllokut etnik shqiptar prapa kauzës së integritetit evropian dhe kërkesa e tyre për një marrëveshje e cila do t'i hapte rrugë një gjëje të tillë. Në shikim të parë, kjo nuk duket të jetë e rëndësishme, por partitë shqiptare ishin faktori kryesor që dërgoi VMRO-në në opozitë sepse ata u bashkuan me bashkësinë ndërkombëtare dhe refuzuan të formonin një qeveri me VMRO-në, e cila kishte fituar zgjedhjet parlamentare, por sepse ajo kishte humbur mbështetjen ndërkombëtare falë

nacionalizmit të saj të tepruar dhe armiqësor ndaj Greqisë, ajo u la vetëm. Kjo është arsyeja pse kryeministri i ri i Maqedonisë së Veriut nuk do të rrezikonte marrëdhëniet e tij me partitë shqiptare, pasi pa mbështetjen e tyre ai nuk do të kishte qenë në gjendje të formonte një qeveri. Kjo përshkruhet më së miri nga të dhënat paraprake nga hulumtimi i gjendjes shpirtërore të qytetarëve për ndryshimin e emrit, të cilin shqiptarët e mbështetën bindshëm dhe i dhanë krahë kësaj ideje.

Në fund të fundit, nuk duhet të harrojmë se çështjet e sigurisë, të shoqëruara nga probleme ekonomike dhe politike në Maqedoni dhe Greqi, bënë një presion shtesë ndaj udhëheqësve politikë të të dy vendeve, gjë që rezultoi me mbylljen e një marrëveshjeje dhe lënien pas një mosmarrëveshjeje të zgjatur që bllokuan mundësitë për një të ardhme më të mirë dhe më të prosperuar. Gjithashtu, retorika nacionaliste, e cila u dha pushtet liderëve populistë në Ballkan gjatë tre dekadave të fundit, u shemb përpara guximit dhe vendosmërisë së epokës së re të liderëve politikë, të cilët janë globalisht të lidhur dhe të orientuar drejt formulave të drejtuara nga suksesi. Për më tepër, në epokën e teknologjisë dhe informacionit, udhëheqësit politikë janë në vijën e frontit të të gjitha zhvillimeve politike dhe duhet të veprojnë si zgjidhës të problemeve në mënyrë që të krijojnë një shoqëri më të mirë për qytetarët e tyre, një vlerë që me kohën do t'u japë atyre mbështetjen e nevojshme për mbijetesën e politikave të tyre.

KAPITULLI 6 - NDIKIMI I FAKTORIT NDËRKOMBËTAR MBI LIDERSHIPIN POLITIK NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Roli i faktorit ndërkombëtar dhe përpjekjet e tyre për të zbutur krizën politike duhet të merren gjithashtu parasysh, pasi ata luajnë një rol të rëndësishëm në sjelljen e liderëve rajonalë, veçanërisht për ata vendet e të cilëve aplikojnë për proceset e euro-integritimit. Në këtë kontekst, qëllimi i punimit është të identifikojë faktorët kryesorë që luajtën një rol të rëndësishëm në arritjen e marrëveshjes politike midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë në lidhje me çështjen e emrit, implikimet e mëtejshme që dolën si rezultat i kësaj marrëveshjeje dhe të ardhmen apo perspektivat e vendeve në rajon.

Pas gjithë këtyre zhvillimeve në Maqedoni, zyrtarët e BE u takuan me udhëheqësit politikë të vendit për të kapërcyer krizën dhe për ta çuar qeverinë drejt rrugës së BE. Në bisedime, të ndërmjetësuara nga bashkësia ndërkombëtare, morën pjesë udhëheqësit politikë kryesorë të partisë, të cilët ranë dakord të ktheheshin në parlament dhe të mos botonin përgjime për opinionin publik. Për më tepër, ata gjithashtu arritën marrëveshje për të caktuar prokurorë specialë, të cilët do të hetojnë zyrtarët e lidhur me materialet e përgjuara të paligjshme, si dhe për të formuar një qeveri të përkohshme që do ta çojë vendin në zgjedhje të parakohshme.

Kriza në vend u rishfaq pasi Presidenti, Gjorge Ivanov, duke përdorur të drejtën e tij kushtetuese, vendosi të ndalojë procedurat ligjore të filluara kundër politikanëve në vend për zgjidhjen e krizës politike në Maqedoni. Ky vendim krijoi tensione shtesë politike dhe qytetarët përsëri u mbledhën për të protestuar ndaj vendimit të Ivanov, me qytetarët që marshuan së pari në ndërtesën e zyrës së prokurorit ku po zhvillohej hetimi dhe më pas në zyrën presidenciale. Këto protesta u përshkallëzuan dhe u bënë të dhunshme, duke thelluar krizën politike dhe duke dëmtuar imazhin ndërkombëtar të vendit.

Në këtë drejtim, anëtarët e Parlamentit Evropian reaguesh për ndaj vendimit të Presidentit Ivanov, duke thënë se vendimi përbën një rrezik shtesë për stabilitetin e vendit dhe integritimin Euro-Atlantik, dhe bëri thirrje që marrëveshja të respektohet dhe zgjedhjet të

mbahen në mënyrë të sigurt. Për më tepër, Departamenti i Shtetit i ShBA në një deklaratë tha se ShBA kanë shqetësime të thella për vendimin e marrë nga Presidenti Ivanov, i cili nëse zbatohet, do të mbrojë politikanët e përfshirë në krime dhe gjithashtu do të jetë një pengesë për drejtësinë që meritojnë qytetarët e Maqedonisë. Për më tepër, deklarata thoshte se ky vendim "do të dëmtojë më tej sundimin e ligjit në Maqedoni, integritetin e institucioneve të saj gjyqësore dhe besueshmërinë e angazhimit të udhëheqësve të saj ndaj vlerave themelore të NATO-s dhe Bashkimit Evropian". (Departamenti i Shtetit i ShBA, 2016)

Ajo që dukej një shumicë e qëndrueshme për VMRO, një parti e orientuar nga e djathta që po drejtonte vendin që nga 2006, u shemb përpara presionit të imponuar nga zyrtarët e BE dhe ShBA, kryesisht për shkak të retorikës së saj nacionaliste dhe populiste, deklarata që po e largonin vendin nga Integrimi Euro-Atlantik dhe po provokonin Greqinë, duke e bërë kështu zgjidhjen e mosmarrëveshjes për emrin pothuajse të pamundur. Ky tranzicion u pasua nga Zyra e Prokurorisë Speciale e sapokrijuar, e mbështetur nga BE dhe ShBA., misioni kryesor i të cilave ishte të hetonte materialet e marra në mënyrë të paligjshme të regjistruar dhe të sillte para drejtësisë zyrtarët e përfshirë qeveritarë. Si rezultat i këtyre hetimeve, shumë zyrtarë të VMRO-së u sollën para gjykatës, duke përfshirë ish-Kryeministrin e Maqedonisë Nikolla Gruevski, i cili më vonë u arratis dhe mbetet ende në mërgim.

Duke marrë parasysh këtë, në një botim të fundit në lidhje me procesin e negociatave, ndërmjetësi Mathew Nimetz në analizën e tij tha si vijon: "Suksesi që u arrit në të dy vendet, duhet të pranohet, ishte i mundur vetëm për shkak të udhëheqjes efektive politike dhe mobilizimit të mbështetjes. Sipas mendimit të shumë njerëzve, këta dy udhëheqës të rinj ballkanikë vendosën një shembull të vizionit afatgjatë, vendimmarrjes së vështirë nën presion dhe udhëheqjes politike të guximshme që jo shumë udhëheqës globalë duket se janë në gjendje të arrijnë në kohën tonë." (Nimetz, 2020). Marrëveshja u përshëndet nga udhëheqësit botërorë si një hap i madh për rajonin, duke theksuar se ishte e rëndësishme të pranohet se Marrëveshja e Prespës nuk kishte mbështetje të gjerë në të dy vendet dhe, siç u përmend, mezi fitoi votat e kërkuara parlamentare dhe votat e qytetarëve në Greqi dhe në fqinjin e saj verior. Për më tepër, Anëtarët e Parlamentit Evropian emëruan Kryeministrat e të dy vendeve, Tsipras dhe

Zaev, për Çmimin Nobel për Paqe, duke deklaruar se "Marrëveshja është një model për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare përmes dialogut dhe kompromisit të ndërsjellë. Tsipras dhe Zaev treguan guxim politik në këmbënguljen e tyre për një dialog përkundër kundërshtimit të nacionalistëve në të dy vendet" (EWB, 2019).

Zgjidhja e mosmarrëveshjes së emrit me Greqinë dhe fqinjin e saj verior ka krijuar një mundësi të re të rëndësishme për marrëdhënie më konstruktive dhe një Ballkan më të sigurt. Por, pas suksesit për mbylljen e kësaj marrëveshjeje, përveç guximit të liderëve të të dy vendeve, ekzistojnë edhe disa faktorë. Faktori më i rëndësishëm është sigurisht roli i bashkësisë ndërkombëtare të udhëhequr nga zyrtarë të ShBA-së dhe BE-së, pasuar nga diplomacia e tyre e anijes, i cili krijoi një presion ndërkombëtar i cili më parë demonstroi fuqinë dhe vendosmërinë e tij me izolimin dhe penalizimin e qeverisë së mëparshme të udhëhequr nga Gruevski, e cila rezultoi që Gruevski të dilte në opozitë edhe pse kishte fituar zgjedhjet. Qeveria e re e zgjedhur, e cila erdhi në pushtet për shkak të bashkësisë ndërkombëtare duhej të respektonte mendimin e tyre dhe veproi në përputhje me rrethanat.

Ndarjet e vendeve anëtare të BE-së u reflektuan gjithashtu në politikën e saj të jashtme, duke mos dhënë një datë për fillimin e bisedimeve me shtetet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut), duke stimuluar përsëri një krizë politike. Në Maqedoninë e Veriut kjo do të çojë në dorëheqjen e qeverisë reformiste dhe zgjedhje të parakohshme të cilat mund të rezultojnë në ngecje të mëtejme të procesit të integritimit.

Sërish, mosmarrëveshja për emrin midis asaj që tani njihet si Maqedonia e Veriut dhe Greqisë ka qenë një konflikt me intensitet të ulët që helmoi marrëdhëniet dypalëshe për gati tre dekada duke parandaluar integritimin Euro-Atlantik të Maqedonisë së Veriut dhe përfundimisht kontribuoi në rënien e saj demokratike. Zgjidhja e mosmarrëveshjes zbulon guximin e dy qeverive, veçanërisht të Maqedonisë së Veriut, por gjithashtu demonstroi mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ballkanike brenda rajonit, me një mbështetje të kufizuar nga jashtë. Kjo gjithashtu thekson proceset për integrim Euro-Atlantik si një motivues për adresimin e mosmarrëveshjeve të vështira. Pa perspektivën e anëtarësimit në NATO dhe BE, mosmarrëveshja midis dy vendeve nuk do të ishte zgjidhur.

Rasti i mosmarrëveshjes Kosovë-Serbi është i ndryshëm. Ndërsa një normalizim i marrëdhënieve ka qenë në agjendë për gati një dekadë, një zgjidhje është dëshmuar - deri më sot - e pakapshme. Këtu, përfshirja e jashtme ka qenë më e gjerë dhe afati kohor është diktuar nga aktorë të jashtëm. Ndërsa ka pasur koordinim midis protagonistëve kryesorë - BE, vendet anëtare të saj dhe ShBA - ai është prishur në vitet e fundit, siç u bë e qartë në lidhje me debatin mbi potencialin e ndryshimeve të kufirit. Kjo ide është pranuar gjerësisht, qoftë edhe në mënyrë të nënkuptuar, nga aktorë thelbësorë të jashtëm si një çelës i mundshëm për një zgjidhje.

Sidoqoftë, pavarësisht nga problemet që mund të sjellin rregullime të tilla kufitare, ato gjithashtu nuk bazohen në një afrim të palëve, por përkundrazi janë përshtatur duke krijuar ndarje armiqësore, një koncept i përforcuar nga mediumet dhe fjalimet e liderëve politikë kosovarë dhe serbë. Për më tepër, motivimi pas tensioneve të përshkallëzuara është shumë i lidhur me mangësitë demokratike në të dy vendet. Kështu, dialogu Kosovë - Serbi është përdorur strategjikisht nga elitat në të dy vendet.

Një numër vendesh të Ballkanit, dhe veçanërisht paraardhësit në procesin e pranimit në BE, Serbia dhe Mali i Zi, kanë përjetuar një rënie serioze demokratike në vitet e fundit. Kjo pasqyrohet në indeksat kryesore ndërkombëtare, siç janë ato të Freedom House dhe Indeksi i Demokracisë.

Angazhimi zyrtar i presidentëve për integrimin Euro-Atlantik ka kamufluar rënien demokratike. Kohët e fundit, lëvizjet protestuese në të dy vendet kanë shfaqur pakënaqësi të gjerë me regjimet përkatëse. Dhe ndërsa protestat po zbehen, shkaqet e tyre mbeten të pa adresuara. Rënia demokratike paraqet një sfidë të veçantë për Shtetet e Bashkuara dhe BE. Konsensusi demokratik dhe evropian është minuar nga udhëheqësit autokratë të cilët kanë bashkëpunuar me ligjërimin e reformës pro-evropiane, ndërsa minojnë sistematikisht institucionet demokratike. Përdorimi i regjimeve të pozicioneve pro-perëndimore zbeh idenë e integritit Euro-Atlantik në sytë e shumë qytetarëve. Si rezultat, konsensusi pro-perëndimor që ka formësuar rajonin për dekadën e fundit nuk është më i sigurt. Lëvizjet dhe partitë e opozitës shpesh po përpiqen të formulojnë alternativa demokratike dhe pro-perëndimore; një dinamikë

e tillë fuqizon forcat anti-amerikane dhe anti-evropiane që shpesh kërkojnë mbështetje dhe frymëzim në Rusi. Lëvizjet shoqërore dhe partitë e opozitës janë kryesisht të interesuara për t'i bërë vendet e tyre më demokratike dhe të qeverisura nga shteti i ligjit. Përpyjekjet e regjimeve për t'i portretizuar ato si forca radikale pro-ruse duhet të sfidohen. Kjo thekson dinamikën e tretë rajonale – kërcënimin (Bieber, 2019).

KAPITULLI 7 - SHPALOSJA E REZULTATEVE NGA HULUMTIMI I RRJETEVE SOCIALE DHE INTERVISTAT E REALIZUARA

Hulumtimi i rrjeteve sociale – Analiza e interaktivitetit të liderëve politik të Ballkanit Perëndimor me rrjetet sociale

Arritjet teknologjike kanë ndryshuar shumëçka në shoqërinë bashkëkohore, e veçanërisht. Komunikimi përmes rrjeteve sociale është bërë trend botëror dhe një mjet i fuqishëm propagandues, i cili mes tjerash jep mundësinë për bërjen e analizave të mëtejme nga personat të cilët kanë nevojë për këtë. Duke marrë parasysh këtë, si dhe faktin se politikanët e sotshëm gjithnjë e më tepër e përdorin këtë formë komunikimi, dhe jo vetëm aq, në të shumtën e rasteve edhe si mjet për të eliminuar kundërshtarët politik.

Për këtë qëllim, në këtë hulumtim do të analizojmë aktivitetin e disa prej liderëve të Ballkanit perëndimor në rrjetet më të popullarizuara sociale, siç janë Facebook, Instagram dhe Twitter. Periudha kohore e përfshirë në këtë analizë është 3 mujore, pra nga muaji Tetor e deri në muajin Dhjetor të vitit 2020.

Tabela 1: Lista e liderëve të Ballkanit Perëndimor të radhitur sipas numrit të ndjekësve në Facebook

FACEBOOK				
Nr.	Shteti	Lideri	Ndjekës	Postime në ditë / mesatare
1	Shqipëri	Edi Rama	1,489,918	9
2	Kosovë	Albin Kurti	443,811	2
3	Kosovë	Hashim Thaçi	359,879	3
4	Maqedonia e V.	Zoran Zaev	236,816	4
5	Serbi	Aleksandar Vučić	188,702	1
6	Shqipëri	Ilir Meta	145,706	5
7	Mali Zi	Milo Xhukanovic	62,921	3

8	Bosnja dhe Hercegovina	Bakir Izetbegović	51,885	1
9	Mali Zi	Zdravko Krivokapic	30,492	2
10	Bosnja dhe Hercegovina	Milorad Dodik	17,378	1

Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjeti social Facebook.

Në tabelën më sipër kemi paraqitur të dhëna që burojnë nga platforma sociale Facebook, ku mund të shihet numri i ndjekësve të liderëve politik të Ballkanit Perëndimor si dhe numri i postimeve të cilat ata i bëjnë në ditë.

Në këtë tabelë paraqitet renditja sipas numrit të ndjekësve, ku si lider i cili ndiqet më së tepërmi në platformën Facebook paraqitet Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama me 1,489,918 ndjekës, i pasuar nga ish-Kryeministri i Kosovës Albin Kurti i cili ka 443,811 ndjekës në këtë platformë. Më tej e kemi ish Presidentin Hashim Thaçi me 359,879 ndjekës, ndërsa në vendin e katërt radhitet Kryeministri aktual i Maqedonisë së Veriut me 236,816 ndjekës në këtë platformë të rrjeteve sociale. Në fund të kësaj renditjeje na paraqitet anëtari i Presidencës së Bosnja e Hercegovinës Milolard Dodik me vetëm 17,378 ndjekës në Facebook.

GRAFIKONI 1: LIDERËT E BALLKANIT PERËNDIMOR SIPAS NUMRIT TË NDJEKËSVE NË FACEBOOK



Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjeti social Facebook.

Në grafikonin e më sipër duket qartë se në platformën Facebook, Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama është lider më i ndjekur në Ballkan, me numrin e ndjekësve 1,489,918. Me këtë shifër Edi Rama i lë pas të gjithë liderët tjerë.

Tabela 2: Lista e liderëve të Ballkanit Perëndimor të radhitur sipas numrit mesatar të postimeve në ditë në Facebook


FACEBOOK				
Nr.	Shteti	Lideri	Ndjekës	Postime në ditë
1	Shqipëri	Edi Rama	1,489,918	9
2	Shqipëri	Ilir Meta	145,706	5
3	Maqedonia e V.	Zoran Zaev	236,816	4
4	Kosovë	Hashim Thaçi	359,879	3
5	Mali Zi	Milo Xhukanovic	62,921	3
6	Kosovë	Albin Kurti	443,811	2
7	Mali Zi	Zdravko Krivokapic	30,492	2
8	Serbi	Aleksandar Vuçiç	188,702	1
9	Bosnja dhe Hercegovina	Milorad Dodik	17,378	1
10	Bosnja dhe Hercegovina	Bakir Izetbegović	51,885	1

Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjeti social Facebook.

Në këtë tabelë paraqitet renditja sipas numrit të postimeve të cilat liderët i bëjnë në ditë në platformën e Facebook-ut. Numri i postimeve që liderët bëjnë në ditë është llogaritur si mesatare e postimeve që ata e kanë bërë në dy muajt e fundit. Sipas të dhënave që janë në tabelën më sipër, duket se Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama është radhitur në vend të parë

me mesatarisht 9 postime në ditë, Ilir Meta me 5 postime në ditë, Kryeministri i Maqedonisë së Veriut me 4 postime, ish Presidenti Hashim Thaçi dhe Presidenti i Malit të Zi Milo Xhukanoviç me nga 3 postime, ish-Kryeministri i Kosovës Albin Kurti me Kryeministrin e Malit të Zi Zdravko Krivokapiç me nga 2 postime në ditë, dhe Presidenti i Sërbis Aleksandar Vuçiç me dy liderët e Bosnja e Hercegovinës me nga 1 postim në ditë ne rrjetin e medimeve sociale Facebook.

Grafikoni 2: Liderët e Ballkanit Perëndimor sipas numrit mesatar të postimeve në ditë në Facebook



Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjeti social Facebook.

Në grafikonin numër 2 shihen liderët ballkanik sipas numrit mesatar të postimeve në ditë në Facebook, me Kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama duke bërë mesatarisht 9 postime në ditë në Facebook si lider më aktiv. Pas tij radhiten, Presidenti i Shqipërisë Ilir Meta me nga mesatarisht 5 postime në ditë dhe Kryeministri i Maqedonisë së Veriut Zoran Zaev me nga mesatarisht 4 postime në ditë. Hashim Thaçi dhe Milo Xhukanoviç me nga mesatarisht 3 postime në ditë, Albin Kurti dhe Zdravko Krivokapiç me nga mesatarisht 2 postime në ditë dhe

në fund të grafikonit me nga mesatarisht 1 postime në ditë paraqiten Aleksandar Vuçiç, Milolard Dodik dhe Bakir Izetbegoviç.

Tabela 3: Lista e liderëve të Ballkanit Perëndimor të radhitur sipas numrit të ndjekësve në Instagram

INSTAGRAM				
Nr.	Shteti	Lideri	Ndjekës	Postime
1	Shqipëri	Edi Rama	467,002	1,713
2	Serbi	Aleksandar Vuçiç	165,662	845
3	Kosovë	Albin Kurti	162,890	309
4	Shqipëri	Ilir Meta	57,497	2,109
5	Kosovë	Hashim Thaçi	55,980	1,685
6	Maqedonia e V.	Zoran Zaev	51,107	2,368
7	Mali Zi	Zdravko Krivokapic	30,603	198
8	Mali Zi	Milo Xhukanovic	30,213	1,108
9	Bosnja dhe Hercegovina	Bakir Izetbegoviç	1,350	35
10	Bosnja dhe Hercegovina	Milorad Dodik	0	0


Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjeti social Instagram.

Në tabelën më sipër janë paraqitur të dhëna që burojnë nga platforma sociale Instagram, në të cilën janë dhënë numri i ndjekësve të liderëve politik të Ballkanit Perëndimor si dhe numri i postimeve që ata kanë bërë deri tani.

Në këtë tabelë paraqitet renditja sipas numrit të ndjekësve, ku si lider i cili ndiqet më së tepërmi në platformën Instagramit ashtu si në platformën e Facebookut, përsëri paraqitet

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama me 467,002 ndjekës, në vend të dytë Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiç me 165,662 ndjekës, në vendin e tretë ish-Kryeministri i Kosovës Albin Kurti i cili ka 162,890 ndjekës në këtë platformë. Më tej e kemi Presidentin e Shqipërisë Ilir Meta me 57,497 ndjekës, ish Presidentin Hashim Thaçi me 55,980 ndjekës, Kryeministri i Maqedonisë së Veriut me 51,107 ndjekës, dy liderët e Malit të Zi me mbi 30,000 ndjekës, dhe anëtari i Presidencës së Bosnja e Hercegovinës Bakir Izetbegović me 1,350 ndjekës. Në fund të kësaj tablele paraqitet anëtari i Presidencës së Bosnjë e Hercegovinës Milolard Dodik i cili nuk ka llogari oficiale në Instagram.

Grafikoni 3: Liderët e Ballkanit Perëndimor sipas numrit të ndjekësve në Instagram



Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjeti social Instagram.

Si në grafikonin numër 1 ashtu edhe në këtë grafikon, Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama paraqitet si lider i Ballkanit më i ndjekur në platformën e Instagramit, duke i lënë liderët tjerë pas vete. Presidenti i Serbisë dhe Ish-Kryeministri i Kosovës vijojnë pas Kryeministrit të Shqipërisë sipas numrit të ndjekësve ne Intagram. Në vendin e fundit paraqitet anëtari i Presidencës së Bosnjë dhe Hercegovinës Milolard Dodik, i cili nuk ka llogari zyrtarë ne Instagram.

Tabela 4: Lista e liderëve të Ballkanit Perëndimor të radhitur sipas numrit të postimeve në Instagram


INSTAGRAM				
Nr.	Shteti	Lideri	Ndjekës	Postime
1	Maqedonia e V.	Zoran Zaev	51,107	2,368
2	Shqipëri	Ilir Meta	57,497	2,109
3	Shqipëri	Edi Rama	467,002	1,713
4	Kosovë	Hashim Thaçi	55,980	1,685
5	Mali Zi	Milo Xhukanovic	30,213	1,108
6	Serbi	Aleksandar Vuçiç	165,662	845
7	Kosovë	Albin Kurti	162,890	309
8	Mali Zi	Zdravko Krivokapic	30,603	198
9	Bosnja dhe Hercegovina	Bakir Izetbegović	1 350	35
10	Bosnja dhe Hercegovina	Milorad Dodik	0	0

Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjeti social Instagram.

Në këtë tabelë paraqitet renditja sipas numrit të postimeve të cilat liderët i kanë bërë deri tani në platformën e Instagramit. Sipas të dhënave që janë në tabelën e mësipërme, shohim se Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev është radhitur në vend të parë me 2,368 postime, Ilir Meta me 2,109 postime, Kryeministri i Shqipërisë me 1,713 postime, ish Presidenti Hashim Thaçi me 1,685 postime, Presidenti i Malit të Zi Milo Xhukanović me 1,108

postime, Presidenti i Serbisë me 845 postime, ish-Kryeministri i Kosovës Albin Kurti me 309 postime, Kryeministri i Malit të Zi Zdravko Krivokapiç me 198 postime, dhe anëtar i Presidencës së Bosnja e Hercegovinës Bakir Izetbegović me 35 në rrjetin social Instagram. Ashtu siç cekëm edhe më herët, anëtar i Presidencës së Bosnja e Hercegovinës Milorad Dodik nuk ka llogari oficiale në platformën e Instagramit.

Grafikoni 4: Liderët e Ballkanit Perëndimor sipas numrit të postimeve në Instagram



Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjeti social Instagram.

Kur bëhet fjalë për postimet që i kanë bërë liderët Ballkanik në platformën e Instagramit Kryeministri i Maqedonisë së Veriut Zoran Zaev paraqitet në vendin e parë, me gjithsej 2,368 postime. Menjëherë pas tij paraqitet Presidenti i Shqipërisë Ilir Meta me 2,109 postime dhe Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama me 1,713 postime.

Tabela 5: Lista e liderëve të Ballkanit Perëndimor të radhitur sipas numrit të ndjekësve në Twitter

TWITTER				
Nr.	Shteti	Lideri	Ndjekës	Tweets


1	Shqipëri	Edi Rama	358,221	5,888
2	Serbi	Aleksandar Vuçiç	353,402	3,230
3	Kosovë	Hashim Thaçi	80,335	3,418
4	Kosovë	Albin Kurti	40,271	487
5	Mali Zi	Zdravko Krivokapic	23,975	281
6	Maqedonia e V.	Zoran Zaev	23,627	8,107
7	Shqipëri	Ilir Meta	20,365	5,940
8	Mali Zi	Milo Xhukanovic	11,956	517
9	Bosnja dhe Hercegovina	Bakir Izetbegović	4,577	2,255
10	Bosnja dhe Hercegovina	Milorad Dodik	0	0

Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjeti social Twitter.

Në këtë tabelë janë paraqitur të dhënat e ndjekësve të liderëve të Ballkanit Perëndimor në platformën e Twitterit si the numri i postimeve të tyre në këtë platformë.

Edhe në këtë tabelë Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama paraqitet në rend të parë me numrin e ndjekësve 358,221, dhe pas Kryeministrit të Shqipërisë, paraqitet Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiç me 353,402 ndjekës. Këta dy liderë, janë liderë që ndiqen më së tepërmi në platformën Twitterit. Në vendin e tretë kemi ish Presidentin Hashim Thaçi me 80,335 ndjekës, ish-Kryeministri i Kosovës Albin Kurti i cili ka 40,271 ndjekës në këtë platformë radhitet i katërti. Më tej e kemi Kryeministrin e Malit të Zi dhe Kryeministrin e Maqedonisë së Veriut me mbi 23.000 ndjekës, Presidentin e Shqipërisë Ilir Meta me 20,365 ndjekës, Presidentin e Malit të Zi me 11,956 ndjekës dhe anëtarin e Presidencës së Bosnjë e Hercegovinës Bakir Izetbegović me 4,577 ndjekës. Në fund të kësaj tablele përsëri paraqitet anëtari i Presidencës së Bosnja e Hercegovinës Milorad Dodik i cili nuk ka llogari oficiale as në Twitter.

Grafikoni 5: Liderët e Ballkanit Perëndimor sipas numrit të ndjekësve në Twitter



Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjeti social Twitter.

Në grafikunin numër 5 paraqiten liderët Ballkanik sipas numrit të ndjekësve në platformën e Twitterit. Edhe në këtë platformë Kryeministri I Shqipërisë Edi Rama paraqitet në vendin e parë, por menjëherë pas tij paraqitet Presidenti i Serbisë Aleksandar Vučić. Anëtar i Presidencës së Bosnjë dhe Hercegovinës Milolard Dodik, as në platformën Twitter nuk ka llogari zyrtare dhe paraqitet në fund të grafikunin.

Tabela 6: Lista e Liderëve të Ballkanit Perëndimorë të radhitur sipas numrit të postimeve në Twitter


TWITTER

Nr.	Shteti	Lideri	Ndjekës	Tweets
1	Maqedonia e V.	Zoran Zaev	23,627	8,107
2	Shqipëri	Ilir Meta	20,365	5,940
3	Shqipëri	Edi Rama	358,221	5,888
4	Kosovë	Hashim Thaçi	80,335	3,418
5	Serbi	Aleksandar Vuçiç	353,402	3,230
6	Bosnja dhe Hercegovina	Bakir Izetbegović	4,577	2,255
7	Mali Zi	Milo Xhukanovic	11,956	517
8	Kosovë	Albin Kurti	40,271	487
9	Mali Zi	Zdravko Krivokapic	23,975	281
10	Bosnja dhe Hercegovina	Milorad Dodik	0	0

Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjeti social Twitter.

Në këtë tabelë paraqitet renditja sipas numrit të postimeve të cilat liderët e Ballkanit Perëndimor i kanë bërë deri tani në platformën e Twitterit. Sipas të dhënave që janë në tabelën më sipër, shohim se Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev përsëri është radhitur në vend të parë me 8,107 postime, dhe menjëherë pas tij Ilir Meta, Presidenti i Shqipërisë me 5,940 postime, Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama me 5,888 postime, ish Presidenti Hashim Thaçi me 3,418 postime, Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiç me 3,230 postime, anëtari i Presidencës së Bosnja e Hercegovinës Bakir Izetbegović me 2,255 postime, Presidenti i Malit të Zi Milo Xhukanović me 517 postime, ish-Kryeministri i Kosovës Albin Kurti me 487 postime, Kryeministri i Malit të Zi Zdravko Krivokapiç me 281 postime. Ashtu siç cekëm edhe më herët, anëtari i Presidencës së Bosnja e Hercegovinës Milorad Dodik nuk ka llogari oficiale në platformën e Twitterit.

Grafikoni 6: Liderët e Ballkanit Perëndimor sipas numrit të postimeve në Twitter



Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjeti social Twitter.

Në grafikonin numër 6 mund të vërehet se Kryeministri i Maqedonisë së Veriut Zoran Zaev ashtu si në platformën e Instagramit edhe në platformën e Twitterit është lideri ballkanik më aktiv me mbi 8,000 postime. Ilir Meta dhe Edi Rama kanë afër 6,000 postime, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vučić me mbi 3,000 postime, Bakir Izetbegović me mbi 2,000 postime dhe Milo Xhukanović, Albin Kurti dhe Zdravko Krivokapić ndër 1,000 postime në platformën Twitter.

Tabela 7: Lista e numrit të ndjekësve dhe numrit të postimeve të liderëve të Ballkanit Perëndimor në të gjitha platformat e rrjeteve sociale

RRJETET SOCIALE		FACEBOOK		INSTAGRAM		TWITTER	
Shteti	Lideri	Ndjekës	Postime në ditë	Ndjekës	Postime	Ndjekës	Postime
Maqedonia e V.	Zoran Zaev	236,816	4	51,107	2,368	23,627	8,107
Shqipëri	Edi Rama	1,489,918	9	467,002	1,713	358,221	5,888
Shqipëri	Ilir Meta	145,706	5	57,497	2,109	20,365	5,940
Kosovë	Albin Kurti	443,811	2	162,890	309	40,271	487
Kosovë	Hashim Thaçi	359,879	3	55,980	1,685	80,335	3,418
Serbi	Aleksandar Vuçiç	188,702	1	165,662	845	353,402	3,230
Bosnja dhe Hercegovina	Milorad Dodik	17,378	1	ska	ska	Ska	ska
Bosnja dhe Hercegovina	Bakir Izetbegović	51,885	1	1,350	35	4,577	2,255
Mali Zi	Milo Xhukanovic	62,921	3	30,213	1,108	11,956	517
Mali Zi	Zdravko Krivokapic	30,492	2	30,603	198	23,975	281


Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjetet sociale Facebook, Instagram, Twitter.

Në këtë tabelë i kemi të dhënat për numrin e ndjekësve dhe numrin e postimeve të liderëve të Ballkanit Perëndimor në të gjitha platformat e rrjeteve sociale. Prej të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër, mund të krahasohen më lehtë përdoruesit më aktiv të rrjeteve sociale, ku Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama paraqitet në të gjitha platformat në rend të parë

me numrin e ndjekësve dhe me numrin e postimeve në ditë në platformën e Facebookut, ndërsa Kryeministri I Maqedonisë së Veriut në platformën e Instagramit dhe në platformën e Twitterit paraqitet në vend të parë sipas numrit të postimeve që kanë bërë deri më tani.

Sipas të dhënave në tabelë, duket qartë se anëtari i Presidencës së Bosnja e Hercegovinës Milorad Dodik nuk përdor rrjetet sociale për komunikim me publikun.


Grafikon 7: Ndjekësit e Liderëve të Ballkanit Perëndimor në rrjetet sociale



Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjetet sociale Facebook, Instagram, Twitter.

Grafikoni i mësipërm jep një pasqyrë se sa Liderët e Ballkanit Perëndimor ndiqen nga përdoruesit e rrjeteve sociale, Facebook, Instagram dhe Twitter. Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama ka numër më të madh të ndjekësve në Facebook dhe Instagram për dallim nga liderët tjerë; i njëjti është edhe më aktiv në rrjetet sociale.

Grafikoni 8: Postimet e Liderëve të Ballkanit Perëndimorë në Instagram dhe Twitter



Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjetet sociale Facebook, Instagram, Twitter

Nga grafikoni i mësipërm duket qartë se liderët e Ballkanit Perëndimor janë përdorues më aktiv të Twitterit në krahasim me Instagramin. Lideri i Maqedonisë së Veriut Zoran Zaev është në vend të parë në të dy platformat pasuar nga Edi Rama dhe Ilir Meta. Te ish-Presidenti i Kosovës dhe te Albin Kurti kemi një rënie në të dy platformat.

Grafikoni 9: Numri Mesatar i Postimeve të liderëve të Ballkanit Perëndimor në ditë në Facebook



Burimi: Të dhënat zyrtare nga rrjeti social Facebook.

Në vijim do të paraqesim profilet e liderëve politik të cilët i kemi analizuar në kuadër të hulumtimit:



Zoran Zaev

Kryeministër i R. së Maqedonisë së Veriut

2017 –

Posta elektronike: info@vlada.gov.mk

Faqja Facebook: www.facebook.com/zaevzoran 236,816 ndjekës

Profili në Twitter: www.twitter.com/Zoran_Zaev 23,627 ndjekës

Profili në Instagram: www.instagram.com/zoranzaev 51,107 ndjekës



Edi Rama

Kryeministër i R. së Shqipërisë

Shtator 2013 –

Posta elektronike: <http://www.ps.al/>

Faqja Facebook: www.facebook.com/edirama.al 1,489,918 ndjekës

Profili në Twitter: www.twitter.com/ediramaal 358,221 ndjekës

Profili në Instagram: www.instagram.com/ediramaal 467,002 ndjekës



Ilir Meta

Presidenti i R. së Shqipërisë

2017

Posta elektronike: <http://www.president.al/>

Faqja Facebook: www.facebook.com/ilirmetazyrtar 145,706 ndjekës

Profili në Twitter: www.twitter.com/ilirmetazyrtar 20,365 ndjekës

Profili në Instagram: www.instagram.com/ilirmeta.faqjazyrtare 57,497 ndjekës



Albin Kurti

Kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje dhe ish Kryeministri i Republikës së Kosovës

Posta elektronike: <http://www.vetevendosje.org/>

Faqja Facebook: www.facebook.com/albini2017 443,811 ndjekës

Profili në Twitter: www.twitter.com/albinkurti 20,365 ndjekës

Profili në Instagram: www.instagram.com/albinkurti 40,271 ndjekës



Hashim Thaçi

Ish President i Republikës së Kosovës

Posta elektronike: <http://www.hashimthaci.com/>

Faqja Facebook: www.facebook.com/HashimThaciOfficial 359,879 ndjekës

Profili në Twitter: www.twitter.com/HashimThaciRKS 80,335 ndjekës

Profili në Instagram: www.instagram.com/hashimthaciofficial 55,980 ndjekës



Aleksandar Vučić

President i Republikës së Serbisë

2017

Posta elektronike: <http://www.predsednik.rs/>

Faqja Facebook: www.facebook.com/buducnostsrbiavevucic 33,380 ndjekës

Profili në Twitter: www.twitter.com/avucic 353,402 ndjekës

Profili në Instagram: www.instagram.com/avucic 165,662 ndjekës



Milolard Dodik

Anëtar serb i Presidencës së Bosnjë dhe Hercegovinës

Aleanca e Social Demokratëve të Pavarur

Ueb faqja: <http://predsjednistvobih.ba/kab/default.aspx?id=60337&langTag=bs-BA>

Faqja Facebook: [www.facebook.com/ Милорад Додик - Milorad Dodik](https://www.facebook.com/Милорад_Додик_-_Milorad_Dodik) 17,378 ndjekës



Bakir Izetbegović

Ish Anëtar Boshnjak i Presidencës së Bosnjë dhe Hercegovinës

Partia e Veprimit Demokratik

Posta elektronike: www.bakirizetbegovic.ba

Faqja Facebook: www.facebook.com/B.Izetbegovic 51,885 ndjekës

Profili në Twitter: www.twitter.com/B_Izetbegovic 4,577 ndjekës

Profili në Instagram: www.instagram.com/bakir.izetbegovic.official 55,980 ndjekës



Milo Xhukanoviç

President i Malit të Zi

2018

Posta elektronike: <http://www.predsiednik.me/>

Faqja Facebook: www.facebook.com/predsiednikcg

62,921 ndjekës

Profili në Twitter: www.twitter.com/predsiednik_cg

11,956 ndjekës

Profili në Instagram: www.instagram.com/predsiednik_cg

30,213 ndjekës



Zdravko Krivokapiç

Kryeministri i Malit të Zi

2020

Posta elektronike: <http://www.predsiednik.me/>

Faqja Facebook: www.facebook.com/profKrivokapic

30,492 ndjekës

Profili në Twitter: www.twitter.com/profKrivokapic

23,975 ndjekës

Profili në Instagram: www.instagram.com/zdravkokrivokapiccg

30,603 ndjekës

Në bazë të hulumtimit të realizuar në rrjetet sociale Facebook, Twitter, Instagram, mbi përdorimin e këtyre mjeteve të komunikimit nga liderët e Ballkanit Perëndimor shihet qartë se kryeministri i Republikës së Shqipërisë Edi Rama kryeson në të gjitha platformat në rrjetet sociale, i pasuar nga Presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiç. Pikërisht këta dy liderë akuzohen për mosdhënie të mjaftueshme të hapësirës mediatike opozitës gjë që ka ndikuar mes tjerash në pushtet absolut të këtyre dy liderëve në nivel lokal dhe qendror. Më tej, janë të arsyeshme edhe shqetësimet e opozitës serbe kur kemi parasysh të dhënat e lartpërmendura, fushatën arrogante mediatike dhe investimet e vazhdueshme në këtë fushë, shpeshherë edhe në mënyrë të palejueshme nga ana e pushtetmbajtësit, duke cekur edhe keqpërdorimet të cilat i mundësojnë edhe rrjetet sociale me përdorimin e llogarive të rreme për ta sulmuar oponentin politik.

Për më tepër mund të vërehet tendenca rritëse e ish-kryeministrit të Kosovës Albin Kurti, i cili në vazhdimësi bën investime në rrjetet sociale përmes angazhimit të njerëzve profesionist në këtë fushë.

Nga ana tjetër udhëheqësit nga Bosnja Hercegovina rezultojnë të jenë më pak të përfshirë në rrjetet sociale, pasi që të njëjtit nuk i kushtojnë shumë rëndësi kësaj forme komunikimi. Anëtar i Presidencës (Bosnja e Hercegovina) Millorad Dodik shfrytëzon vetëm llogarinë në Facebook dhe ka rreth 17.000 ndjekës, që në krahasim me liderët tjerë të Ballkanit perëndimorë është numër shumë i vogël.

Intervista

Siç edhe cekëm në fillim, në mënyrë që të vijmë deri tek rezultatet e kërkuara për verifikim të hipotezave të parashtruara në këtë disertacion, si pjesë e metodologjisë hulumtuese kemi përdorur intervistën me persona që kanë njohuri dhe eksperiencë në fushën të cilën e kemi temë hulumtimi.

Intervistat janë realizuar gjatë periudhës kohore prej Shtator 2020 – Nëntor 2020, dhe të njëjtat janë dërguar në formë elektronike. Më poshtë i paraqes pyetjet e parashtruara gjatë kësaj interviste.

1. Si e përcaktoni suksesin e lidërshiptit politik?
2. Cila është karakteristika që besoni se çdo udhëheqës duhet ta zotërojë?
3. Çfarë këshille do t'i jepnit dikujt që merr pozicionin e liderit për herë të parë?
4. Kush janë disa nga liderët politik sot që shërbejnë si një shembull i mirë që duhet ndjekur?
5. Cila është sfida më e madhe me të cilën përballen udhëheqësit e shteteve të Ballkanit perëndimor?
6. Cilët janë disa nga mangësitë më të mëdha të liderëve ballkanik?
7. Sa ndikim ka ish-sistemi monist në mendësinë e liderëve aktual në Ballkanin perëndimor?
8. A ndikon sistemi politik shtetëror në dështimet e një lideri? (këtu kemi parasysh se shtetet e reja të Ballkanit perëndimor kanë marrë modele të gatshme të sistemeve politike, disa të cilat akoma nuk janë plotësisht autonome, si Rasti i Bosnjës dhe Kosovës)

Intervista 1: Adelina Marku

Znj. Adelina Marku punon si zyrtare në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe është ligjëruese në Akademinë Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjatë karrierës së saj profesionale zonja Marku ka punuar edhe si gazetare dhe ka qenë e angazhuar në shumë projekte si menaxhere ekzekutive dhe koordinatorë. Zonja Marku ka publikuar një numër të madh të shkrimeve dhe punimeve, si dhe ka marrë pjesë në Konferenca të ndryshme në mbarë botën. Zonja Marku ka një diplomë Master në Psikologji Politike nga Universiteti i Tiranës.

1. Si e përcaktoni suksesin e lidërshiptit politik?

Periudha e pas vitit 1990 nxori në pah, do e quaja, një nevojë për vetëdije sovranë tek popujt pjesë e ish Jugosllavisë, por edhe te të tjerët në Ballkan! Kjo nevojë grupohet në ndjenjat e forta të popujve në kërkim të vetes, sepse ka të bëjë me nevojën për atë që mungon/te, në kuptimin e një letrari! Ndjenjat e forta prodhojnë vizione të qarta për sovranin, por kur ato nuk kanë sistem shoqëror për t'u rehatuar (mungesa e kushtetutave demokratike) mbeten të frustruara, ndaj dhe tranzicioni nga një sistem komunist në një sistem demokratik, mbeti për shumë gjatë kohë si revolucionar. [Përjashtim bëri vetëm Sllovenia, atje sovranin ruajti harduerin dhe sofistikoi softuerin! Prandaj dhe Sllovenia ishte e para që u bë pjesë e BE]. Unë, si konsumatore e këtij lloji politikë-bërjeje që qëndroi gjatë kohë pezull e në “revolucionin” e vet, kam lexuar një lidërshipt nacionalist në esencë, por jo në kuptimin etnonacionalist dhe egocentrist (siç na stigmatizojnë me të padrejtë anëtarët e BE). Në thelb erdhi si pasojë e ndërgjegjes së rrejtshme për vetët tona, e që padyshim ishte trashëgimi nga unitarizmi i shkollës së të menduarit komunist. Ne nuk ishim të njëjtë, ishim të ndryshëm! Të përbashkët e kishim vetëm një emërues pra, nevojën për të strukturuar sovranin tek qytetari që mësonte alfabetin e një regjimi të ri e të panjohur më parë, që e quajmë sistem demokratik! Si do e përcaktoja këtë lloj lidërshipti? Sa përcakton sukses ose pezhorativ ky lloj lidërshipti? Nga kjo perspektivë sot, më

shumë do e kategorizojnë si një tendencë për të etabluar demokraci liberale nëpër shoqëritë e shteteve që dolën nga rënia e komunizmit, pra i kisha dhënë më shumë dozë pezhorative përcaktimit të atij lidershipi sepse i mungonte dija (KNOWLEDGE) dhe përvoja (experience) për tre elemente thelbësore të demokracisë liberale:

- Lidershipi vuante mungesën e njohurive dhe përvojës së të drejtave dhe lirive të njeriut (prandaj dhe kushtetutat vuanin nga inercia e vetë-sajuar),
- Lidershipi vuante mungesën e njohurive të tregut të lirë,
- Lidershipi vuante mungesën e njohurive dhe përvojës për integritet euroatlantike.

Tre elemente të rëndësishme këto që kanë mbetur të pasofistikuara edhe sot e kësaj dite! Platforma e lidershipit që u vendos atëbotë pra, gëzonte përcaktime të forta emocionale për veten si sovran, emocioni i fortë ishte përcaktues, por që vizioni i të cilit emocion vuante nga mungesa e mësimi doktrinor të demokracisë liberale. Si i tillë, përcaktoi formë parademokratike të menaxhimit të institucioneve dhe votës së lirë. Prandaj, metademokracia do ishte diskursi i ri i lidershipit sot, e që do të thotë: përdor demokracinë që të përmirësohë demokracinë (use democracy to improve democracy)!

2. Cila është karakteristika që besoni se çdo udhëheqës duhet ta zotërojë?

I takoj shkollës për lidership të Joseph Nye, i cili jep mësim mbi një model të suksesshëm të lidershipit. E quan aftësi për LIDERSHIP TË MENÇUR, SMART LEADERSHIP (SMART POWER). Ky lloj lidershipi është kombinim i lidershipit (Fuqisë) të fortë dhe (Fuqisë) të butë.

Nëse lidershipi (fuqia) i fortë karakterizohet nga:

1. Aftësia për të kontrolluar dhe nga,
2. Aftësia për makiavelizëm,

lidshipi i butë karakterizohet nga:

1. Aftësia për komunikim,

2. Aftësia për ndërtim vizioni dhe nga
3. Aftësia për inteligjencë emocionale.

Çdo udhëheqës/e duhet të ketë karakteristikën **(virtutin)** për të kombinuar fuqinë e fortë me fuqinë e butë. Kombinimi i tyre, prodhon SMART LEADERSHIP. Është gabim të mendohet se çdo lider/e duhet t'i ketë organike këto aftësi, më mirë do kisha thënë se i/e suksesshme është ai/ajo lider/e që din të gjejë tek të tjerët këto aftësi (team building) e të posedojë aftësinë e mençur vetë për ti kombinuar ato! Ky/kjo lider/e jam e bindur që do dijë të bien në vendime të mençura në politikë, por dhe në jetë!

3. Çfarë këshille do t'i jepnit dikujt që merr pozicionin e liderit për herë të parë?

- MBAJ RRETH VETES dhe AFËR VETES NJERËZ ME PËRVOJË INSTITUCIONALE prandaj dhe NJERËZORE!
- ËSHTË ART TË PRANOSH SE JE MË I PADITURI MES TË DITURVE dhe atyre me PËRVOJË , por prandaj dhe është FAT të udhëheqësh me diturinë dhe përvojën e tyre.
- Pastaj, mëso artin e distancës së nevojshme me ata që ke rreth vetes, lidërsipin autentik megjithatë duhesh vetë ta ndërtosh! Në të kundërtën, je vetëm një clown!

4. Kush janë disa nga liderët politik sot që shërbejnë si një shembull i mirë që duhet ndjekur?

Angela Merkel – smart lidere, autentike padyshim. Kjo zonjë përcjell vija të theksuara të lidërsipit autentik! Për mua, e vetmja në nivel global! Në aspektin lokal, do kisha veçuar dy:

- Edi Rama, që ka ndërtuar lidërsip kontekstual, dhe
- Zoran Zaev – po aq lidërsip kontekstual.

Janë dy liderë këta që padyshim shpërfaqin edhe nuanca autokratësh, i pari me elemente elitiste, i dyti, me elemente egalitariste, por që në kuptimin tim këto nuanca janë të “tolerueshme” për vende të vogla si tonat e që vuajnë histori të së kaluarës përplot me demonë të pa-rehatuar! Të dy këta, do kishin përfituar mjaft nga mësimet që jep metademokracia d.m.th., use democracy to improve democracy! ☺

5. Cila është sfida më e madhe me të cilën përballen udhëheqësit e shteteve të Ballkanit perëndimor?

Mungesa e besimit të ndërsjellë, pra mungesa e respektit, prandaj dhe strukturimi i idesë për efektshmërinë e Berlin Process for the Western Balkans Countries është përplot paradigma dhe ndërgjegje falsive. Mungesa e besimit të ndërsjellë është e sfiduar nga mungesa e besueshmërisë dhe legjitimitetit të qeverisjeve të vendeve veçmas nga ana e votuesve! Mungesa e besueshmërisë ndaj tyre veçmas është si rezultat i riciklimit të vazhdueshëm të dështimit /falsitetit të luftës kundër korrupsionit, rule of law dhe tregut të lirë!

6. Cilët janë disa nga mangësitë më të mëdha të liderëve ballkanik?

Vetëkënaqja është mangësi! Liderët këtej janë të vetëkënaqur, prandaj dhe nuk kapërcejnë përtej vetes! Atyre ju mjafton limiti i tyre personal i menaxhimit me politikën e prodhim lidershipi! Kapërcimi përtej vetes, ka të bëjë me vendimmarrjen! Autokratët riciklojnë po aq vetëkënaqësi sa dhe qeverisje latente! Kompleksi i vetëkënaqjes tek ata çuditërisht bëhet viral tek votuesi i tyre! (Obeyed to their selfsufficiency) Prandaj dhe vepra kapitale e autorit bullgar IVAN KRASTEV, “In mistrust we trust”, flet për mosbesueshmërinë e votuesit si diskurs politik por që përsëri e shtyn atë të votojë të njëjtin lider! Kjo ka të bëjë me letargjinë e palës së tretë, d.m.th. gjeneratës së re të politikanëve (jo ekskluzivisht në moshë, por në prurje diskursi ndryshe politik) që duhet të mbushë/plotësojë këtë hapësirë të madhe të mosbesueshmërisë

ricikluese, gjeneratore e pakënaqësisë në shoqëri. (Shembulli i Dritan Abazoviç në Mal të Zi, mund të merret si shembull shkollar)!

7. Sa ndikim ka ish-sistemi monist në mendësinë e liderëve aktual në Ballkanin perëndimor?

SHUMË! Demonët e së kaluarës ende janë të pranishëm në mendjen e politikë-bërjen e tyre. Është ky një rrjet merimange i relatave të dikurshme që i trashëgojnë edhe gjeneratat e reja. Shkëputja e moderuar nga to do nënkuptonte mirëqenie sovraane për shtetin, shoqërinë dhe lidërshtipin. Dhe këtu, në këtë relacion e në këtë vazhdë, është koha që krijon “distancën e ftohtë” ajo që i jep kuptim kësaj marrëdhënieje! I shton vlera të reja, i hap horizonte të reja do kisha thënë!

8. A ndikon sistemi politik shtetëror në dështimet e një lideri? (këtu kemi parasysh se shtetet e reja të Ballkanit perëndimor kanë marrë modele të gatshme të sistemeve politike, disa të cilat akoma nuk janë plotësisht autonome, si Rasti i Bosnjës dhe Kosovës)

Pyetje shumë e mirë! Stabiliteti para standardeve jo gjithmonë ka dëshmuar mirëqenie nëpër këto shoqëri, këtu BH, Kosova po aq, por dhe Maqedonia e Veriut! Një garanci për standarde të reja Maqedonisë së Veriut p.sh. po i jep anëtarësimi në NATO (e këtu, përderisa gjeopolitika detyrimisht nxit një marrëdhënie sublime mes BE dhe NATO, një ekuilibër që mbahet me kujdes nga lidërshtipi botëror e me qëllim “harmonie” mes civilizimit perëndimor dhe atij lindor). BH është një pasojë e filozofisë “Stabilitet para standardeve” dhe kthesa ndryshe ndaj kësaj formule është pothuajse një mission impossible....!!! BH është një tampon zonë për WB6 (Western Balkan Countries); një zonë akute e të panjohurave që mund të sillte eventualisht ndryshimi i sistemit politik aty! BE nuk e aktualizon narrativin mbi këtë vend përderisa problemin e ka sajuar vetë ajo, tej-rregullimi i një sistemi të ri politik, do

fragmentonte edhe më shumë etnitë e vogla që përbëjnë këtë vend dhe do ngjallte padyshim demonët e fjetur! Prandaj dhe liderët atje, mbeten peng i asaj kushtetute e atij sistemi politik që mbahet në status quo të hollë! Pyetja është deri kur? ...NATO ende larg, BE po aq galaktikisht larg! Në anën tjetër, një Kosovë në NATO e BE dhe një Serbi në NATO e BE mund të shikohet përmes pragmes së vullnetit të popullit, fuqisë dhe vullnetit të demosit, e kjo do të thotë se një referendum në Kosovë dhe Shqipëri për një Konfederatë shqiptare duhet parë si vizion i lidërshiptit të radhës (i së ardhmes) në Kosovë dhe Shqipëri, si një vizion i fokusuar i lidërshiptit dhe jo anarkik, e që WB6 do i jepte një impetus të hatashëm për zhvillim dhe progres. Ballkani do i siguronte NATO-s një gjeo-strategji detare të jashtëzakonshme, ndërsa BE një ekonomi të leverdishme (sidomos pas “brexit”). Kjo, do neutralizonte “fake” populizmin e lidërshiptit në Serbi, që riciklon ëndrrën e vjetër e tanimë anakronike se Kosova mund të behet pjesë e Serbisë përsëri! Kosovën në NATO dhe në BE, të paktën unë e shoh vetëm së përmes kësaj Konfederate mes Kosovës dhe Shqipërisë në Ballkan. Kjo zgjedhje ka të bëjë me leadership of real politics, and not illusory of utopic one! Po, sistemet politike të imponuara si modele paqeje akute diktojnë shpesh centrizmin e vendimeve të lidërshiptit në vend, por këto shoqëri do vazhdojnë të riciklojnë ankthin e brendshëm e dita ditës do iu largohen tre shtyllave të demokracisë: human rights, free market, integration in NATO and BE. Ky largim, do mban në ajër të gjithë rajonin e WB6. Pikërisht këtu, e në llogari të këtij vizioni paqeje dhe progresi në regjionin e WB6 hyn në përdorim lidërshipi sipas modelit të Joseph Nye, e që ai e quan SMART LIDERSHIP!

Intervista 2: Enisa Musai

Znj. Enisa Musai është një menaxhere projektsh me përvojë, me një histori të dëshmuar të udhëheqjes dhe menaxhimit të hulumtimeve dhe propozimeve të inovacionit të BE-së, kryesisht në fushat e arsimit, rinisë, grave, etj. Posedon aftësi të forta profesionale në projektet e financuara nga BE, komunikim në rrjet dhe menaxhimin e projekteve ndër-funksionale. Shpreh mendim të fortë kritik dhe aftësi krijuese për zgjidhjen e problemeve. Ka koordinuar një rrjet prej 140 anëtarësh nga rajoni Euro-Mesdhetar i përbërë nga akademia publike dhe private, OJQ-të dhe organizata të ndryshme.

1. Si e përcaktoni suksesin e lidërshiptit politik?

Kuptimi dhe përcaktimi i suksesit të lidërshiptit politik në Ballkanin Perëndimorë pas vitit 1990 është një veti komplekse. Në këtë përcaktim bëjnë pjesë luftërat e shumta çka ndodhën në Ballkan dhe udhëheqësit apo grupacionet e këtyre luftërave u shndërruan në udhëheqësi politike duke luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e shtetit. Për shkak të figurave heroike, suksesi politik është matur me faktin se “ata kanë luftuar për liri” duke vënë kështu në hije dhe duke mos kontestuar punën për të cilën kishin marrë përgjegjësi ta kryejnë. Fatkeqësisht, me përjashtime kuptohet, në Ballkan nuk ka një sukses kolektiv të lidërshiptit politik.

2. Cila është karakteristika që besoni se çdo udhëheqës duhet ta zotërojë?

Do ti kisha veçuar tre karakteristika primare: integriteti, ndjeshmëria dhe vendosmëria. Mendoj që një lider/lidere që i zotëron këto veti dhe nuk bën kompromis me vendosmërinë e tij/saj në çështjet që i konsiderohen të shenjta, nuk ka vend për dështim. Janë po këto veti çka duhet t'i kërkojmë tek liderët e rinj në Ballkanin Perëndimor.

3. Çfarë këshille do t'i jepnit dikujt që merr pozicionin e liderit për herë të parë?

T'u qëndrojë drejt premtimeve dhe kauzës për të cilën ai/ajo beson dhe i është besuar vota e popullit. Pushteti ka tendencë të jetë shumë lakmitar dhe shpesh herë nga rrethana të ndryshme pushteti ka fuqinë të ndryshojë personalitetin e njeriut. Fatmirësisht, ka shumë shembuj të mirë në botë ku mund të mbështeten liderët e Ballkanit Perëndimorë dhe të marrin praktikën më të mira. Po ashtu, mendoj që Ballkani Perëndimor ka vuajtur shumë nga pasoja e të pasurit udhëheqësi jo korrekte gjatë gjithë këtyre dekadave, kështu ka plot shembuj të këqij që mund të shërbejnë si pasqyrim se çka nuk duhet bërë. Këshilla ime më e drejtpërdrejtë do të ishte të mos kopjojmë liderët e vjetër, por të gjejmë mënyrën se si të jemi vetë origjinal dhe të sjellim ndryshim të vërtetë për të cilën gjithë ankohemi se na mungon.

4. Kush janë disa nga liderët politik sot që shërbejnë si një shembull i mirë që duhet ndjekur?

Fatmirësisht ka shumë. Kryeministri i Kanadasë Justin Trudeau apo Kancelarja e Gjermanisë Angela Merkel janë shembuj fantastik që dëshmojnë se si një udhëheqësi e fortë kontribuon në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Kryeministrja e Zelandës së Re e cila e beri këtë vend të jetë i pari fitues në luftën më pandeminë është një udhëheqëse për t'u admiruar. Rast më i freskët është edhe Maia Sandu, fituese e zgjedhjeve presidenciale në Moldavi e cila la të kuptohet se ka shpresë për demokraci në një vend fragjil siç është Moldavia. Për më tepër ajo vërtetoi rolin e saj mobilizues për të bërë diasporën e Moldavisë të vendosin për të ardhmen e vendit të vet. Në Ballkanin Perëndimor, e sidomos tek shqiptarët, besoj që sytë i kemi krejt të drejtuar nga lideri i Vetëvendosjes Albin Kurti. Jam e sigurt se vendosmëria e tij, e sidomos dashuria e tij për vendin e vet, do t'u shërbejë mirë jo vetëm qytetarëve të Kosovës por krejt rajonit të Ballkanit Perëndimor.

5. Cila është sfida më e madhe me të cilën përballen udhëheqësit e shteteve të Ballkanit perëndimor?

Do të kisha thënë që sfida më e madhe është padyshim mos krijimi i një politike të unifikuar për të punuar së bashku në përmbushjen e kushteve për të ju bashkangjitur Bashkimit Evropian. Kjo deklaratë mund të tingëllojë si shumë e “lehtë për t’u shkruar dhe shumë e vështirë për t’u zbatuar” por e di që ka gatishmëri nga të gjitha vendet. Çdo herë më ka pëlqyer thënia e te madhit Winston Churchil “Ballkani prodhon më shumë histori seç mund të konsumojë” dhe mendoj se ka ardhur kohë të marrim përgjegjësi kolektive dhe ti përvishemi punës. Ia kemi borxh rinisë.

6. Cilët janë disa nga mangësitë më të mëdha të liderëve ballkanik?

Nuk mendoj se ka një përgjigje të drejtpërdrejt për këtë pyetje, sidoqoftë do të thosha që mangësia qëndron te fakti se politikanët tanë dinë të politizojnë çdo gjë. Shfrytëzimi i ngjarjeve të ndryshme për pikë politike është një veti shumë e ulur e politikanëve të Ballkanit Perëndimor, të cilët e zotojnë në çdo rotacion qeverie dhe uroj këtë veti mos ta vërej tek liderët e ardhshëm.

7. Sa ndikim ka ish-sistemi monist në mendësinë e liderëve aktual në Ballkanin perëndimor?

Të gjitha sistemet kanë ndikim në krijimin e politikave në Ballkan. Ajo çka mund të thuhet është se fatmirësisht Ballkani Perëndimor ka ndikim të vendeve të zhvilluara me demokraci solide dhe çdo lloj ndikimi që vjen tani do të jetë më pozitiv.

8. A ndikon sistemi politik shtetëror në dështimet e një lideri? (këtu kemi parasysh se shtetet e reja të Ballkanit perëndimor kanë marrë modele të gatshme të sistemeve

politike, disa të cilat akoma nuk janë plotësisht autonome, si Rasti i Bosnjës dhe Kosovës)

Padyshim. Sistemet politike janë të lidhura ngushtë me historinë dhe kulturën e një vendi. Përshtatja e sistemeve të gatshme nga vendet tjera nuk është strategji e mirë. Në rastin e Kosovës dhe B&H, mund të jetë më ndryshe për shkak të rrethanave të luftës dhe limitit të kohës, mirëpo ajo çka shpesh e anashkalojmë ose e vendojmë në harresë është se ka kaluar një kohë e gjatë që nga pavarësimi i këtyre shteteve dhe edhe nëse modeli është marrë i gatshëm, ka pasur deri më tani kohë të mjaftueshme për të bërë përmirësime dhe për të bërë një përputhje më të mirë të sistemit politik e duke marrë parasysh historinë, kulturën, rrethanat socio-ekonomike të vendeve. Mënyra më e mirë se si të shpëtohet nga dështimi është transparenca. Nëse të gjitha punët do të kryheshin me transparencë të plotë, besoj që rrethanat do të ishin shumë ndryshe.

Intervista 3: Selim Daku

Selim Daku ka doktoruar në lëmin e shkencave politike pranë Universitetit të Evropës Juglindore, ndërsa tani ligjeron në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjiilan. Është autor i disa punimeve shkencore që ndërlidhen me fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare në Ballkanin Perëndimor dhe procesin e euro-integrimeve.

1. Si e përcaktoni suksesin e lidershit politik?

Suksesi i një lideri politik përcaktohet nga disa karakteristika, e para është se ai duhet të ketë vizion (për të planifikuar rrugën e suksesit), së dyti i duhet menaxhim efikas (i brendshëm dhe i jashtëm), së treti është mënyra e përcaktimit të nevojave (prioritetet) dhe së fundit implementimi (sjellja e përgjegjshme, ofrimi i zgjidhjeve, kryerja e punëve).

2. Cila është karakteristika që besoni se çdo udhëheqës duhet ta zotërojë?

Karakteristikë e çdo udhëheqësi duhet të jetë vetëdija për respektimin e ligjit, në dobi të zhvillimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kuadër zhvillohet drejtësia dhe barazia si vlera universale brenda strukturës shoqërore.

3. Çfarë këshille do t'i jepnit dikujt që merr pozicionin e liderit për herë të parë?

Të ruajë integritetin personal, të respektojë me këmbëngulësi normat ligjore, të zhvillojnë konceptin e përgjegjësisë kolektive brenda institucionit, të ketë guxim për të vendosur në dobi të shoqërisë, të delegojë detyra dhe të kërkojë llogari, të zhvillojë demokracinë dhe transparencën. Këto pak këshilla mendoj që implikojnë shumë procese të tjera që janë të rëndësishme për funksionimin e shtetit.

4. Kush janë disa nga liderët politik sot që shërbejnë si një shembull i mirë që duhet ndjekur?

Disa nga liderët botërorë të cilët janë shembull i mirë që duhet ndjekur janë Angela Merkel – Kancelare e Gjermanisë dhe Sanna Marin – Kryeministre e Finlandës.

5. Cila është sfida më e madhe me të cilën përballen udhëheqësit e shteteve të Ballkanit perëndimor?

Nuk është e lehtë të zgjidhet një sfidë për udhëheqësit e shteteve të Ballkanit Perëndimor, por duhet të kemi parasysh, ata zakonisht ballafaqohen me nacionalizma nga të cilët është vështirë të largohen. Nacionalizmi ballkanik mbetet sfida më e madhe e cila shndërrohet në pengesë për zhvillim të gjithëmbarshtëm.

6. Cilat janë disa nga mangësitë më të mëdha të liderëve ballkanik?

Autoritarizmi – nënshtrimi i të tjerëve, zhvillojnë ide për të kontrolluar çdo gjë, kërkojnë kontroll absolut në partinë e tyre, tentojnë kontroll të mjaftueshëm në institucione, gjithashtu synojnë edhe ndikimin në partitë tjera.

Korrupsioni – përdorimi i të gjitha mekanizmave në dispozicion për të pasuruar bashkëpunëtorët dhe veten e tyre në mënyra të paligjshme.

Pushteti para shtetit – Puna që ata bëjnë, primat ka marrjen dhe ruajtjen e pushtetit, sa më gjatë që është e mundur dhe më pas mendohet për zhvillimin e shtetit.

7. Sa ndikim ka ish-sistemi monist në mendësinë e liderëve aktual në Ballkanin perëndimor?

Padyshim, impakti i ish-sistemit është evident, veçanërisht kur jemi në dijeni që shumica e liderëve nëpër parti dhe shtete, në një ose mënyrë tjetër kanë qenë të implikuar me detyra në

ish-sistemin monist. Liderët e Ballkanit Perëndimor, është shumë vështirë që të tejkalojnë këtë mendësi, për faktin se përmes saj ose modeleve më të avancuara që dalin nga politikat moniste, realizojnë politika dhe interesa në dëm të popujve.

8. **A ndikon sistemi politik shtetëror në dështimet e një lideri?** (këtu kemi parasysh se shtetet e reja të Ballkanit perëndimor kanë marrë modele të gatshme të sistemeve politike, disa të cilat akoma nuk janë plotësisht autonome, si Rasti i Bosnjës dhe Kosovës)

Është fakt se sistemi i funksionimit shtetëror ua komplikon rrugën e realizimit politik dhe institucional liderëve politik. Padyshim, është përkushtimi për punë të mira, që duhet të bëjë dallimin. Në sisteme të komplikuar si në Bosnjë dhe ndoshta në Kosovë, nëse pre-supozojmë se kemi një lider me tiparet që karakterizojnë liderin e suksesshëm, ai mund të vihet para një situatë ku duhet të zgjedhë në mes të të qenit i veçantë ose i rëndomtë që nuk do të kujtohej për ndonjë gjë. Natyrisht, këto situata janë rrjedhojë e vetëdijes së tyre, se pamundësia e ndryshimit të sistemit i kufizon aspiratat e rrjedhimisht edhe suksesin e tyre.

Intervista 4: Sefer Tahiri

Sefer Tahiri është doktor shkencash nga lëmi i komunikimit në Universitetin e New York-ut në Shkup me temë "Ndikimi i Partive Politike në Politikën Redaktuese të Shërbimit Publik MRTV në periudhën 1998-2006". Ai ka përfunduar studimet e tij master në Institutin për Kërkime Sociologjike dhe Politiko-Ligjore në Shkup. Përveçse profesor në Institutin e Studimeve të Komunikimit, ai jep mësim në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit në Departamentin e Komunikimit në Universitetin e Evropës Juglindore. Ai është një studiues me eksperiencë në Institutin për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Sektori Ndërkulturor dhe është drejtor i Institutit për Demokraci dhe Zhvillim. Fushat me interes akademik dhe kërkimor përfshijnë mediumet dhe politikën, marrëdhëniet me publikun, vetëdijen e medimeve për lirinë dhe shprehjes.

1. Si e përcaktoni suksesin e lidërsipit politik?

Suksesi i një lidërsipit politik varet para së gjithash se sa do të jetë i qëndrueshëm në skenën politike! Por përveç kësaj, ky sukses varet edhe nga fakti se sa arrin të vë në zbatim programin e një subjekti politik, sidomos kur bëhet pjesë e pushtetit. Suksesi i një lidërsipit politik varet edhe nga mënyra se si menaxhon një subjekt të caktuar politik dhe sa arrin të sigurojë demokratizim dhe liri të shprehjes brenda subjektit, përkatësisht demokraci brenda-partiake.

2. Cila është karakteristika që besoni se çdo udhëheqës duhet ta zotërojë?

Duhet të jetë menaxhues i mirë politik, duhet të dijë të menaxhojë në kohë krizash politike, të ketë njohuri themelore mbi sistemin politik dhe funksionimin e institucioneve shtetërore, të jetë komunikues me bazën - qytetarët, të jetë i hapur me mediumet dhe gazetarët, të jetë i dëshmuar në profesionin e tij, të ketë kapacitete politike për bashkëpunime dhe koalicione politike. Po ashtu duhet të jetë orator i mirë, pra të ketë paraqitje të mirë në publik, qoftë duke marrë parasysh të folurin publik dhe komunikimin jo-verbal.

3. Çfarë këshille do t'i jepnit dikujt që merr pozicionin e liderit për herë të parë?

Këshilla kryesore është të mos shndërrohet në lider autokratik, të mos ndjehet mbi të tjerët në partinë politike apo institucionin që drejton dhe të jetë i pari mes të barabartëve.

4. Kush janë disa nga liderët politik sot që shërbejnë si një shembull i mirë që duhet ndjekur?

Ka disa liderë politik që mund të ndiqen, siç janë kryeministri kanadez, Justin Trudeau, sidomos për vizionin e tij të qartë politik dhe qasjen e tij demokratike dhe humane në të bërit politike dhe në qeverisje, pastaj kancelarja gjermane Angela Merkel, e cila ka konsistencë në qëndrime dhe veprime, ndërsa nga liderët e mëhershëm padyshim se janë Bill Clinton dhe Toni Bler.

5. Cila është sfida më e madhe me të cilën përballen udhëheqësit e shteteve të Ballkanit perëndimor?

Sfida më e madhe është tejkalimi i makijavelizimit apo tentimi që me çdo kusht të qëndrojnë në skenën politike, pa marrë parasysh edhe pasojat ndaj tyre, por edhe ato kolektive. Sfidë e madhe është edhe krijimi i kapaciteteve për bashkëpunim mes shteteve, duke marrë parasysh dimensionet historike që vështirësojnë këtë bashkëpunim. Një sfidë shumë e madhe është shmangia e populizmit nga politikë-bërja, por edhe e etnocentrizimit si mënyrë e lehtë për të arritur vota, por që shkakton shumë tensione ndëretnike dhe ndërshtetërore. Një segment tjetër është ajo që përmenda më lartë: shmangia apo eliminimi në masë të madhe i liderokracisë apo i "sulltanatit" në partitë politike, që analogjikisht me thënien e Luigjit XIV do të thotë "Shteti (partia) jam unë"!

6. Cilët janë disa nga mangësitë më të mëdha të liderëve ballkanik?

Mangësitë kryesore reflektohen te funksionimi i partive politike dhe i institucioneve shtetërore, të cilat vuajnë nga totalitarizmi dhe mendësia e imponimit të vetvetes si shpëtimtarë apo figura misionare, që me kalimin zbehen! Mangësi e madhe e liderëve ballkanikë është mospranimi i kritikës ndaj politikave partiake dhe publike që i imponojnë në funksionimin e qeverive dhe institucioneve të shteteve përkatëse. Një shembull të tillë kemi Edi Ramën ose Aleksandar Vuçiqin, të cilët bëjnë të ashtuquajturën politikë mediatike apo politikë për efekte propaganduese apo të PR (marrëdhënieve me publikun), pasi brenda ditës shfaqen disa herë në media, përdorin të gjitha mjetet e komunikimit masiv dhe rrjetet sociale për promovim dhe afirmim të politikave të tyre, duke vënë veten e tyre në plan të parë dhe duke folur për gjithçka dhe duke tentuar që të mos ketë aspak apo fare pak opozitë ose opozitë minimaliste.

7. Sa ndikim ka ish-sistemi monist në mendësinë e liderëve aktual në Ballkanin perëndimor?

Sigurisht që ka ndikim të madh, sepse shoqëritë e shteteve ballkanike dalin nga një ish sistem, në të cilin institucionalisht dhe në procesin arsimor dhe mediatik kultivohej kulti i liderit politik, i cili ishte kreu i klasës udhëheqëse politike, ndërsa i njëjti aspak nuk guxohej të kritikohet apo akuzohet. Ai ishte vetë partia dhe partia ishte lideri, ndërsa partia ishte shteti e shteti ishte partia, pra ishte një rreth ciklik që fillonte dhe përfundonte te lideri (udhëheqësi), i cili hipnotizonte masat e gjera popullore me karizmën, oratorinë e ti dhe prandaj konsiderohej si drejtues shpirtëror dhe jo vetëm politik apo shtetëror. Duke qenë se një pjesë e gjeneratës aktuale politike ka qenë aktive edhe në ish sistemin komunist ose është edukuar në atë sistem, reliktet e të cilit as sot nuk mund t'i eliminojmë, ndikon ndaj faktit që liderë të sotëm politik në Ballkan e projektojnë veten si ish liderët përkatës të popujve apo shteteve, të cilave u përkasin!

8. **A ndikon sistemi politik shtetëror në dështimet e një lideri?** (këtu kemi parasysh se shtetet e reja të Ballkanit perëndimor kanë marrë modele të gatshme të sistemeve politike, disa të cilat akoma nuk janë plotësisht autonome, si Rasti i Bosnjës dhe Kosovës)

Po ndikon, pasi për të pasur sistem partiak demokratik duhet të kemi sistem politik demokratik, i cili në vendet ballkanike, përjashtuar Kroacinë dhe Slloveninë është një ideal i dëshiruar, pasi këto sisteme politike janë hibride, meqë në aspektin normativ - juridik janë demokratike, ndërsa në praktikë, natyrisht me variacione të ndryshme janë autokratike apo edhe shfaqen në dimensione diktatoriale, siç kemi pasur rastin e ish kryeministrit Gruevski në Maqedoni nga vitet 2006-2016! Prandaj, demokratizimi i sistemit do të ndikonte ndaj demokratizimit të partive, edhe pse bindja ime është se ky proces është i kundërt përkatësisht së pari duhet të ndodh demokratizimi i partive politike, të cilat kur instalohen në pushtet duhet të kontribuojnë në demokratizimin e sistemit politik apo institucioneve dhe shteteve ballkanike, duke i bërë më evropiane dhe në këtë mënyrë duke e evropianizuar Ballkanin dhe duke mos mbetur "delja e zezë" (anti) demokratikë në mes të Evropës.

Intervista 5: Bardhyl Zaimi

Bardhyl Zaimi ka një karrierë gazetarie përmbi 20 vjeçare. Fillimisht ka punuar si gazetar në RTM-Redaksia në gjuhën shqipe. Më pas ka punuar si gazetar dhe redaktor kulture në të përditshmen në gjuhën shqipe “Fakti”. Ka punuar si korrespondent një kohë për “Bota Sot”. Ka qenë kryeredaktor i të përvjetshmes “Epoka”, redaktor në të përvjetshmen “Nacional” dhe gazetar-kolumnist në rubrikën e kulturës në “Lobi” si dhe kryeredaktor i revistës mujore për kulturë “Prokultura”. Ka qenë kryeredaktor i televizionit në gjuhën shqipe TV ALB. Gjithashtu ka qenë redaktor edhe në media tjera. Ai ka botuar disa libra dhe është i kyçur në disa projekte ndërkombëtare që kanë të bëjnë me gazetarinë hulumtuese dhe verifikimin e fakteve.

1. Si e përcaktoni suksesin e lidërshiptit politik?

Në kuptimin më të gjerë lidërshipti nënkupton të ngrihesh mbi mesataren, mbi turmën si profil dhe si vlerë. Kjo nënkupton gjithashtu edhe aftësi të caktuara për të menaxhuar me resurset njerëzore, me situatat, gjithnjë duke vendosur parime të mirëqena dhe duke kultivuar vlerën e debatit, por njëkohësisht duke arritur që gjithë këtë ta transponosh dhe sintetizosh në një vizion politik. Suksesi i një lidërshipti përcaktohet nga vizioni dhe guximi për progres, nga këmbëngulja dhe përpjekja për të çuar përpara vizione, nisma dhe procese që janë në përputhje me një lloj idealiteti për një shoqëri më të mirë, për një hapësirë vlerash të kultivuara që në epiqendër kanë një aspiratë të një kolektiviteti, sigurisht gjithnjë në frymën e papërsëritshme të njësisë njerëzore për një botë më të mirë, më të drejtë dhe më humane.

Suksesi i një lidërshipti është pikërisht ky kultivim vlerash, kreativiteti, lirie që sublimohet në vizion dhe në progres gjithëpërfshirës. Është fryma e ndryshimeve pozitive, e lirisë dhe e mirëqenies që synohet si një idealitet politik, kulturor dhe social.

2. Cila është karakteristika që besoni se çdo udhëheqës duhet ta zotërojë?

Ndër karakteristikat kryesore janë vizioni, durimi, maturia, forca kohezive. Këto janë elementet të themi parake, ndërkohë që kësaj duhet shtuar edhe guximi për ndryshim, për

protagonizëm, për të çarë përpara në një mjedis konformist dhe apatik. Gërshetimi i këtyre elementeve bashkë me një zgjuarsia atipike përbëjnë forcën e një udhëheqësi.

3. Çfarë këshille do t'i jepnit dikujt që merr pozicionin e liderit për herë të parë?

Një ndër këshillat do të ishte që të ketë durimin për të dëgjuar dhe debatuar për çfarëdo teme të mundshme, qoftë ajo edhe më paradoksalja. Të jetë interaktiv me njerëzit dhe përpara çdo vendimi të diversifikojë marrjen e mendimeve. Të reflektojë guxim dhe pozitivitet dhe të jetë vetvetja në vizionin që përfaqëson. Të jetë tolerant dhe dialogues në rrafshin e debatit, por të jetë reprezentativ dhe këmbëngulës në forcën e argumenteve.

4. Kush janë disa nga liderët politik sot që shërbejnë si një shembull i mirë që duhet ndjekur?

Nuk mund ta veçoj ndonjërin sepse secili ka anët e mira dhe anët më pak të mira. Sidomos kjo bëhet e vështirë për ta veçuar kur kërkojmë një lider politik që përfron me parametrat më ideale të mundshme. Personalisht gjithnjë të liderët vlerësoj atë që përfaqëson të mirën, duke kritikuar gjithnjë atë që sipas mendimit tim është e gabuar. Në Ballkan, padyshim gati se thuaj të gjithë liderët kanë performanca të përafërta dhe një veçim duket i pamundshëm në këtë rast.

5. Cila është sfida më e madhe me të cilën përballen udhëheqësit e shteteve të Ballkanit perëndimor?

Është mentaliteti ballkanik. Janë realitetet e vrazhda të trashëguara përgjatë historisë së trazuar ballkanike që paraqesin sfida më vete. Janë problemet e shtresuara që nuk gjejnë zgjidhje strukturore. Është konteksti i brishtë, janë ndërvarësitë e shumta, por edhe mbetjet nga ish sistemi që mbeten sfida e vërtetë. Janë edhe shtresëzimet historike, përplasjet identitare, paragjykimet, demonizimet që e bëjnë një lider të jetë në funksione multitask.

Sfida më e madhe pra mbetet transponimi i këtij mentaliteti, i këtyre realiteteve në matricën e mendësisë evropiane, që njeh sistemin e vlerave dhe strukturimin institucional të të gjitha realiteteve politike, kulturore, ekonomike dhe sociale.

6. Cilët janë disa nga mangësitë më të mëdha të liderëve ballkanik?

Mbyllja në një perceptim të padiversifikuar dhe populizmi. Ky mbetet një problem që vërehet tek të gjithë liderët e Ballkanit.

7. Sa ndikim ka ish-sistemi monist në mendësinë e liderëve aktual në Ballkanin perëndimor?

Pa diskutim që ish-sistemi monist ka reflektim në performimin e mendësisë së liderëve të Ballkanit, sepse në një farë mënyre ato determinohen edhe nga kjo mendësi pavarësisht dëshirës për t'u shkëputur. Është një inercion që ndikon nganjëherë edhe padiktueshëm. Është një periudhë kohore e gjatë që ka strukturuar mendësi tipike që reflektohet edhe te liderët e tranzicionit të gjatë në Ballkan. Fundja është një paradigmë që nënkupton shumë shndërrime për të prodhuar liderë me përmasa tjera pa ndikimin e kësaj mendësie.

8. A ndikon sistemi politik shtetëror në dështimet e një lideri? (këtu kemi parasysh se shtetet e reja të Ballkanit perëndimor kanë marrë modele të gatshme të sistemeve politike, disa të cilat akoma nuk janë plotësisht autonome, si Rasti i Bosnjës dhe Kosovës)

Absolutisht sistemi politik shtetëror ndikon në dështimin e një lideri. Kjo vjen për shkak të mospërputhjes së një vizioni politik me kompleksitetin e organizimit dhe sidave të vështira të harmonizimit që i kërkon një rend, një sistem politik dhe kushtetues dhe që bart në vete

shtresëzime dhe mbingarkesa politike dhe identitare që shfaqen tepër të rënda për t'i menaxhuar. Gati në të gjitha vendet e Ballkanit manifestohen këto premisa komplekse të cilat kanë prodhuar dhe mund të prodhojnë dështim. Një lider mund të ketë një vizion të qartë, por shtrëngesat e sistemit politik dhe shtetëror ndikojnë që ai të futet në procesin e kompromiseve dhe të tërheqjes nga ai vizion. Në këtë rast sistemi i ngritur politik shtetëror ia ngushton fushëveprimin dhe prodhon situata që mund ta devalvojnë një lider dhe bashkë me këtë edhe të dështojë në projeksionet e veta sado qofshin ato korrekte dhe në përputhje me substancën e tij si lider. Shtetet e Ballkanit përgjithësisht trashëgojnë sisteme të komplikuara politike dhe shtetërore që nuk kanë arritur të transformohen në një hapësirë lirie dhe mundësish. Gjithë kjo planimetri e disfavorshme e sistemit mund ta çojë në dështim një politikan pavarësisht nga vizioni dhe angazhimi korrekt i projektuar nga ai.

Intervista 6: Xhelal Neziri

Xhelal Neziri ka punuar një kohë të gjatë si gazetar në të përditshmen në gjuhën shqipe Fakti. Në vitin 2002 Neziri kalon si redaktor në të përditshmen Global, kurse njëkohësisht punon edhe si bashkëpunëtor i javores Lobi. Në vitin 2003 angazhohet si korrespondent nga Maqedonia i gazetës Koha Ditore, ndërkohë që ka punuar edhe në javoren Java. Në vitin 2005 angazhohet si redaktor në gazetën Lajm Ekskluzive. Në vitin 2007 themelon javoren e tij Nacional.

Nga viti 2008 është koordinator për Maqedoni i Rrjetit të Gazetarisë Hulumtuese SCOOP, me seli në Kopenhagë të Danimarkës, ndërsa nga viti 2011 është themelues dhe president i Qendrës për Gazetari Hulumtuese SCOOP Macedonia, me seli në Shkup.

Neziri ka botuar tekste, analiza dhe komente në shumë media të vendit dhe të huaja. Ai është drejtues i magazinës online INBOX7.mk, gazetar hulumtues i OCCRP dhe analist në disa media të rajonit. Është ekspert i komunikimit dhe i marrëdhënieve me publikun, në të cilën fushë ka magjistruar pranë Institutit për Hulumtime Sociologjike, Politike dhe Juridike pranë Universitetit "Shën Qirili dhe Metodi" në Shkup. Është duke doktoruar pranë këtij Instituti në shkencat politike në programin "Demokracia në kohë globalizimi".

1. Si e përcaktoni suksesin e lidërshiptit politik?

Mendimi im është se suktesi i lidërshiptit politik përcaktohet nga tre komponentë apo përbërës kryesor: faktorizimi i subjektit në skenën politike, përhapja e ideologjisë te qytetarët dhe vizioni për të ardhmen. Sukseset dhe dështimet në zgjedhje, apo rënie-ngritjet e përkrahjes, janë një lloj treguesi për momente dhe rrethana të caktuara politike, por jo edhe të lidërshiptit në përgjithësi. Lidërshipi vihen në krye të një lëvizje apo organizmi politik për të zbatuar ide dhe ideale (ideologji) që ndajnë një grup i caktuar i njerëzve. Për të përcaktuar suksesin e atij lidërshipi duhet parë shkallë e realizimit të ideve dhe idealeve të tyre, e që janë rezultat i drejtimit të proceseve politike. Pra, suktesi nuk matet vetëm me numrat që burojnë

nga proceset zgjedhore, por me idetë dhe idealet që kanë mbajtur gjatë dhe me realizimin e vizionit që kanë paraqitur.

2. Cila është karakteristika që besoni se çdo udhëheqës duhet ta zotërojë?

Karakteristika e parë duhet të jetë vizioni i qartë politik – çka dëshiron të arrijë me angazhimin e tij; e dyta - idetë dhe ideali (ideologjia) që ka si motor i veprimit politik; e treta – konsistenca/vazhdimësia në realizimin e ideologjisë; e katërta – aftësi organizative, motivuese dhe mobilizuese; e pesta – fleksibiliteti dhe gatishmëria për kompromis; e gjashta – fokusi te qëllimi (vizioni) dhe injorimi i sfidave episodike; e shtata – rritja e kapacitetit koalicionues dhe bashkëpunues nëpërmjet fitimit të besimit të partnerët; e teta – sensi për baraspeshë midis demokracisë së brendshme (shprehja e mendimit ndryshe) dhe kontrollit të partisë (rreshtimit pas një qëndrimi të marrë); e nënta – aftësi për komunikim me publikun; dhe e dhjeta – guxim për të marrë përgjegjësi.

3. Çfarë këshille do t'i jepnit dikujt që merr pozicionin e liderit për herë të parë?

Për të qenë i suksesshëm mendoj se një lider duhet të jetë i çliruar nga emocionet, empatitë dhe aspektet tjera joracionale. Racionaliteti është parakushti kryesor që një lider të jetë i suksesshëm. Arsyeja (ratio) definohet si një aksion që ka një qëllim të caktuar. Nëse një veprim është rezultat i shpërthimeve emotive/joracionale (urrejtje, hakmarrje, inat, smirë...), atëherë ai veprim nuk ka qëllim. Emocionet mund të përdoren vetëm si element i komunikimeve strategjike.

4. Kush janë disa nga liderët politik sot që shërbejnë si një shembull i mirë që duhet ndjekur?

Në realitetet e shteteve demokratike, kancelarja gjermane Angela Merkel pa dyshim është shembull i mirë i udhëheqjes partiake dhe shtetërore. Është racionale, vizionare dhe e qëndrueshme përballë sfidave në Evropë dhe botë. Një model i mirë i politikanit modern është edhe kancelari austriak, Sebastijan Kurz. Edhe ky është një politikan pragmatik, që di të balancojë midis forcave të ndryshme në qeverinë austriake, di të gjejë vendin e duhur në BE dhe di të kompozojë ekip kualitativ dhe të besueshëm rreth tij.

Modelet e dorës së fortë në udhëheqje, siç është rasti i liderëve populistë (Orban, Jansha, Erdogan, Salvini, Trump...), janë vetëm një eksperimentim në kuadër të demokracisë që mëton të shohë nëse forma jo-liberale mund të jetë efektive. Kjo formë e demokracisë është e suksesshme për aq kohë sa prodhon zhvillim ekonomik, vende pune, mirëqenie. Problem tjetër është lidhja e sistemit me një figurë-autoritet, gjë që nuk garanton jetëgjatësi.

Kryeministri britanik Boris Johnson dhe presidenti francez Emanuel Macron janë dy liderë që përdorin elemente populiste në komunikimin e tyre strategjik me opinionin, por duke lëvizur kryesisht në terrenin e demokracisë liberale.

5. Cila është sfida më e madhe me të cilën përballen udhëheqësit e shteteve të Ballkanit perëndimor?

Problemet e shtresuara në histori janë sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohen udhëheqësit e shteteve të BP. Ballkani është i kapur peng nga historia dhe si i tillë vazhdon të ngelet një zonë e nxehtë për konflikte të reja. Modeli i pajtimit midis vendeve evropiane, që numëruan miliona të vrarë në luftën e parë dhe të dytë, rëndë zbatohet në Ballkan. Udhëheqësit shtetërorë nuk kanë guxim të dalin jashtë narrativeve dhe diskurseve konfliktuoze që kanë ndërtuar në opinionet e brendshme për qëllime zgjedhore. Andaj ky pajtim është i

rëndë. Probleme tjera të udhëheqësve shtetërorë të BP është mungesa e zhvillimit ekonomik, mungesa e vendeve të reja të punës, ikja masive e të rinjve dhe paqëndrueshmëria politike dhe e sigurisë.

6. Cilët janë disa nga mangësitë më të mëdha të liderëve ballkanik?

Mangësia më e madhe është mungesa e vendosmërisë në realizimin e vizionit politik. Joshja pas përfitimeve të pushtetit i bën të humbasin fokusin – qëllimin e angazhimit politik. Pjesa më e madhe e tyre nuk arrijnë të gjejnë baraspeshën midis obligimeve dhe përfitimeve nga pushteti.

7. Sa ndikim ka ish-sistemi monist në mendësinë e liderëve aktual në Ballkanin perëndimor?

Ish-sistemi monist ka shumë ndikim së pari në familje, rrethet shoqërore më të vogla (këshilla, bashkësi lokale...) e pastaj edhe te liderët. Liderët janë arketipa të shoqërisë, pra modele që pasqyrojnë njerëzit që përfaqësojnë. Janë një sintezë i të gjitha vetive, veseve, karakteristikave, mentaliteteve dhe niveleve të shoqërisë në një person të vetëm. Liderët janë pasqyrat e grupit të njerëzve që drejtojnë. Kur kemi parasysh faktin se sa patriarkale janë familjet, sa autoritare janë religjionet dhe arsimi, atëherë nuk mund të pritet një lider që nuk do të mëtojë të jetë autoritar. Mendoj se autoritarizmi më shumë ka të bëjë me mënyrën tonë të jetesës sesa me komunizmin, pasi shqiptarët nuk kanë qenë dhe aq të përfshirë e as të mishëruar me atë sistem.

8. A ndikon sistemi politik shtetëror në dështimet e një lideri? (këtu kemi parasysh se shtetet e reja të Ballkanit perëndimor kanë marrë modele të gatshme të sistemeve politike, disa të cilat akoma nuk janë plotësisht autonome, si Rasti i Bosnjës dhe Kosovës)

Gjithsesi se po. Në Kosovë dhe Bosnjë e Hercegovinë tentohet të instalohet një sistem që duket se nuk mund të funksionojë në terrenin ballkanik. Ky sistem promovon vlera evropiane, por nuk mund t'i garantojë ato. Ky sistem buron nga kushtetuta demokratike dhe ligjet në frymë evropiane, që nuk gjejnë zbatim në praktikë. Një gjendje e këtillë e disonancës institucionale, ku mungon shteti ligjor, shpesh sjell edhe dështime për liderët politikë që kërkojnë rregulla loje konform ligjeve dhe kushtetutës.

Intervista 7: Demush Bajrami

Demush Bajrami është Doktor i Shkencave Sociale. Ai doktoroi në Fakultetin e Shkencave Sociale pranë Universitetit të Tiranës, me temë: "Roli i mediave sociale në politikë". Një periudhë ka ushtruar rolin e deputetit në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa aktualisht është i angazhuar si dekan në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit pranë Universitetit të Evropës Juglindore. Ai është autor i shumë publikimeve dhe teksteve dhe ka marrë pjesë në shumë trajnime dhe konferenca ndërkombëtare.

1. Si e përcaktoni suksesin e lidërshiptit politik?

Parë në kontekstin social, karizma në udhëheqjen politike, ka një domethënie të rëndësishme. Kështu, karizma, në të vërtetë përbën një marrëdhënie shoqërore, sepse krijohet një ndërveprim midis udhëheqësit dhe të udhëhequrve. Një udhëheqës ka cilësi që e bëjnë atë të jashtëzakonshëm dhe rreth tij formohet një komunitet pasuesish, nga ku edhe situata shoqërore në të cilën shfaqet karizma është e një rëndësie thelbësore, prandaj lidërshipti është hallka më e rëndësishme për një arritje e për të pasur sukses. Pra, mund të thuhet se çelësi i suksesit në lidërshiptin dhe menaxhimin strategjik qëndron në komunikimin dhe punën e përbashkët. Kjo nënkupton 'rrjetëzimin' politik dhe fluksin gjithnjë e më të shpejtë të depërtimit të informacionit dhe shpejtësisë së përshtatjes me ndryshimet në mjedis.

2. Cila është karakteristika që besoni se çdo udhëheqës duhet ta zotërojë?

Shumëkush mund të mendojë për veten e tij se mund të jetë udhëheqës, por qoftë nëse bazohemi nga teoria, apo nga gjetjet empirike, vetëm disa mund të jenë udhëheqës të suksesshëm. Arti i të qenit lider apo i të bërit lidërshipt, mund të mësohet dhe praktikohet, por shpesh kjo gjë konsiderohet e parëndësishme dhe pikërisht këtu ndodhë gabimi, duke menduar se ata kanë lindur me aftësi lideri! Janë disa karakteristika: lideri duhet të ketë vizion dhe duhet të dijë ta paraqesë vizionin e tij në një mënyrë bindëse. Të ketë aftësi komunikuese dhe të jetë

frymëzues, të ketë ide në çdo kohë - përmes të cilave planifikon t'i arrijë qëllimet e vendosura. Liderët e suksesshëm besojnë në vetvete, kanë qëndrueshmëri, marrin rreziqe dhe dinë si t'i tejkalojnë ato, duhet të jetë i vendosur. Lideri gjithnjë duhet të jetë në hap me trendët, dhe të kuptojë se është jashtëzakonisht e rëndësishme të dijë të përshtatet me anëtarët e ekipit tij.

3. Çfarë këshille do t'i jepnit dikujt që merr pozicionin e liderit për herë të parë?

Ajo që do ta ndihmonte një Lideri të ri, për t'u bërë lider i vërtetë është aftësia e tij për t'u përqendruar në qëllimin kryesor. Duhet të jetë një personalitete energjik, i pandalshëm, të vendosë qëllime të qarta. Të jetë miqësor dhe me ndjeshmëri të zhvilluar dhe të jetë i lumtur kur të gjithë bien dakord me njëri-tjetrin. Të jetë kreativ në kombinimin e ideve dhe krijimin e diçkaje të re, origjinale. Dhe, sa herë që ka një ide, mendim të ri dhe interesant, duhet të jetë i gatshëm që ta ndajë me ekipin (vartësit) e tij!

4. Kush janë disa nga liderët politik sot që shërbejnë si një shembull i mirë që duhet ndjekur?

Lideri efektiv është ai të cilin vartësit e tij do ta pranin pa kundërshtim dhe me simpati. Historia është plot dëshmi për shkëlqimet dhe rëniet e liderëve dhe këto janë të njohura. Kjo do të thotë që njerëzit nuk do ta ndjekin një lider 'me çdo kusht' për një kohë të gjatë, nëse ai do të 'moliset' nga akomodimi në pushtet. Lideri do të mbetet lider për aq kohë sa do ta ketë pëlqimin e përgjithshëm. Një lider i suksesshëm duhet të kuptojë dhe të jetë parimor në bashkëpunim. Pra, kjo do të thotë se lidërshipi kërkon forcë, e forca, siç dihet kërkon bashkëpunim. Për më tepër, lideri duhet të jetë në gjendje të ndikojë tek vartësit e tij, për ta ndjekur atë për ta bërë të njëjtën gjë. Ndoshta, Arben Xhaferi, duke qenë zëri më i artikuluar i shqiptarëve të Maqedonisë, e meriton të ketë vend në leksionet e lidërshipit. Stili i tij i

udhëheqjes nënkupton një sërë strategjish që formësohen dhe homogjenizohen në një tërësi. Modeli i tij i konsensusit përqendrohej në marrëveshjet dhe respektimin e kërkesave të ndryshme të mjedisit që e rrethonte, si një përcaktues i modelit të udhëheqjes së tij. Ndërkohë që, historia botërore na ka dhënë shumë shembuj nëpër kohë... Presidenti Abraham Lincoln, modeli i liderit që u ndjek nga Presidenti Obama. Këta dy ishin njerëzit e duhur në kohën dhe vendin e duhur.

5. Cila është sfida më e madhe me të cilën përballen udhëheqësit e shteteve të Ballkanit perëndimor?

Vendet e Ballkanit Perëndimor sikur janë në kërkim të një lidhësi më të mirë, të cilin për momentin nuk po e gjejnë dot. Pastaj, këtu mbufaten sfidat më të mëdha si çështja e pajtimit ndëretnik, krimi dhe korrupsioni, trafikimi njerëzor, diskriminimi, liria fetare dhe liria e medias, përshtatshmëria dhe transparencja e sistemeve gjyqësore, integrimi i vendeve të mbetura të Ballkanit Perëndimor në NATO dhe BE, si një moment thelbësor për të siguruar një stabilitet të qëndrueshëm në rajon.

6. Cilët janë disa nga mangësitë më të mëdha të liderëve ballkanik?

Mangësia kryesore e liderëve të Ballkanit Perëndimor është se ata duke qenë vetë të pa reformuar nuk mund ta kuptojnë rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe ndjekjen e reformave strukturore. Prandaj, herët a vonë, lidhësi do të jetë temë kryesore e agjendës ballkanike. Mendoj se duhet një veprim i shpejtë sepse kemi të bëjmë me një çështje urgjente. Hapësira po hapet gjithnjë e më shumë për një brez të ri të liderëve për ta marrë të ardhmen e Ballkanit Perëndimor në duart e tyre.

7. Sa ndikim ka ish-sistemi monist në mendësinë e liderëve aktual në Ballkanin perëndimor?

Ende janë të pranishme gjurmët... Mbetjet e strukturave politike nga ish-sistemi monist në shumë vende të Ballkanit Perëndimor janë të integruara mirë në të gjitha strukturat e pushtetit. Në shumë parti politike ata veprojnë dhe janë bartës të po asaj ideologjie politike. Ata vazhdojnë të jenë pjesë në ndarjen e pushtetit politik dhe ekonomik.

8. A ndikon sistemi politik shtetëror në dështimet e një lideri? (këtu kemi parasysh se shtetet e reja të Ballkanit perëndimor kanë marrë modele të gatshme të sistemeve politike, disa të cilat akoma nuk janë plotësisht autonome, si Rasti i Bosnjës dhe Kosovës)

Mund të them se arsyet themelore të dështimit të lidërshpit qëndrojnë pikërisht në natyrën e sistemit politik, tipar kryesor i të cilit është cilësia e dobët e institucioneve. Derisa institucionet janë një pasqyrim i politikës, atëherë thelbi politik i problemit bëhet i dukshëm nëse roli i shtetit nuk shikohet përmes cilësisë së institucioneve shtetërore dhe shërbimeve publike që ato ofrojnë. Këtu diku është shteti i Kosovës, Bosnja e Hercegovina etj.

Intervista 8: Albulena Halili

Albulena Halili ka magjistruar për Diplomaci dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare me temën "Sistemi i Versajës - një rend ndërkombëtar i paqëndrueshëm". Është doktorante për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Tiranës. Fusha e saj hulumtuese është e përqendruar kryesisht në marrëdhëniet transatlantike. Punon në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë që nga viti 2007. Ndër botimet e saj të fundit shkencore radhiten: "Çështja kombëtare shqiptare pjesa e fundit e mozaikut të pabërë Ballkanik", "Evropa Pos-tLisboniane: Politika e jashtme e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor", "Ndërtimi i sistemit ndërkombëtar sipas doktrinë së Udrour Uillsonit", "Çështjet e pazgjidhura që u zënë rrugën integritimeve Euroatlantike: rasti i Ballkanit Perëndimor", etj. Shkruan rregullisht edhe artikuj analitikë në shtypin ditor e atë elektronik.

1. Si e përcaktoni suksesin e lidershit politik?

Suksesi i lidershit politik matet me ndjesinë që ka njeriu i thjeshtë në kohën kur matet sukcesi si dhe vlerësimi i dallimit me kohën para ardhjes së këtij lidershi.

2. Cila është karakteristika që besoni se çdo udhëheqës duhet ta zotërojë?

Udhëheqësi duhet para së gjithash të jetë njerëzor. Së dyti, duhet të ketë bërë një shkollim të rregullt. Të ketë lexuar së paku dhjetë libra, apo thjesht lektyrat shkollore. Udhëheqësi ideal duhet të ketë vizion dhe mision kombëtar dhe të mos jetë vegël e interesave kombëtare të shteteve tjera. Interesi kombëtar duhet të jetë mbi gjithçka. Dhe shumë e rëndësishme - dinjiteti i udhëheqësit.

3. Çfarë këshille do t'i jepnit dikujt që merr pozicionin e liderit për herë të parë?

Të mbesë njerëzor. Pushteti është si lakmia. Sa më shumë që ke, aq më shumë do. Lideri i suksesshëm nuk duhet të harrojë kurrë prej nga ka ardhur dhe ata që i ndihmuan të ngjitet aty. Të mbetet i pakorruptueshëm. Morali në politikë është një gjë e paçmuar. Të lexojë shumë e të informohet shumë. Informacioni është momentalisht arma më e madhe e globit.

4. Kush janë disa nga liderët politik sot që shërbejnë si një shembull i mirë që duhet ndjekur?

Shumë pyetje e qëlluar, por përgjigjja është tej mase e vështirë. Nga liderët shqiptarë që jetojnë do veçoja biografinë e Albin Kurtit si një biografi frymëzuese për të rinjtë me aspirata për t'u bërë liderë politikë. Nga ata që s'rrojnë më, do thosha - Arbën Xhaferi.

5. Cila është sfida më e madhe me të cilën përballen udhëheqësit e shteteve të Ballkanit perëndimor?

Me politikën jo koherente brenda atlantike, pra atë midis Evropës dhe ShBA-ve lidhur me Ballkanin, pastaj me mungesën e unitetit midis shteteve Evropiane, BE-së, e treta me konfliktet historike të pazgjidhura, dhe së fundmi me sfidat e tranzicionit tonë të tejzgjatur, siç janë: korrupsioni, krimi shtetëror i organizuar, krijimi i shteteve-parti, mos-ndarja e pushteteve, mosfunksionimi i shtetit ligjor etj.

6. Cilët janë disa nga mangësitë më të mëdha të liderëve ballkanik?

E para, harrojnë t'i thonë mjaft pushtetit, apo edhe të qenët në krye të një subjekti. Për mua lideri ideal do kishte të drejtë të rrinte në një pozitë më së shumti dy mandate. E dyta, moskrijimi i pasardhësve apo edhe pamundësimi i krijimit të tyre. Kjo është një e metë e madhe që e minon procesin e vijimësisë së idesë dhe ideologjisë politike të subjekteve. E treta, të parit

e subjektit që ata udhëheqin, si pronë private dhe familjarizimi me anëtarët e tij. E katërta, të parit e pushtetit si mënyrë për t'u pasuruar. Dhe së fundmi, të dhënit e premtimeve që tejkalojnë mundësitë e përmbushjes.

7. Sa ndikim ka ish-sistemi monist në mendësinë e liderëve aktual në Ballkanin perëndimor?

Shumë. Sistemi monist, është fatkeqësisht akoma mendësi veprimi jo vetëm në subjektet politike, por edhe në të gjitha institucionet publike e private, duke mos përjashtuar as institucionet arsimore.

8. A ndikon sistemi politik shtetëror në dështimet e një lideri? (këtu kemi parasysh se shtetet e reja të Ballkanit perëndimor kanë marrë modele të gatshme të sistemeve politike, disa të cilat akoma nuk janë plotësisht autonome, si Rasti i Bosnjës dhe Kosovës)

Po, gjithsesi. Sidomos në shtetet të cilat nuk përfaqësojnë realitetin shoqëror, siç është rasti me Maqedoninë. Maqedonia ka një sistem politik që funksionon si shtet mono-etnik, ndërkaq që shoqëria është multi-etnike. Apo, shembujt që theksoni më lart vetë ju. Modelet e gatshme të njëjta të cilat imponohen për realitete të ndryshme etnike, fetare, historike etj.

Në demokraci të pa-konsoliduara, lideri mund të jetë një faktor shumë i rëndësishëm, por edhe e kundërta, pa asnjë lloj peshe. Suksesi dhe dështimet e tij, nuk varen kryekëput nga ai, por nga një mori rrethanash e faktesh që për shoqëritë demokratike bashkëkohore janë të panjohura madje të paimagjinueshme.

Konkluzione për intervistat e realizuara

Në bazë të intervistave të realizuara, mund të përfundojmë se sukseesi i lidërshiptit politik përcaktohet nga tre komponentë apo përbërës kryesor: faktorizimi i subjektit në skenën politike, përhapja e ideologjisë te qytetarët dhe vizioni për të ardhmen. Gjithashtu, ndër karakteristikat kryesore që një udhëheqës politik duhet t'i posedojë janë vizioni, durimi, maturia, forca kohezive. Duhet të jetë menaxhues i mirë politik, duhet të dijë të menaxhojë në kohë krizash politike, të ketë njohuri themelore mbi sistemin politik dhe funksionimin e institucioneve shtetërore, të jetë komunikues me bazën - qytetarët, të jetë i hapur me mediumet dhe gazetarët, të jetë i dëshmuar në profesionin e tij, të ketë kapacitete politike për bashkëpunime dhe koalicione politike. Po ashtu duhet të jetë orator i mirë, pra të ketë paraqitje të mirë në publik, qoftë duke marrë parasysh të folurin publik dhe komunikimin jo-verbal.

Si lider i cili përcjell vija të theksuara të lidërshiptit autentik në nivel global, nga shumica e të anketuarve përmendet Angela Merkel. Ajo portretizohet si e aftë, a mençur dhe vizionare.

Autoritarizmi, tentativa për kontroll absolut në partinë e tyre dhe në institucionet që i udhëheqin, korrupsioni, pushteti para shtetit janë disa nga mangësitë kryesore të liderëve të Ballkanit Perëndimor.

Problemet e shtresuara në histori janë sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohen udhëheqësit e shteteve të BP. Ballkani është i kapur peng nga historia dhe si i tillë vazhdon të ngelet një zonë e nxehtë për konflikte të reja. Modeli i pajtimit midis vendeve evropiane, që numëruan miliona të vrarë në luftën e parë dhe të dytë, rëndë zbatohet në Ballkan.

Gati të gjithë të intervistuarit janë të mendimit se ish-sistemi monist ka pasur një ndikim të konsiderueshëm në mendësinë e liderëve aktual në Ballkanin perëndimor. Madje, ata konsiderojnë se demonët e së kaluarës ende janë të pranishëm në mendjen e politikë-bërjen e tyre. Është ky një rrjet merimange i relatave të dikurshme që i trashëgojnë edhe gjeneratat reja. Shkëputja e moderuar nga to do nënkuptonte mirëqenie sovraane për shtetin, shoqërinë dhe lidërshiptin. Dhe këtu, në këtë relacion e në këtë vazhdë, është koha që krijon "distancën e

ftoftë” ajo që i jep kuptim kësaj marrëdhënieje! I shton vlera të reja, i hap horizonte të reja do kisha thanë !

Për sa i përket konstatimit se **sistemi politik shtetëror luan rol të rëndësishëm në dështimet e një lideri**, të intervistuarit cekin se sistemet politike janë të lidhura ngushtë me historinë dhe kulturën e një vendi. Përshtatja e sistemeve të gatshme nga vendet tjera nuk është strategji e mirë. Në rastin e Kosovës dhe B e H, mund të jetë më ndryshe për shkak të rrethanave të luftës dhe limitit të kohës, mirëpo ajo çka shpesh e anashkalojmë ose e vendojmë në harresë është se ka kaluar një kohë e gjatë që nga pavarësimi i këtyre shteteve dhe edhe nëse modeli është marrë i gatshëm, ka pasur deri më tani kohë të mjaftueshme për të bërë përmirësime dhe për të bërë një përputhje më të mirë të sistemit politik e duke marrë parasysh historinë, kulturën, rrethanat socio-ekonomike të vendeve. Stabiliteti para standardeve jo gjithmonë ka dëshmuar mirëqenie nëpër këto shoqëri! Një garanci për standarde të reja Maqedonisë së Veriut p.sh. po i jep anëtarësimi në NATO.

Për më tepër, arsyet themelore të dështimit të lidërsipit qëndrojnë pikërisht në natyrën e sistemit politik, tipar kryesor i të cilit është cilësia e dobët e institucioneve. Derisa institucionet janë një pasqyrim i politikës, atëherë thelbi politik i problemit bëhet i dukshëm nëse roli i shtetit nuk shikohet përmes cilësisë së institucioneve shtetërore dhe shërbimeve publike që ato ofrojnë.

KONSTATIME DHE REKOMANDIME

Udhëheqja politike apo lidhshipi politik është një koncept thelbësor i cili luan një rol të rëndësishëm në rregullimin shoqëror në përgjithësi. Liderët politikë janë ata të cilët duhet prodhuar vlerë publike, të identifikojnë problemet dhe sfidat me të cilat përballet një komunitet i veçantë politik, të japin drejtimin e duhur dhe zgjidhje, duke siguruar mbështetje politike dhe popullore për realizimin e ideve të paracaktuara. Udhëheqësi politik nuk është vetëm një politikan, si dhe udhëheqja politike nuk është udhëheqje standarde. Liderët politikë në vendet demokratike shpërndajnë përgjegjësi, fuqizojnë njerëzit dhe ndihmojnë në diskutime dhe debate. Këtu, rol të madh luan edhe pjekuria e demokracisë, e cila mund të ndikojë në kuptimin e njerëzve për udhëheqjen politike, e kjo do të thotë që politika ndikohet jo vetëm nga sistemi, por edhe nga mjetet e marketingut, duke përfshirë krijimin e imazhit, stilin e udhëheqjes dhe përgjigjen ndaj nevojave dhe pritjeve të votuesve.

Shtetet e Ballkanit Perëndimor për një kohë të gjatë tani më ndodhen në një tranzicion të cilit akoma nuk i shihet fundi dhe i njëjti dita ditës tregohet të jetë jofunksional, duke i nxjerrë në pah dobësitë e sistemeve politike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Nga ana tjetër, këto ndryshime ndodhin në një kohë ku kërkesat e qytetarëve janë gjithnjë në rritje e sipër, si rezultat i ngritjes së vetëdijes së tyre kolektive e cila vjen si pasojë e zhvillimit të jashtëzakonshëm teknologjik në përgjithësi, dhe të globalizmit në veçanti. Këtu ndonëse një rol kyç kanë edhe liderët politik të Ballkanit Perëndimor, sërish qasja e tyre kërkon një analizë më të thellë nga aspekti teorik praktik i të gjitha shteteve përkatëse.

Në bazë të rekomandimeve të OSBE (ODIHR-it), në lidhje me organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve në Shqipëri, vërejmë se vërejtjet dhe rekomandimet pothuajse të njëjta përsëriten vite me radhë, duke mos u përfillur nga institucionet shtetërore apo nga klasa politike në vend. Kjo do të thotë se mungon vullneti i mirë nga elitat politike në vend për të kapërcyer anomalitë që kanë të bëjnë me shkeljet e procesit zgjedhor dhe sundimin e demokracisë funksionale, por nga ana tjetër na bën me dije se mungojnë mekanizmat qortues dhe disiplinor nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, ose thjesht të njëjtat nuk japin rezultatet e duhura.

Raporti i fundit i organizatës Freedom House, është tejet negativ mbi Serbinë dhe udhëheqësinë politike, duke e përshkruar Serbinë si një “regjim hibrid”, kryesisht për shkak të standardeve në rënie në qeverisje, drejtësi, zgjedhje dhe liri të mediumeve. Qeveria aktuale serbe kontrollon mediumet dhe rrjetet sociale, duke mos lënë anash faktin se ajo udhëhiqet gati pa pjesëmarrjen e opozitës në parlament.

Mali i Zi për herë të parë pas rreth 30 viteve do të udhëhiqet nga një parti apo koalicion tjetër, ndryshe nga ai të cilin malazezët e kanë pasur në të kaluarën, i cili udhëhiqej nga Milo Gjukanović, presidenti aktual i Malit të Zi, me jetëgjatësinë më të madhe politike në Ballkan, gjë e cila tani do të krijoj një tërmet politik, pasi që qeveria e re vazhdimisht po ngre akuza korruption dhe keqpërdorime për ish-pushtetmbajtësit.

Bosnja dhe Hercegovina është shembulli më i mirë i mos-funksionimit të një sistemi politik, dhe shoqërie multi-etnike, pasi që lufta kryesore në arenën politike bëhet për të forcuar pozicionet brenda pushtetit dhe jo për të shërbyer për një shoqëri më të mirë. Ky mos funksionim i sistemit vërehet edhe në raportet e mësipërme midis entiteteve të ndara në baza etnike.

Kosova vazhdimisht përballet me zgjedhje të një pas njëshme dhe jo-stabilitet politik. Shumë nga politikanët pretendojnë të bëhen udhëheqës shtetëror por asnjëri nuk arrin të mbledh vota të mjaftueshme për një qeveri dhe stabilitet politik në vend. Kjo tregon një krizë lidërsipit politik i cili akoma nuk mund të konsolidohet, që nga vdekja e presidentit historik Ibrahim Rugova, i cili akoma shihet nga numri më i madh i popullatës si i pa-zëvendësueshëm, gjë e cila e krijon kultin e liderit.

Në rastin e Maqedonisë së Veriut, numri i madh i rekomandimeve nga ana e ODIHR kanë të bëjnë me keqpërdorimin e resurseve shtetërore në kohë zgjedhjesh nga ana e pushtetit. Këto vlerësime edhe pse të buta, sërish e vendojnë në pikëpyetje legjitimitetin e lidërsipit të zgjedhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Për më tepër mund të merret parasysh, mos realizimi i regjistrimit të popullatës që nga viti 2002, e cila ndikon drejtpërdrejt në listat zgjedhore që vite me radhë kontestohen nga subjekte të ndryshme politike në vend.

Në bazë të hulumtimit të realizuar në rrjetet sociale Facebook, Twitter, Instagram, mbi përdorimin e këtyre mjeteve të komunikimit nga liderët e Ballkanit Perëndimor shihet qartë se kryeministri i Republikës së Shqipërisë Edi Rama kryeson në të gjitha platformat në rrjetet sociale, i pasuar nga Presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiç. Pikërisht këta dy liderë akuzohen për mosdhënie të mjaftueshme të hapësirës mediatike opozitës gjë që ka ndikuar mes tjerash në pushtet absolut të këtyre dy liderëve në nivel lokal dhe qendror. Më tej, janë të arsyeshme edhe shqetësimet e opozitës serbe kur kemi parasysh të dhënat e lartpërmendura, fushatën arrogante mediatike dhe investimet e vazhdueshme në këtë fushë, shpeshherë edhe në mënyrë të palejueshme nga ana e pushtetmbajtësit, duke cekur edhe keqpërdorimet të cilët i mundësojnë edhe rrjetet sociale me përdorimin e llogarive të rreme për ta sulmuar oponentin politik. Për më tepër mund të vërehet tendenca rritëse e ish-kryeministrit të Kosovës Albin Kurti, i cili në vazhdimësi bën investime në rrjetet sociale përmes angazhimit të njerëzve profesionist në këtë fushë. Nga ana tjetër udhëheqësit nga Bosnja Hercegovina rezultojnë të jenë më pak të përfshirë në rrjetet sociale, pasi që të njëjtit nuk i kushtojnë shumë rëndësi kësaj forme komunikimi. Anëtari aktual i Presidencës së Bosnjë dhe Hercegovinës Millorad Dodik shfrytëzon vetëm llogarinë në Facebook dhe ka rreth 17.000 ndjekës, që në krahasim me liderët tjerë të Ballkanit perëndimorë është numër shumë i vogël.

Situata aktuale e dalë nga kriza me COVID 19 ka lënë një pasiguri të madhe në rrafshin global. Si pasojë e kësaj krize në të ardhmen do të ketë edhe zhvendosje të mëdha të politikave botërore dhe bashkëpunimeve strategjike. Kjo krizë shihet edhe si një garë në mes të fuqive botërore për të shprehur gatishmërinë, madhështinë dhe kapacitetet e këtyre shteteve, me qëllim që pas kapërcimit të krizës, të përfitojnë sa më tepër në ri-radhitjen e re të listës së superfuqive botërore. Për sa u përket shteteve të Ballkanit Perëndimor, ata ndjekin me vëmendje këto zhvillime gjeostrategjike dhe vlerësojnë përfitimet por edhe rreziqet nga lidhja e aleancave të reja në të ardhmen e afërt. Për këtë arsye edhe studimi i rrethanave dhe indikatorëve që kanë ndikim në politikat aktuale të liderëve politik janë e një rëndësie të veçantë, ngase kjo edhe do të vendosë se në çfarë drejtimi do të lëvizë Ballkani Perëndimor në një të ardhme të pasigurt me plot sfida për udhëheqësit politik.

Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të vazhdojnë zbatimin e reformave të nevojshme pavarësisht nga përparimi në procesin e integritimit në BE. Për mbarëvajtjen e këtij procesi duhet të angazhohen të gjithë liderët politik. Reformat si të tilla po ndihmojnë në modernizimin e vendeve dhe janë të dobishme për to. Në kohën kur politikës së zgjerimit nuk i jepet përparësi në BE, fokusi duhet të përqendrohet në aspektet teknike/sectoriale të procesit të integritimit. Zhvillimi ekonomik duhet të jetë një përparësi kryesore. Politika e zgjerimit është një kornizë e modernizimit të shtetit dhe ekonomisë dhe qëllimi i saj është të përgatisë vendin për konkurrencën në tregun e përbashkët. Sa më mirë të përgatitet një vend për anëtarësimin, aq më shumë përfitime mund të ketë nga anëtarësimi. Reforma e Administratës Publike, siç është nënvizuar disa herë nga BE, është bërë guri thelbësor i të gjitha reformave të tjera dhe synohet si një nga shtyllat e procesit të zgjerimit. Ajo gjithashtu është një parakusht për zbatimin e reformave të tjera.

Rajoni i Ballkanit është plot me çështje dypalëshe të pazgjidhura dhe ato duhet të trajtohen me kujdes dhe sa më shpejtë, pasi ndonjëherë duket se një vend duhet të negociojë më shumë me fqinjët e tij sesa me Brukselin. Për sa i përket BE-së dhe rolit të tij në Ballkan, politika e zgjerimit ka qenë një mjet për të nxitur stabilitetin përtej kufijve të BE-së. Dështimi i kësaj politike ndoshta do të çonte në rritjen e paqëndrueshmërisë rreth Bashkimit Evropian; në perspektivën më të gjatë, kjo do të ndikonte negativisht në sigurinë e BE-së, si të brendshme ashtu edhe të jashtme. Në të njëjtën kohë do të dobësonte pozicionin e BE-së karshi partnerëve të tjerë globalë.

Roli i BE-së është sfiduar ende më shumë në këtë periudhë, duke pasur parasysh tendencën në rritje të shteteve si Rusia, Kina apo Turqia, që nëpërmjet projekteve ekonomike, infrastrukturore dhe kulturore të faktorizohen në Ballkan. Situata aktuale, që buron nga kriza me pandeminë COVID-19, vetëm se më tepër e thekson këtë realitet. Marrja e vaksinave anti-Covid nga Rusia, nga ana e Serbisë, investimi në autostrada në Maqedoninë e Veriut dhe Mal të Zi nga ana e kompanive kineze, sigurimi i porteve Greke nga ana kineze dhe investimet nga ana e qeverisë turke në shumicën e vendeve të Ballkanit perëndimor, si shkolla, spitale, qendra kulturore, banesa sociale dhe të tjera. E gjithë kjo tregon një tendencë të distancimit të

shteteve të Ballkanit Perëndimor nga rruga drejt BE, duke u kthyer gjithnjë e më tepër drejt Lindjes.

Në bazë të hulumtimit dhe analizave të prezantuara më lartë, si dhe nga intervistat e realizuara në kuadër të këtij punimi, konstatojmë se liderët politik të Ballkanit Perëndimor janë ndikuar ndjeshëm nga e kaluara moniste, gjë e cila ka luajtur një rol të madh në profilizimin e tyre në skenën politike të Ballkanit Perëndimor. Shembull konkret është jetëgjatësia dhe mënyra e politikë-bërjes, si në rastin e Shqipërisë dhe Serbisë – dy shtete këto që funksionojnë pa opozitë parlamentare, duke kontrolluar çdo pore të shoqërisë, dhe duke mos lejuar të jenë të kontrolluar. Jetëgjatësia politike është një tipar tjetër që i karakterizon liderët e Ballkanit Perëndimor, ku numri më i madh i tyre janë aktiv në postet kyçe të pushtetit në një periudhë kohore mbi 20 vite. Me këtë e vërtetojmë hipotezën kryesore të cilën e kemi cekur në hyrje të punimit. Kjo dëshmohet në ngjashmëritë dhe tiparet që i posedojnë numri më i madh i liderëve të Ballkanit Perëndimor, të tilla siç janë nacionalizmi, populizmi, mos-dhënia e llogarisë dhe mos-mbajtja e përgjegjësisë, kontrollimi i sistemit dhe lufta e pamëshirshme për pushtet, me ç'rast humbet shpresa se rajoni i Ballkanit Perëndimor do të qeveriset në të ardhmen e afërt nga një demokraci funksionale dhe shtet i së drejtës.

Për më tepër, sistemet aktuale dhe rregullimi politik i shteteve të Ballkanit Perëndimor, edhe pse njihen si demokratike, kanë dështuar në prodhimin e demokracisë funksionale, gjë e cila më së miri mund të konfirmohet nga analiza e raporteve të OSBE (ODIHR), të cilat në vazhdimësi japin kritika dhe rekomandime për përmirësimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Gjithashtu, politika jo e konsoliduar dhe përkëdhelëse e Unionit Evropian karshi shteteve të Ballkanit Perëndimor ka ndikuar ndjeshëm në jetëgjatësinë e liderëve politik të shteteve të Ballkanit Perëndimor, gjë e cila e ka dëmtuar rajonin dhe rrugëtimin e tij drejt integritimeve euro-atlantike, duke hapur kështu mundësinë e kthimit të rajonit drejt alternativave të tjera. Së fundmi, shfrytëzimi i rrjeteve sociale nga liderët Ballkanik, gjithnjë e më tepër influencon politikat aktuale dhe përkrahjen politike nga masat. Krahës kësaj, një numër i liderëve Ballkanik shfrytëzojnë këto platforma për të shpalosur nacionalizmin e tyre me qëllim të përfitimit të votave dhe ruajtjen e pushtetit, bile në raste të tilla si Serbia, aparati

shtetëror është përdorur për kontroll dhe manipulim të rrjeteve sociale, me qëllim të dëmtimit të imazhit të opozitës dhe eliminimit të tyre politik.

BIBLIOGRAFIA

- Aristotle & Roberts, W. R. (2004). *Rhetoric*. Mineola, N.Y.: Dover Publications.
- Aristotle, Ross, W. D., & Brown, L. (2009). *The Nicomachean ethics*. Oxford University Press.
- Rrustemi, A., de Wijk, R., Dunlop, C., Perovska, J., & Palushi, L. (2019). *Geopolitical Influences of External Powers in the Western Balkans*. HCSS Security.
- Burns, J. M. (1978). *Leadership*. New York: Harper & Row.
- Koprivica, D. & Kovacevic, M. (2020). *Demokratija bez institucija*. Qendra për tranzicion demokratik. Podgoricë.
- Cawthon, D. (2002). *Philosophical Foundations of Leadership*. Routledge. New York.
- Nelson, M. (2015). *Aristotle and Leadership*. University of the Cumberland. Kentucky.
- European Union. (2019). *Election Observation Mission - KOSOVO 2019*, Final Report.
- EWB. (2019). Members of European Parliament nominate Tsipras and Zaev for Nobel Peace Prize. Retrieved from <https://europeanwesternbalkans.com/2019/01/28/members-european-parliament-nominate-tsipras-zaev-nobel-peace-prize/>
- Bieber, F. (2019). *Leadership Adrift: American Policy in the Western Balkans*. Balkans in Europe Policy Advisory Group.
- Floudas, D.A. (2002). *Pardon? A Conflict for a Name? FYROM'S DISPUTE WITH GREECE REVISITED*, in: Kourvetaris et al. (eds.), *The New Balkans: Disintegration and Reconstruction*, East European Monographs, New York: Columbia University Press
- Fukuyama, F. (2010). *Ndërtimi i shtetit*. AHS. Tiranë
- Frckoski, L. (2009). *The character of the name dispute between Macedonia and Greece*. Friedrich-Ebert-Stiftung. Skopje
- Hinrich Ahrens, G. (2010). *Diplomaci mi tēhun e thikēs, Pengimi i konfliktit etnik dhe grupi i punēs për minoriteteti konferencave për Jugosllavinē*. Tiranë.
- Fruscione, G. (2020). *The Balkans: Old, new instabilities, a European region looking for its place in the world*. ISPI.

- WorldMayor (data e qasjes, 26.12.2020)
http://www.worldmayor.com/worldmayor_2004/rama_winner04.html,
- Kalderon Adizes, I. (2012). *Adizes o politici*. Hesperia. Beograd
- Josifoviq, I. (2015). *Demokratizimi përmes stabilitetit të institucioneve*.
<http://eprints.ugd.edu.mk/17067/17/Democratization.pdf>
- Rost, J. (1993). *Leadership for the Twenty-First Century*. CN:Praeger. Westport.
- Torfing, J. & Sorensen, E. (2019). *Udhëheqja politike ndërvepruese në teori dhe praktikë: si politikanët e zgjedhur mund të përfitojnë nga bashkë-krijimi i rezultateve të vlerave publike*. Shkencat administrative.
- Horton, J. (2007). *Political Leadership and Contemporary Liberal Political Theory*. School of Politics - International Relations and Philosophy. Keele University.
- Abdullai, J. (2016). *Politika dhe politikat publike*. Arbëria Design. Tetovë.
- Abdullai, J. (2008). *Ndryshimet sociale dhe tranzicioni*. Arbëria Design. Tetovë.
- Keohane, N. O. (2014). *Mendimi Politik Perëndimor*. Oxford: Oxford University Press.
- Koleci, B. (2019). *Improving strategies and the role of leadership in enterprise*. Knowledge International Journal.
- Kostovilis, S. (2005). *Exploring the Sources of Greek Foreign Policy Towards the Former Yugoslav Republic of Macedonia*. London School of Economics and Political Science.
- Matha Cottam, Beth Dietz – Uhler, Elena M. Mastors, Thomas Preston, Hyrje në psikologji politike, UFO Press, Tiranë, 2009, f.105
- MCIC. (2018). *Name dispute*. Retrieved from <https://mcms.mk/en/news-and-publicity/news/2020-sporot-za-imeto-2018.html>
- Simurdic, M. (2016). *Ballkani Perëndimor në mes të gjeografisë dhe gjeopolitikës*. Friedrich Ebert Stiftung. Beograd.
- Drzewiecka, M. & Cwalina, W. (2014). *Cilat stile politike të udhëheqjes preferojmë? Studim ndër-kulturor në tipologjinë e udhëheqjes së Goleman*. Instituti i Psikologjisë Ekonomike. Universiteti i Shkencave Sociale dhe Shkencave Humane (SWPS) Varshavë. Poloni.

- Nimetz, M. (2020). *The Macedonian “Name” Dispute: The Macedonian Question—Resolved?*. Nationalities Papers. Vol. 48.
- Office for Democratic Institutions and Human Rights (2018). *BOSNIA AND HERZEGOVINA, GENERAL ELECTIONS, 7 October 2018*. ODIHR Election Observation Mission Final Report.
- Office for Democratic Institutions and Human Rights, MONTENEGRO
- Office for Democratic Institutions and Human Rights (2020). *REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA, EARLY PARLIAMENTARY ELECTIONS, 15 July 2020*. ODIHR Special Election Assessment Mission Final Report.
- Office for Democratic Institutions and Human Rights (2019). *REPUBLIC OF ALBANIA, LOCAL ELECTIONS, 30 June 2019*. ODIHR Election Observation Mission Final Report.
- Office for Democratic Institutions and Human Rights (2020). *REPUBLIC OF SERBIA, PARLIAMENTARY ELECTIONS, 21 JUNE 2020*. ODIHR Special Election Assessment Mission Final Report.
- ODIHR Limited Election Observation Mission (2020). *PARLIAMENTARY ELECTIONS, 30 AUGUST 2020*, Final Report.
- Platoni. (2017). *Republika*. Plejad. Tiranë.
- Solomon, R.C. (1998). *Ethical Leadership, Emotions and Trust: Beyond Charisma, Ethics, The heart of Leadership*. CN:Praeger. Westport.
- Huntington, S. (2011). *Vala e tretë*. AIIS. Tiranë.
- Lehne, S. (2020). *Geopolitics, the EU and the Western Balkans*. Institute for Democracy “Societas Civilis”. Skopje.
- W.Bennis & B. Nanus. (1978). *Leaders: The strategies for taking charge*. Harper & Row New York.
- Weber, M. (1919). *Politikals Beruf* (lecture delivered before the Freistudentischen Bund of the University of Munich) (S.H. transl.) in: *GesammeltpolitischeSchriften*
- Brzezinski, Z. (2012). *Vizion strategjik – Amerika dhe kriza e fuqisë globale*. AIIS.

SHTOJCA

Pyetjet e intervistës

1. Si e përcaktoni suksesin e lidërsipit politik?
2. Cila është karakteristika që besoni se çdo udhëheqës duhet ta zotërojë?
3. Çfarë këshille do t'i jepnit dikujt që merr pozicionin e liderit për herë të parë?
4. Kush janë disa nga liderët politik sot që shërbejnë si një shembull i mirë që duhet ndjekur?
5. Cila është sfida më e madhe me të cilën përballen udhëheqësit e shteteve të Ballkanit perëndimor?
6. Cilët janë disa nga mangësitë më të mëdha të liderëve ballkanik?
7. Sa ndikim ka ish-sistemi monist në mendësinë e liderëve aktual në Ballkanin perëndimor?
8. A ndikon sistemi politik shtetëror në dështimet e një lideri? (këtu kemi parasysh se shtetet e reja të Ballkanit perëndimor kanë marrë modele të gatshme të sistemeve politike, disa të cilat akoma nuk janë plotësisht autonome, si Rasti i Bosnjës dhe Kosovës)